

Sipas procesit të planifikimit kombëtar të përshtatjes

PLANIT KOMBËTAR I PËRSHTATJES TË SHQIPËRISË PLANI I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026-2036



GREEN
CLIMATE
FUND



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT



Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e Republikës së Shqipërisë

Tetor 2025

Autorët:

Marinela Spahiu
Lauren Clark

Koordinuar nga:

Laureta Dibra, Koordinatore e Projektit të PKP-së pranë UNDP-së

Redaktorë dhe kontribuues të tjerë:

Inês Ferreira (Global Factor)
Maria Florencia Lang (Global Factor)
Soraya Cuesta (Global Factor)
Claudia Ramos (Global Factor)
Joselyn Manosalvas (Global Factor)

Autorët dëshirojnë të shprehin mirënjohjen e tyre të sinqertë për palët e shumta të interesit që kontribuuan në hartimin e këtij Plani për Barazinë Gjinore. Falënderime të veçanta shkojnë për përfaqësuesit e institucioneve qeveritare vendore dhe kombëtare, organizatat e shoqërisë civile, akademikët, partnerët e zhvillimit dhe ekspertët e pavarur që ndanë kohën, njohuritë dhe pikëpamjet e tyre gjatë intervistave dhe konsultimeve. Kontributet e tyre të vyera kanë luajtur rol thelbësor në formësimin e një qasjeje të përgjigjshme gjinore ndaj Planit Kombëtar të Përshtatjes të Shqipërisë.

Deklaratë për mospranim përgjegjësie

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të vetë autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), apo të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë. Gjinia nuk është një term i barasvlershëm me gratë. Gjinia u referohet karakteristikave të burrave dhe grave të ndërtuara nga shoqëria, si dhe marrëdhënies midis tyre (pra, me çfarë përballen gratë dhe burrat në të njëjtën kontekst).

Sipas procesit të planifikimit kombëtar të përshtatjes

PLANIT KOMBËTAR I PËRSHTATJES TË SHQIPËRISË PLANI I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026-2036



Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive	08
01. Hyrje	12
02. Të kuptuarit e lidhjes midis përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe aspekteve gjinore	16
2.1. Historiku i vendit	17
2.2. Panoramë e integritit të aspekteve gjinore në Shqipëri	19
2.3. Rëndësia e integritit të aspekteve gjinore në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	25
03. Analiza gjinore në sektorët kryesorë të PKP-së	28
3.1. Bujqësia dhe pylltaria	29
3.2. Turizmi	30
3.3. Zhvillimi urban	31
3.4. Energjia	32
3.5. Transporti	33

04.	Plani i veprimit për aspektet gjinore 2026-2036	36
	4.1. Arsyetimi	37
	4.2. Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore	38
	4.3. Masat ndërsektorale	36
	4.4. Bujqësia dhe pylltaria	42
	4.5. Turizmi	43
	4.6. Zhvillimi Urban	44
	4.7. Energjia	45
	4.8. Transporti	46
<hr/>		
	Lista e referencave	47
<hr/>		
	Shtojcat	49
<hr/>		

Lista of Figurave

Figura 1. Shpërndarja e popullsisë sipas qarqeve	17
Figura 2. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (%)	18
Figura 3. Punësimi informal (%)	18
Figura 4. Ilustrim i konceptit bazë të riskut (PNNK, 2014)	46
Figura 5. Punësimi sipas sektorit dhe gjinisë në Shqipëri	53
Figura 6. Popullsia e Shqipërisë sipas vitit të censit (në milionë)	60

Lista of Tabelave

Tabela 1. Terminologjia kryesore lidhur me riskun dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	45
Tabela 2. Angazhimet e qeverisë për integrimin e aspekteve gjinore në politikat për klimën	48
Tabela 3. Marrëveshjet ndërkombëtare kryesore për aspektet gjinore, mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në të cilat Shqipëria ka ndërmarrë angazhime	48
Tabela 4. Proceset me përgjegjshmëri gjinore të PKP-së: Çështjet themelore për t'u marrë në konsideratë nga ekipet e PKP-së	68

Lista e Shkurtesave dhe Shkurtimeve

KKK (KK4)	Komunikimi i Katërt Kombëtar
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
OSHC	Organizatë e shoqërisë civile
MRF	Menaxhimi i riskut nga fatkeqësitë
PVBGJ	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore
DHBGJ	Dhuna me bazë gjinore
IBGJ	Indeksi i barazisë gjinore
GES	Gaz me efekt serrë
GNPNK	Grupi Ndërmintor i Punës për Ndryshimet Klimatike
PNNK	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
M-V	Monitorimi dhe vlerësimi
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MFE	Ministri e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PKP	Plani Kombëtar i Përshtatjes
KKP	Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar
OJQ	Organizatë joqeveritare
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
AFPT	Arsimi dhe formimi profesional teknik
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
KKKBNK	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

Përmbledhje ekzekutive

Procesi i Planit Kombëtar të Përshtatjes të Shqipërisë (PKP) përfaqëson një mundësi thelbësore për të trajtuar dimensionet gjinore të ndryshimeve klimatike në sektorët kyç të ekonomisë. Ky Plan Veprimi për Barazinë Gjinore ofron një kuadër gjithëpërfshirës për integrimin e aspekteve gjinore në përpjekjet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe pranon faktin se ndikimet e ndryshimeve klimatike prekin në mënyra të ndryshme gratë dhe burrat si pasojë e pabarazive ekzistuese sociale, ekonomike dhe kulturore.

Plani fokusohet në pesë sektorë prioritarë: **bujqësia dhe pylltaria, turizmi, zhvillimi urban, energjia dhe transporti.**

Analiza identifikon një hendek gjinor të konsiderueshëm në të gjithë sektorët dhe konstaton se gratë përballen me sfida joproporcionale në aksesimin e burimeve, në pjesëmarrjen në proceset e vendimmarrjes, si dhe në rritjen e qëndrueshmërisë ndaj ndikimeve klimatike. Në sektorin e **bujqësisë**, i cili kontribuon me 18,6% në PBB-në e Shqipërisë, janë të punësuar 440 872 persona (33,9% e totalit të personave të punësuar) dhe gratë përbëjnë 54,4% të totalit (239 775 punonjëse), ndërsa burrat 45,6% (201 097 punonjës). Ky sektor përballlet me cenueshmëri specifike klimatike, ku përfshihen përmytjet, thatësirat, modelet jokonsistente të reshjeve, rënia e produktivitetit të kulturave bujqësore dhe rritja e rasteve të shpërthimeve të dëmtuesve/insekteve të dëmshme. Gratë preken veçanërisht si pasojë e përfshirjes së tyre në detyra me ndjeshmëri ndaj klimës, si bujqësia në shkallë të vogël dhe përpunimi pas korrjes. Gratë përballen me sfida sistematike ku përfshihen, aksesimi i kufizuar në titujt e pronësisë së tokës, aksesimi i kufizuar në kredi bujqësore për shkak të mungesës së kolateralit, përjashtimi nga shërbimet e ekstensionit

bujqësor (vetëm 8%) dhe pjesëmarrja e ulët në arsimin profesional bujqësor (16%). Pavarësisht se përbëjnë shumicën e punonjësve në sektorin e bujqësisë, kontributet e grave vijnë të mos njihen dhe të nënvlerësohen ndjeshëm. Vetëm 10,8% e fermerëve të regjistruar zyrtarisht janë gra (rreth 25 896 nga numri total i fermerëve të regjistruar). Këto problematika thellohen edhe më tej si pasojë e rënies së efikasitetit të skemave të mbështetjes kombëtare për të arritur te gratë (nga 22% në vitin 2018 në 16% në vitin 2023, çka përfaqëson një rënie nga rreth 52 750 në 38 364 përfituese gra).

Sipas Strategjisë Kombëtare të Turizmit, 2024-2030, **sektori i turizmit** punëson 42 698 individë. Edhe pse kjo strategji nuk përmban të dhëna specifike për turizmin të ndara sipas gjinisë, të dhënat e INSTAT për vitin 2022 tregojnë se në kategorinë më të gjerë “Tregtia, transporti, akomodimi dhe ushqimi, dhe shërbimet e biznesit dhe administrative”, gratë përbëjnë 22,5% të fuqisë punëtore femra ndërsa burrat 30,9% të fuqisë punëtore meshkuj. Ndikimi te gratë është më i ndjeshëm pasi ato janë të përqendruara në pozicionet më të cenueshme ndaj ndryshimeve klimatike, si puna sezonale, punësimi informal dhe rolet e orientuara drejt shërbimit. Në rastet e

Gratë përbëjnë shumicën e fuqisë punëtore bujqësore të Shqipërisë

54%

ngjarjeve ekstreme të motit ose të ndryshimeve në modelet e turizmit, shpeshherë, gratë janë të parat që humbasin të ardhurat ose vendin e punës si pasojë e statusit të tyre të paqëndrueshëm të punësimit dhe aksesit të kufizuar në mundësi ekonomike alternative. Në sfidat specifike me të cilat përballen gratë bëjnë pjesë niveli i lartë në punësimin sezonal dhe informal pa pasur siguri në punë, niveli i ulët i përfaqësimit në rolet drejtuese dhe vendimmarrëse gjatë formulimit të strategjive të përshtatjes, aksesit i kufizuar në pozicione drejtuese, mundësitë më të pakta për zhvillim profesional, përgjegjësitë tradicionale të kujdesit për familjen, pengesat drejt sipërmarrjeve në fushën e turizmit të qëndrueshëm dhe mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë në sektorin e turizmit për të garantuar politikëbërje efikase.

Zhvillimi urban shfaq pabarazi gjinore të konsiderueshme. Më konkretisht, në sektorin e ndërtimit janë të punësuar 98 179 punonjës, nga të cilët 96,3% (94 593 punonjës) janë burra dhe vetëm 3,7% (3586 punonjës) janë gra. Ky sektor përballen me sfida specifike, ku përfshihen përkeqësimi i cilësisë së ajrit si pasojë e shkarkimeve bujqësore dhe industriale, ndotja nga plehu azotik, i cili ndikon në cilësinë e ujit dhe ajrit, si dhe ndikimet nga teknikat e prerjes dhe djegies së bimësisë.

Gratë përballen me sfida joproporcionale, ku përfshihen infrastruktura e dobët, veçanërisht në zonat periurbane ku 63% e grave raportojnë kushte sanitare të papërshtatshme, pjesëmarrja e kufizuar në proceset e planifikimit, shqetësimet e lidhura me sigurinë në hapësirat publike, niveli i shtuar i përgjegjësisë lidhur me kujdesin (rritje nga 75% në 79% gjatë krizave që përkthehet në 23 908 më shumë gra të prekura), niveli i ulët i përfaqësimit në rolet vendimmarrëse dhe aksesit i kufizuar në burimet në ekonomitë urbane informale.

Në **sektorin e energjisë**, ku janë të punësuar 35 508 punonjës, ekziston një pabarazi gjinore e theksuar, pasi burrat përbëjnë 84,9% (30 129 punonjës) të totalit ndërsa gratë 15,1% (5379 punonjës). Gratë përballen me ndikime joproporcionale si pasojë e rolit të tyre kryesor në administrimin e energjisë elektrike në familje, pavarësisht ndikimit të kufizuar në politikat për energjinë. Varfëria energjetike ndikon veçanërisht familjet me kryefamiljare gra, aty ku kostot e shërbimeve utilitare shkojnë deri në 17% të shpenzimeve. Sfidat strukturore të sektorit përfshijnë: një hendek gjinor të pagave prej 8,2%, mungesë të të dhënave të ndara sipas gjinisë nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) në

Shqipëri, si dhe përfaqësim të ulët të grave në pozicione teknike dhe drejtuese. Fakti që 98% e sektorit varet nga energjia hidrike është një faktor që amplifikon cenueshmërinë nga ndryshimet klimatike, çka ndikon veçanërisht tek aksesin në energji dhe përballueshmëria e kostove nga familjet me kryefamiljare gra dhe familjet me një prind. Kombinimi i varfërisë energjetike, cenueshmërisë nga ndryshimet klimatike dhe pabarazisë gjinore krijon sfida të thella lidhur me kapacitetin për përshtatje.

Sektori i transportit shfaq pabarazi gjinore të theksuara dhe më konkretisht, burrat përbëjnë 91,9% të fuqisë punëtore ndërsa gratë vetëm 8,1%. Cenueshmëria e grave nga ndryshimet klimatike rritet akoma më tepër si pasojë e nivelit të lartë të përdorimit të transportit publik nga ana e tyre (60%). Sfidat me specifike gjinore përfshijnë opsionet e kufizuara të transportit rural, gjë që ndikon në aksesin në shërbimet thelbësore, si dhe rritjen e cenueshmërisë nga ngjarjet ekstreme të motit si pasojë e varësisë nga transportit publik. Niveli i ulët i përfaqësimit të grave në pozicionet vendimmarrëse i thëllon këto cenueshmëri duke kufizuar planifikimin e përshtatjes dhe zhvillimin e infrastrukturës me përgjegjshmëri gjinore. Strategjitë për qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike në këtë sektor kërkojnë vëmendje të veçantë për modelet e lëvizshmërisë dhe kërkesat e sigurisë së grave, veçanërisht gjatë ngjarjeve ekstreme të motit.

Për të trajtuar këto sfida, Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore nënvizon një grup ndërhyrjesh gjithëpërfshirëse në të gjithë sektorët. Në bujqësi, veprimet e propozuara fokusohen në përmirësimin e aksesit të grave në **pronësinë e tokës, kreditë dhe shërbimet e ekstensionit**, duke nxitur njëkohësisht pjesëmarrjen e tyre në **praktikat bujqësore të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike**. Veprimet në sektorin e turizmit për integrimin e aspekteve gjinore në masat për përshtatjen e vënë theksin te nxitja e **sipërmarrjeve të grave** në fushën e turizmit të qëndrueshëm dhe në zhvillimin e **strategjive me**

përgjegjshmëri gjinore për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë për fushat e turizmit.

Veprimet për zhvillimin urban u japin prioritet integritit të aspekteve gjinore në planifikimin urban dhe zhvillimin e infrastrukturës, me fokus të veçantë te siguria, aksesueshmëria dhe shërbimet thelbësore. Ndërhyrjet në sektorin e energjisë fokusohen në trajtimin e sfidave kryesore gjinore sektoriale, si varfëria energjetike përmes nxitjes së **politikave me përgjegjshmëri gjinore** dhe pjesëmarrjes së grave në **iniciativat e energjisë së rinovueshme**. Masat gjinore në sektorin e transportit e vënë theksin te përmirësimi i **sigurisë dhe besueshmërisë së transportit publik**, si dhe te rritja e përfaqësimit të grave në proceset e vendimmarrjes të lidhura me sektorin e transportit. Janë përfshirë gjithashtu një sërë veprimesh **ndërsektoriale** për të trajtuar ngritjen e kapaciteteve institucionale, financimet për klimën, edukimin dhe kërkimet, ndërgjegjësimin e publikut, si dhe monitorimin dhe vlerësimin.

Për të arritur sukses në zbatimin e këtij Plani Veprimi për Barazinë Gjinore nevojitet **koordinim i fortë institucional**, burime të përshtatshme financiare (të cilat paraqiten në detaje në PKP, Planin e Zbatimit të PKP-së dhe dokumentet e strategjisë së financimit të PKP-së), si dhe angazhim i qëndrueshëm politik. Plani nënvizon rëndësinë e mbledhjes së **të dhënave të ndara sipas gjinisë** me qëllimin për të informuar vendimet e politikave dhe për të monitoruar progresin. Rishikimi dhe përditësimi periodik i planit do të garantojë ruajtjen e rëndësisë dhe të efikasitetit të tij në nxitjen e masave të përshtatjes me përgjegjshmëri gjinore ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri.

Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore është në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë, duke përfshirë me **Marrëveshjen e Parisit, detyrimet e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave**

(CEDAW), si dhe me **kërkesat e anëtarësimit në BE**. Gjithashtu, plani mbështet prioritetet kombëtare të parashikuara në **Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore** dhe në strategjitë e zhvillimit për sektorë specifikë. Duke zbatuar këto masa, Shqipëria mund të rrisë efikasitetin e përpjekjeve të saj për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke nxitur njëkohësisht barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale në të gjithë sektorët e shoqërisë.

Zbatimi dhe qëndrueshmëria afatgjatë e këtij Plani Veprimi për Barazinë Gjinore mbështeten te përpjekjet e koordinuara dhe angazhimi i përbashkët i një sërë palëve të interesit. **Aktorët kryesorë institucionalë**, duke filluar nga ministritë dhe institucionet e qeverisjes vendore, e deri tek institucionet kërkimore, duhet të punojnë në bashkëpunim me **organizatat komunitare, organizatat për të drejtat e grave dhe liderët në komunitet**. Inovacioni dhe burimet e sektorit privat, së bashku me ekspertizën teknike dhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë për zhvillim, do të jenë thelbësore për të përkthyer objektivat ambiciozë në rezultate konkrete. Përmes kuadrove të monitorimit dhe vlerësimit sistematik, Shqipëria do të mbikëqyrë transformimin drejt strategjive të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike më gjithëpërfshirëse, efektive dhe të barabarta, duke u siguruar që ndërhyrjet t'u shërbejnë realisht nevojave të shumëllojshme të të gjithë popullsisë. Kjo qasje gjithëpërfshirëse për angazhimin dhe llogaridhënien e palëve të interesit do të përcaktojë suksesin e planit në arritjen e ndryshimeve pozitive afatgjata për shoqërinë shqiptare.

Duke zbatuar Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore, Shqipëria synon të zhvillojë strategji të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike më gjithëpërfshirëse, efektive dhe të barabarta, të cilat trajtojnë nevojat dhe cenueshmëritë specifike të burrave dhe grave. Kjo qasje jo vetëm që rrit qëndrueshmërinë e vendit ndaj ndryshimeve klimatike, por kontribuon gjithashtu në objektivat më të gjerë të barazisë gjinore dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

01

Hyrje

Ky Plan Veprimi për Barazinë Gjinore synon të integrojë aspektet gjinore në procesin e Planit Kombëtar të Përshtatjes të Shqipërisë, duke u siguruar që masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike t'u përgjigjen nevojave dhe cenueshmërive unike të grave dhe burrave.

Për zhvillimin e këtij plani është realizuar një shqyrtim i thelluar i literaturës dhe janë shqyrtuar dokumentet kyç si raportet e PNNK-së, udhëzimet e KKKBNK-së dhe politikat përkatëse kombëtare. Është realizuar një analizë gjinore sipas sektorëve, e cila ka analizuar pabarazitë gjinore dhe cenueshmëritë e ndryshme në secilin prej pesë sektorëve prioritarë të parashtruar në PKP-në e Shqipërisë.

Është zbatuar qasja me pjesëmarrje dhe është angazhuar një gamë e gjerë e palëve të interesit, duke përfshirë agjencitë qeveritare, organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët e çështjeve gjinore.

Struktura e dokumentit:

1. Hedh bazat dhe ofron konceptet thelbësore për të kuptuar lidhjen midis aspekteve gjinore dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.
2. Eksploron mënyrat se si ndryshimet klimatike ndikojnë në forma të ndryshme të gratë dhe burrat në pesë sektorët prioritarë.
3. Paraqet veprimet e projektuara për të trajtuar pabarazitë dhe cenueshmëritë e identifikuar.

1
OBJEKTIVI

Të nxisë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në kontekstin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në pesë sektorët prioritarë.

2
OBJEKTIVI

Të ofrojë një kuadër gjithëpërfshirës për veprimtaritë me përgjegjshmëri gjinore të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të iniciativave të përshtatjes.

3
OBJEKTIVI

Të identifikojë dhe trajtojë pabarazitë gjinore sipas sektorëve dhe cenueshmëritë e ndryshme në kuadër të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

4
OBJEKTIVI

Të harmonizojë përpjekjet e Shqipërisë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike me praktikatat më të mira ndërkombëtare për integrimin e aspekteve gjinore.

Dokumenti mbështetet nga tre shtojca gjithëpërfshirëse ku paraqiten informacione thelbësore dhe një analizë e detajuar:

Shtojca I: Konteksti kyç për aspektet gjinore dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike

- **Pjesa 1** prezanton përkufizimet kryesore lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
- **Pjesa 2** nënvizon angazhimet e qeverisë për të integruar aspektet gjinore në politikat për klimën. Shqipëria ka nënshkruar disa angazhime ndërkombëtare detyruese dhe jodetyruese në lidhje me barazinë gjinore.

Shtojca II: Analiza gjinore sektoriale paraqet një ekzaminim të thelluar të integritimit të aspekteve gjinore në masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, në të pestë sektorët prioritarë të PKP-së. Për çdo sektor (zhvillimi bujqësor dhe rural, turizmi, zhvillimi urban, energjia dhe transporti), shtojca ofron:

- Një analizë të detajuar të cenueshmërive me specifike gjinore ku shqyrtohet mënyra se si ndryshimet klimatike ndikojnë në forma të ndryshme të gratë dhe burrat në sektorin përkatës
- Një vlerësim të hendeqeve aktuale në integrimin e aspekteve gjinore në politikat dhe praktikatat sektoriale
- Një analizë të sfidave strukturore që pengojnë përshtatjen me përgjegjshmëri gjinore
- Rekomandime për përmirësimin e integritimit të aspekteve gjinore
- Raste studimore ku nënvizohen iniciativat e suksesshme me përgjegjshmëri gjinore dhe mësimet e nxjerra nga praktikatat më të mira në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

Kjo analizë sektoriale gjithëpërfshirëse shërben si bazë për rekomandimet dhe masat e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore, duke u siguruar që

ndërhyrjet të trajtojnë nevojat e dokumentuara dhe të mbështeten në qasje të konsoliduara paraprakisht.

Shtojca III: Objektivat gjithëpërfshirës për integrimin e aspekteve gjinore në PKP nënvizon çështjet kryesore që duhet të shqyrtojnë ekipet e PKP-së për të avancuar në proceset përkatëse ku përfshihen planifikimi, zbatimi, si dhe kuadrot e monitorimit dhe të vlerësimit.

Shtojca IV: Konsultimet me palët e interesit dokumenton procesin me pjesëmarrje që ka rezultuar në hartimin e këtij Plani Veprimi për Barazinë Gjinore, dhe rendit palët e konsultuara të interesit. Kjo transparencë në procesin e konsultimit tregon se zhvillimi i planit është bazuar në perspektiva të shumëllojshme dhe në përvojë praktike.

Në tërësinë e këtij dokumenti, lexuesit do të gjejnë koncepte dhe përkufizime kyç për të lehtësuar të kuptuarit e tij, si dhe raste studimore dhe shembuj që ilustrojnë zbatimin praktik të përshtatjes me përgjegjshmëri gjinore. Këto elemente, së bashkë me analizën e detajuar në shtojca, u sigurojnë vendimmarrësve dhe ekspertëve kuadrin teorik dhe udhëzimet praktike të nevojshme për të zbatuar masa efektive për përshtatjen me përgjegjshmëri gjinore ndaj ndryshimeve klimatike. Palët e interesit inkurajohen që ta lexojnë plotësisht këtë material duke pasur parasysh se çdo aspekt i përshtatjes me përgjegjshmëri gjinore mund të zbatohet në punën dhe në komunitetet e tyre. Përmes përpjekjeve kolektive, reagimi i Shqipërisë ndaj ndryshimeve klimatike mund të jetë efektiv dhe i barabartë, në mënyrë që askush të mos mbetet pas në rrugëtimin drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme.

02

**Të kuptuarit e
lidhjes midis
përshtatjes ndaj
Ndryshimeve
Klimatike dhe
Aspekteve Gjimore**

2.1 Historiku i vendit

Popullsia


Sipas shifrave për vitin 2025 të paraqitura nga Instituti Kombëtar i Statistikave popullsia e Shqipërisë është 2.363.314 banorë. Kjo shifër shënon një rënie të konsiderueshme krahasuar me të dhënat e Censit 2011, e cila ka ardhur si rezultat i emigracionit neto negativ dhe nivelit të ulët të lindshmërisë. Popullsia e Shqipërisë është tkurrur që nga viti 1990, si pasojë e nivelit të ulët të lindshmërisë dhe nivelit të lartë të emigracionit. Raporti i varësisë së të rinjve është ulur në **24%**, ndërsa raporti i varësisë së të moshuarve është rritur në **30,4%**. Në vitin 2023, moshja mesatare ishte **42,5 vite**, çka pasqyron një plakjen e popullsisë. Aktualisht, **19,7%** e popullsisë bën pjesë në grupmoshën **65 vjeç e lart**, ndërkohë që në vitin 2011 kjo shifër ishte **11,3%**.

Një tjetër tregues që vlen të theksohet është se banorët e Shqipërisë janë duke lëvizur drejt kryeqytetit pasi ka shumë më tepër mundësi (punësim, kujdes shëndetësor, arsim) krahasuar me qytetet më të vogla ose zonat rurale.

Afërsisht një e treta e popullsisë së Shqipërisë (31,6%) banon në qarkun e Tiranës. Qarku i dytë me përqindjen më të lartë të popullsisë është Fieri (10%), pasuar nga qarku i Elbasanit (9,7% e totalit të popullsisë). Kukësi dhe Gjirokastra janë qarqet me përqindjen më të ulët të popullsisë, përkatësisht 2,6 dhe 2,5 për qind të popullsisë.

Gjatë periudhës 2011-2023, të gjitha qarqet, me përjashtim të Tiranës, kanë regjistruar rënie të nivelit të popullsisë. Në terma absolutë, Elbasani dhe Shkodra kanë regjistruar rëniet më të mëdha të nivelit të popullsisë. Nga ana tjetër, popullsia në qarkun Tiranë është rritur me 1,2%, kryesisht për shkak të migrimit të brendshëm.

Figura 1. Shpërndarja e popullsisë sipas qarqeve



Treguesit socio-ekonomikë

Pavarësisht progresit të dukshëm ekonomik, standardet e jetesës në Shqipëri mbeten ndjeshëm më të ulëta krahasuar me ato në BE. Në vitin 2022, vlera e Indeksit të Zhvillimit Njerëzor arriti 0,79, duke e renditur Shqipërinë në kategorinë e vendeve me zhvillim njerëzor të lartë, përkatësisht në pozicionin e 69-të nga 189 vende.

Papunësia arriti nivelin më të ulët historik prej 11,4% në tremujorin e tretë të vitit 2019, ndërsa indeksi Gini për vitin 2020 regjistroi shifrën 29,4, çka tregon një përmirësim të masave kundrejt pabarazisë. Në vitin 2016 indeksi Gini për Shqipërinë ishte 34,6 (një vlerë më e ulët është më pozitive). Për të krijuar një ide më të qartë, në vitin 2020, indeksi Gini për Norvegjinë ishte 27,7 ndërsa për Italinë 34,8, çka do të thotë se renditja e Shqipërisë është diku midis këtyre vendeve¹.

Në vitin 2020, 22% e shqiptarëve jetonin nën kufirin kombëtar të varfërisë, çka përbënte një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2016 ku 23,7% e popullsisë jetonin nën kufirin kombëtar të varfërisë (Banka Botërore, 2020). Shkalla e varfërisë në zonat rurale është shumë më e lartë krahasuar me zonat urbane. Më konkretisht, incidenca e varfërisë në zonat rurale është pothuajse tre herë më e lartë krahasuar me Tiranën dhe dy herë më e lartë krahasuar me rajone të tjera urbane. Shqipëria është klasifikuar

si një vend me të ardhura mesatare-të larta nga Banka Botërore, me një nivel të produktit të brendshëm bruto (PBB, në dollarë amerikanë) që arrin 22,98 miliardë dollarë dhe PBB për frymë prej 8367,8 dollarë në vitin 2023.

Në vitin 2019, sektori i shërbimeve përbënte rreth 50% të PBB-së, industria dhe ndërtimi kontribuonin në rreth 20% të PBB-së, ndërsa bujqësia në rreth 19%. Bujqësia mbetet një sektor thelbësor që gjeneron mbi 60% të totalit të vlerës së shtuar. Në vitin 2017, qarqet Tiranë dhe Durrës regjistruan normat më të larta të rritjes së PBB-së në terma realë, ndërsa Vlora dhe Korça përjetuan rënie. Tirana zotëronte nivelin më të lartë të PBB-së për frymë, pasuar nga Fieri, ndërsa qarqet e tjera ishin nën mesataren kombëtare.

Sipas Portalit të Bankës Botërore për të Dhënat Gjinore për Shqipërinë, edhe pse vendi shfaq një barazi pothuajse të plotë në sektorin e arsimit, me nivele të shkrimit-leximit pothuajse

Figura 2. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (%)





Figura 3. Punësimi informal (%)



1. Indeksi Gini mat nivelin e devijimit të shpërndarjes së të ardhurave (ose në disa raste, të shpenzimeve për konsum) të individëve ose familjeve në një ekonomi, nga një shpërndarje krejtësisht e barabartë. Kurba e Lorenz-it tregon përqindjet kumulative të totalit të të ardhurave të marra në raport me numrin kumulativ të përfituesve/marrësve, duke filluar nga individët apo familjet më të varfra. Indeksi Gini mat sipërfaqen ndërmjet kurbës së Lorenz-it dhe një niveli hipotetik të barazisë absolute, të shprehur si përqindje ndaj sipërfaqes maksimale poshtë këtij niveli. Për rrjedhojë, një indeks Gini prej 0 përfaqëson barazi absolute, ndërsa një indeks prej 100 nënkupton pabarazi të plotë (Banka Botërore).

të barabarta ndërmjet grave (98,7%) dhe burrave (98,3%), dhe nivele të larta të përfundimit të arsimit të mesëm të ulët (91,5% për vajzat dhe 96,7% për djemtë), vazhdojnë të ekzistojnë hendeqe të konsiderueshme gjinore në aspektet e pjesëmarrjes ekonomike dhe pronësisë së aseteve. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore shfaq një pabarazi të dukshme. Më konkretisht, në vitin 2023, pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore ishte 52,8% ndërsa e burrave 67,7%. Në fushën e pronësisë së biznesit, Figura 2, hendequ është edhe më i theksuar. Gratë përbëjnë vetëm 22% të pronarëve të biznesit ndërsa burrat 78%. Të dhënat mbi përfshirjen financiare të vitit 2021 tregojnë se 45,7% e grave dhe 42,6% e burrave kanë llogari bankare. Të dhënat mbi pronësinë favorizojnë ndjeshëm burrat. Më konkretisht, 52,2% e burrave zotërojnë banesa, qoftë vetëm apo në bashkëpronësi, ndërsa në rastin e grave kjo shifër është 23,2%. Në anën pozitive, Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm në aspektin e përfaqësimit politik, ku në vitin 2023 gratë zotëronin 35,7% të vendeve në parlament dhe 41,3% të pozicioneve drejtuese në nivelit të lartë dhe të mesëm. Për sa i përket shëndetit dhe sigurisë, Shqipëria vazhdon të ketë një shkallë të ulët të vdekshmërisë amtare prej 8 vdekjesh për 100 000 lindje të gjalla dhe raporton një nivel më të ulët të dhunës nga partneri intim (13%) krahasuar me mesataren globale prej 27%.

2.2 Panoramë e integritit të aspekteve gjinore në Shqipëri

Kuadri ligjor për barazinë gjinore

Shqipëria ka ngritur një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për barazinë gjinore, i cili mbështetet në angazhimet ndërkombëtare dhe legjisllacionin kombëtar. Në rrafshin ndërkombëtar, Shqipëria ka ratifikuar disa marrëveshje detyruese, duke përfshirë Konventën e Këshillit

të Evropës të vitit 2011, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (“Konventa e Stambollit”) dhe Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).

Në nivel kombëtar, guri i themelit në legjisllacionin shqiptar për barazinë gjinore është ligji i vitit 2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Ky ligj themelor rregullon aspekte të ndryshme të barazisë gjinore, duke përfshirë mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e arsimit, punësimit dhe në fusha të tjera të jetës publike. Ky ligj përcakton një kuotë gjinore minimale prej 30% për pjesëmarrjen e grave në politikëbërje dhe sanksionon mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë nga të gjitha institucionet publike. Ligji parashikon gjithashtu ngritjen e Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore për të monitoruar zbatimin efektiv të ligjit në proceset legjisllative dhe të politikëbërjes, si dhe në proceset e planifikimit, buxhetimit dhe zbatimit. Kodi Zgjedhor ka pësuar ndryshime të konsiderueshme për të promovuar barazinë gjinore në përfaqësimin politik. Një ndryshim i vitit 2015 caktoi një kuotë gjinore prej 50% për kandidatët e këshillave vendorë. Kjo qasje u fuqizua më tej në vitin 2020 me miratimin e një kuote gjinore prej 30% për organet zgjedhore të njëjësive kryesore të qeverisjes vendore dhe për të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Ç’është më e rëndësishme, këto ndryshime mundësuan gjithashtu refuzimin e listave të kandidatëve që nuk respektonin kuotat gjinore, duke zëvendësuar sistemin e mëparshëm të gjobave, i cili ishte jo efektiv.

Shqipëria ka ndërmarrë gjithashtu hapa për të trajtuar dhunën me bazë gjinore përmes ndryshimeve në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Ndryshimet në vitet 2018 dhe 2020 mundësuan përfshirjen e dispozitave të rëndësishme, në përputhje me Konventën e Stambollit dhe Konventën CEDAW. Aspektet barazisë gjinore janë integruar në proceset e

buxhetimit të Shqipërisë. Bazuar në ndryshimet e vitit 2016 në ligjin organik për buxhetin, barazia gjinore është një nga parimet bazë të sistemit buxhetor, dhe udhëzimet standarde për buxhetin, të cilat publikohen çdo vit, përmbajnë aspektin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si pjesë të kriteve të vendit lidhur me buxhetin. Që nga viti 2019². Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar (SIMF) në Shqipëri përfaqëson një instrument gjurmimi për alokimet e buxhetit me përgjegjshmëri gjinore dhe që nga viti 2022, projektbuxheti shoqërohet zyrtarisht nga një Deklaratë e Buxhetit Gjinor.

Progresi në fushën e barazisë gjinore

Shqipëria ka bërë përpjekje të konsiderueshme në përmirësimin e barazisë gjinore, siç faktohet edhe nga performanca e saj në treguesit ndërkombëtarë. Sipas Indeksit Global të Hendekut Gjinor 2023 të Forumit Ekonomik Botëror, Shqipëria renditet në vendin e 17-të nga 146 shtete, çka tregon një progres të konsiderueshëm në mbylljen e hendekut gjinor në sektorë të ndryshëm. Për më tepër, Shqipëria ka një vlerësim relativisht të mirë në Indeksin për Barazinë Gjinore (GEI) të BE-së, përkatësisht 60,4 nga 100 pikë. Edhe pse ky rezultat është për t'u vlerësuar, ai mbetet shtatë pikë nën mesataren e 28 shteteve anëtare të BE-së, çka tregon se ka hapësirë për përmirësim³.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe plani i saj i veprimit tregojnë një angazhim të fortë në drejtim të zbatimit të të drejtave të të gjitha grave dhe burrave, veçanërisht të atyre që përballen me forma të ndërlidhura të diskriminimit dhe cenueshmërisë. Kjo strategji gjithëpërfshirëse e vë theksin te mbështetja për

të rinjtë dhe reformat sociale, si dhe përfshin dispozita për emergjencat humanitare⁴.

Janë shënuar përmirësime lidhur me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Përkatësisht, 9% e buxhetit afatmesëm mbështet specifikisht rezultatet për barazinë gjinore. Kjo përfaqëson një zhvillim të konsiderueshëm për të garantuar që burimet financiare të alokohen në një mënyrë të tillë që promovon barazinë gjinore në sektorë dhe iniciativa të ndryshme⁵.

Gratë në pozicione drejtuese

Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm në drejtim të përfaqësimit të grave në pozicione drejtuese, veçanërisht në sferën politike. Sipas hartës globale “Gratë në politikë: 2023”, të zhvilluar nga UN Women dhe Unioni Ndërparlamentar, Shqipëria renditet e para në nivel global për përqindjen e grave ministre në kabinetin qeveritar. Kjo arritje përfaqëson një pikë të rëndësishme në promovimin e barazisë gjinore në nivelet më të larta të qeverisë.

Për sa i përket përfaqësimit në parlament, Shqipëria renditet në vendin e 42-të në nivel global për përqindjen e grave në parlament. Kjo përbën një përmirësim me 12 vende krahasuar me vitin 2021 kur Shqipëria renditej në pozicionin e 54-t. Rritja e nivelit të përfaqësimit në parlament mund t'i atribuohet gjithashtu zbatimit të kuotave gjinore dhe masave të tjera që synojnë nxitjen e pjesëmarrjes së grave në politikë⁶.

Përfaqësimi i grave është rritur gjithashtu në nivel vendor, edhe pse në një masë më të ulët krahasuar me nivelin qendror. Në zgjedhjet e vitit 2019, 44% e vendeve në këshillat vendorë u fituan nga gratë.

2. Ligji nr. 57, datë 2.6.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”” (të ndryshuar)

3. Forumi Ekonomik Botëror. (2023). Raporti Global i Hendekut Gjinor 2023

4. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, Shqipëri

5. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shqipëri. (2022). Raporti për buxhetin

6. UN Women dhe Unioni Ndërparlamentar. (2023). Gratë në hartën politike

Megjithatë, përfaqësimi i grave në pozicione drejtuese mbetet i ulët, pasi vetëm 8 nga 61 bashki (13%) kanë zgjedhur kryetare bashkie gra. Kjo shifër është më e ulët se mesatarja e BE-së dhe tregon se nevojiten përpjekje të mëtejshme për të promovuar liderhipin e grave në nivelin e qeverisjes vendore⁷.

Edhe pse këto arritje janë për t'u vlerësuar, vazhdojnë të ekzistojnë sfida në zbatimin e plotë të masave të barazisë gjinore dhe integrimin e aspekteve gjinore në të gjithë sektorët. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të garantuar që rritja e përfaqësimit të grave të përkthehet në ndikim konkret në proceset e vendimmarrjes në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Pabarazitë gjinore në aspektet e punësimit, varfërisë dhe përjashtimit social

Pavarësisht progresit të bërë në fushën e barazisë gjinore, vazhdojnë të ekzistojnë pabarazi të konsiderueshme në aspektet e punësimit, varfërisë dhe përjashtimit social. Sipas raportit Burra dhe Gra 2023, pjesëmarrja e grave (të grupmoshës 15-64) në fuqinë punëtore është rritur në 66,7%, por mbetet ende nën nivelin e burrave. Norma e punësimit për gratë kapte shifrën 58,9%, ndërsa për burrat 71,3%, çka tregon një hendek të konsiderueshëm gjinor në punësimin formal.

Nivelet e mosaktivizimit të grave lidhen kryesisht me nivelin arsimor ose trajnimin (18,3%) dhe me detyrat në familje (16,9%). Nga ana tjetër, nivelet e mosaktivizimit të burrave lidhen kryesisht me nivelin arsimor (25%). Kjo pabarazi nënvizon barrën joproporcionale të përkujdesit dhe punës së papaguar në familje që mbajnë gratë, e cila mund të kufizojë mundësitë e tyre për punësim formal dhe zhvillim ekonomik.

Gjithashtu, vijojnë të ekzistojnë pabarazi në fushën

e shëndetit. Më konkretisht, 15,4% e popullsisë raportuan nevoja mjekësore të paplotësuar në vitin 2021. Gratë përballen me sfida më të mëdha se burrat në aksesimin e shërbimeve të nevojshme të kujdesit shëndetësor, çka mund të ketë implikime afatgjata për mirëqenien e tyre dhe pjesëmarrjen ekonomike.

Varfëria dhe përjashtimi social mbeten problematika të konsiderueshme, ndërsa pragu i rrezikut nga varfëria ka regjistruar një rritje të lehtë në vitin 2022. Shkalla e rrezikut nga varfëria u rrit në 22,0%, ndërsa shkalla e thelluar e privimit material u rrit në 35,2%. Vajzat dhe gratë vazhdojnë të përballen me një rrezik më të lartë nga varfëria dhe përjashtimi social krahasuar me burrat, veçanërisht gratë e papuna dhe ato të grupmoshës 0-17 vjeç. Kjo pabarazi gjinore në fushën e rrezikut nga varfëria nënvizon nevojën për ndërhyrje të synuara për të trajtuar cenueshmëritë ekonomike me të cilat përballen gratë dhe vajzat⁸.

Barra joproporcionale e përkujdesit dhe punës së papaguar në familje që mbajnë gratë ka implikime të konsiderueshme në fuqizimin e tyre ekonomik dhe në mirëqenien e tyre të përgjithshme. Ndër individët e punësuar, gratë kanë më shumë gjasa që të jenë të punësuar me pagë (45,4%) ose punëtore pa pagesë në biznesin e familjes (23,5%), ndërsa burrat kanë nivele më të larta të vetëpunësimit (33,1%). Kjo shpërndarje e punës pasqyron dhe përforcon pabarazitë gjinore në fuqinë punëtore dhe kontribuon në cenueshmërinë ekonomike të grave.

Dhuna me bazë gjinore (DHBGJ)

Shqipëria ka bërë përpjekje për të trajtuar dhunën me bazë gjinore përmes masave të politikave dhe iniciativave të ndryshme. Këto përpjekje përfshijnë

7. <https://www.unwomen.org/sites/default/files/2022-01/Womens-representation-in-local-government-en.pdf>

8. INSTAT. (2022). Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës

rritjen e ndihmës ekonomike për viktimat e dhunës në familje, si dhe programe trajnimi për ofruesit e kujdesit shëndetësor për t'iu përgjigjur më mirë rasteve të DHBGJ-së. Ngritja e mekanizmave të referimit për dhunën me bazë gjinore në nivel vendor, përkatësisht në 61 bashki, përbën një hap të madh drejt ofrimit të mbështetjes në nivel komuniteti.

Sipas Raportit të monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, policia ka trajtuar 5210 raste të dhunës në familje, nga të cilat 72% përfshinin viktimat femra. Janë nisur procedime penale në 1887 raste, të cilat kanë rezultuar në 682 arrestime. Qendra e financuar nga shteti, Qendra Liliu, ka ndihmuar 36 gra viktimat të dhunës seksuale, duke ofruar shërbime mbështetëse thelbësore⁹.

Megjithatë, vijojnë të ekzistojnë sfida në ofrimin e mbështetjes gjithëpërfshirëse për të mbijetuarat e DHBGJ-së dhe harmonizimin e kuadrove ligjorë me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë me Konventën e Stambollit. Vazhdojnë të mungojnë financimet e posaçme shtetërore për shërbimet sociale për të mbijetuarat e DHBGJ-së, të cilat ofrohen kryesisht nga organizatat e shoqërisë civile, çka mund të kufizojë shtrirjen dhe efikasitetin e tyre. Për më tepër, ekziston nevoja për të fuqizuar mekanizmat e referimit në nivel vendor dhe për të përmirësuar programet e rehabilitimit për të mbijetuarat¹⁰.

Gjithashtu, nevojiten përpjekje për të rritur aksesin në shërbimet e kujdesit shëndetësor për grupet e marxhinalizuara, ku përfshihen gratë në zonat rurale, gratë romë dhe egjiptiane dhe individët nga komuniteti LGBTIQ, të cilat mund të përballen me pengesa shtesë për të kërkuar ndihmë dhe mbështetje në rastet e dhunës me bazë gjinore.

Ndikimet e ndryshimeve klimatike

Ndikimet e ndryshimeve klimatike nuk janë neutrale nga pikëpamja gjinore. Ndryshimet klimatike prekin në mënyrë joproporcionale grupet e cenueshme (PNNK, 2022; KKKBNK, 2022). Ndikimet aktuale dhe të ardhshme të ndryshimeve klimatike do të prekin më ashpër veçanërisht gratë, si pasojë e ndryshimeve që ekzistojnë ndërmjet grave dhe burrave në fushën e arsimit, shëndetit, punësimit, aksesit dhe kontrollit të burimeve natyrore dhe financiare, si dhe përfshirjes në proceset politike dhe të vendimmarrjes. Për më tepër, cenueshmëria relative e individëve do të përcaktohet nga niveli i qëndrueshmërisë së jetesës së tyre, aftësia për të garantuar “mbrojtje individuale”, niveli i mbrojtjes sociale që përfitojnë dhe qeverisja e përgjithshme, si marrëdhëniet e pushtetit dhe mjedisi institucional (KKKBNK, 2022).

Në kuadër të agjendës së anëtarësimit në BE, Shqipëria ka bërë progres në harmonizimin e kuadrit të saj ligjor për ndryshimet klimatike dhe barazinë gjinore me legjislacionin e BE-së (acquis) dhe standardet ndërkombëtare. Ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike” rregullon aktualisht aspektet e ndryshimeve klimatike në Shqipëri dhe përcakton se Ministria e Mjedisit është institucioni më i lartë qeveritar në nivel kombëtar përgjegjës për aspektet e lidhura me ndryshimet klimatike, pika qendrore kombëtare e KKKBNK-së dhe institucioni përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe menaxhimin e matjes së të dhënave, raportimin dhe verifikimin për përgatitjen e komunikimeve kombëtare dhe të raporteve të përditësimit dyvjeçar, si dhe për përgatitjen, zbatimin dhe raportimin rreth KKP-së. Edhe pse versioni aktual i ligjit nuk parashikon në mënyrë eksplicite integrimin e aspekteve gjinore në politikat për ndryshimet klimatike, është e rëndësishme të theksohet se ky ligj është

9. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2022). Raporti i monitorimit të SKBGj-së

10. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2022). Raporti i monitorimit të SKBGj-së

aktualisht duke u rishikuar. Versioni i rishikuar parashikohet se do ta trajtojë këtë mangësi, duke integruar aspektet gjinore në kuadrot e politikave për klimën.

Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar (KKP) i rishikuar në përputhje me Paketën e Zotimit për Klimën ofron një mundësi për të ndërlidhur ndryshimet klimatike dhe barazinë gjinore, duke nxitur zhvillimin gjithëpërfshirës dhe duke fuqizuar kapacitetet kombëtare. Strategjia e re Kombëtare për Barazinë Gjinore për Shqipërinë përfshin, për herë të parë, një fokus të fortë tek emergjencat dhe parandalimi i riskut nga fatkeqësitë, ndërsa angazhimet kombëtare për ndryshimet klimatike përmbajnë referenca për barazinë gjinore.

Përfshirja e një kapitulli për integrimin e aspekteve gjinore në politikat dhe programet që trajtojnë ndryshimet klimatike në Komunikimin e Katërt Kombëtar (KKK) është një hap pozitiv. Anketa gjithëpërfshirëse e realizuar në kuadër të KKK-së hedh dritë mbi pabarazitë gjinore në perceptimin dhe trajtimin e ndryshimeve klimatike. Anketa tregoi se 39% e të anketuarve besojnë se ekzistojnë dallime ndërmjet aftësive të burrave dhe grave për të reaguar ndaj ndryshimeve klimatike, dhe 53% prej tyre pohuan se meshkujt janë më të aftë për të trajtuar ndryshimet klimatike. Në vijim, analiza tregon se gratë, të cilat janë të angazhuara masivisht në bujqësi, veçanërisht në aktivitetet blegtorale, mbajnë një peshë joproporcionale lidhur me rreziqet klimatike. Përfaqësimi i burrave në pozicione administrative në ferma, si dhe roli i tyre mbizotërues në marrjen e vendimeve financiare dhe për investimet në familje, thellon më tej pabarazitë gjinore. Të anketuarit konstatuan gjithashtu se liria për t'u larguar nga fshatrat u përket kryesisht burrave. Sipas raportit Burra dhe Gra 2023, një pjesë e

konsiderueshme e kësaj problematike lidhet me sektorin e bujqësisë, ku përfshirja e grave është në nivele mjaft të larta, përkatësisht 40,1%, krahasuar me 28,7% të burrave. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e sektorit të bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike, veçanërisht në një vend si Shqipëria që mbështetet ndjeshëm te bujqësia, ky sektor goditet i pari, dhe në një shkallë më të fortë, nga efektet e ndryshimeve klimatike. Një shembull ilustrues është rënia e prodhimit bujqësor në fshatin Verri në Fier, e cila i atribuohet ndikimit negativ që ka një impiant i djegies së mbetjeve (incinerator) në këtë zonë, tek toka e punueshme. Gratë, të cilat mbajnë një peshë të konsiderueshme në sektorin e bujqësisë, kanë ndjerë veçanërisht pasojat në jetesën e tyre¹¹

Për më tepër, sipas KKP-së së rishikuar të Shqipërisë, gratë shtatzëne përballen me rreziqe të shtuara si pasojë e ndërprerjes së aksesit në kujdes shëndetësor në periudhat pas fatkeqësisë, çka i bën ato më të cenueshme ndaj sëmundjeve të rrugëve të frymëmarrjes, infeksioneve gjatë përpjekjeve për pastrim dhe temperaturave ekstreme. Gjithashtu, gratë vazhdojnë të përballen me pengesa të konsiderueshme që i pengojnë të gëzojnë të drejta të barabarta. Aksesit i tyre në asete mbetet tejet i kufizuar, gjë që rezulton në status më të ulët ekonomik krahasuar me burrat, veçanërisht në fusha si pagat, zotërimi i pronave, pensionet, trashëgimia dhe pronësia e tokës. Për më tepër, gratë kanë një nivel më të lartë përfaqësimi në sektorin informal dhe në punët me pagë të ulët, dhe një nivel përfaqësimi shumë më të ulët ndër pronarët e shoqërive me ndikim, veçanërisht në sektorët teknikë si energjia dhe transporti. Pavarësisht se përbëjnë pjesën më të madhe të fuqisë punëtore në bujqësi, shpeshherë gratë nuk gëzojnë të drejta mbi pronësinë e tokës, çka thellon më tej pabarazitë gjinore.

11. Rrjeti i Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore (2019). Raport i organizatave të shoqërisë civile lidhur me zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit në Shqipëri, Pekin +25. Shihni: <https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/Get%20Involved/Beijing-25/Generation-Equality-Forum/csO-Beijing-report-Albania-en.pdf>

Në kuadër të procesit të Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP) të Shqipërisë, UNDP në Shqipëri udhëhoqi një përpjekje gjithëpërfshirëse për të integruar aspektet gjinore në zhvillimin e këtij plani. Kjo iniciativë përfshinte konsultime të gjera me palët e interesit dhe angazhimin e ekspertëve për të garantuar një qasje me përgjegjshmëri gjinore në të gjithë sektorët e prekur nga klima. Procesi i integrit të aspekteve gjinore nisi me një **analizë të plotë të kuadrit ekzistues ligjor dhe të politikave të Shqipërisë** për aspektet gjinore dhe ndryshimet klimatike. Analiza vlerësoi shkallën e trajtimit të çështjeve gjinore në politikat dhe strategjitë aktuale të lidhura me klimën dhe ofroi një bazë për përpjekjet e ardhshme për integrimin e aspekteve gjinore.

Me qëllim përmirësimit e **kapaciteteve institucionale**, u zhvillua një propozim për të përfshirë ekspertizë me përgjegjshmëri gjinore në **Grupin Ndërmintor të Punës për Ndryshimet Klimatike dhe Aspektet Gjinore (GNPNKAGj)**. U krijua një manual i veprimtarive për të drejtuar aktivitetet e GNPNKAGj-së, duke garantuar integrim konsistent dhe efektiv të aspekteve gjinore në punën e tij. Për më tepër, u formuluan udhëzime pune me specifike gjinore për përpjekjet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke lehtësuar kështu zbatimin në praktikë.

Procesi përfshiu një **vlerësim gjinor sipas sektorëve të Institutit të Gjeoshkencave (IGJEO)**, për të vlerësuar kapacitetin e tij për të integruar perspektivat gjinore në studimet dhe veprimtaritë e lidhura me klimën. Ky vlerësim siguroi të dhëna të vlefshme mbi situatën aktuale të integrit të aspekteve gjinore në institucionet shkencore që merren me ndryshimet klimatike. **Mbledhja dhe analiza e të dhënave** luajtën një rol thelbësor në procesin e integrit të aspekteve gjinore. U mblodhën të dhëna socio-ekonomike, të ndara sipas gjinisë, për të kuptuar ndikimet e ndryshme të ndryshimeve klimatike në disa grupe demografike.

U hartua një strategji për të trajtuar mangësitë në të dhëna dhe informacion, e cila garanton njohuri gjithëpërfshirëse mbi cenueshmëritë klimatike të lidhura me aspektet gjinore. Gjatë të gjithë procesit, iu dha prioritet **angazhimit të palëve të interesit**. U organizuan takime me punonjësit e ministrisë, deputetët e kuvendit dhe grupet e punës së kuvendit për ndryshimet klimatike, me qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe të ndërgjegjësimit. U zhvilluan konsultime me një gamë të gjerë palësh interesi, lista e plotë e të cilëve jepet në **shtojcën IV** të këtij dokumenti. Për të mbështetur **ngritjen e kapaciteteve**, u zhvilluan materiale për trajnim në distancë, me fokus tek aspektet gjinore dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike. U realizua një seminar me titull “Gjithëpërfshirja dhe qëndrueshmëria ndaj ndryshimeve klimatike: Integrimi i perspektivave gjinore”, për të forcuar njohuritë mbi përshtatjen me ndjeshmëri gjinore ndaj ndryshimeve klimatike në subjektet vendore. Ky seminar u fokusua në sektorë prioritarë si turizmi, zhvillimi urban, bujqësia, transporti dhe energjia.

Procesi përfshiu gjithashtu krijimin e **instrumenteve dhe udhëzimeve** për të mbështetur përpjekjet në proces për integrimin e aspekteve gjinore. U zhvilluan udhëzime për planifikimin e përshtatjes me ndjeshmëri gjinore ndaj ndryshimeve klimatike (PNK), si dhe tregues për PNK-në me specifike gjinore, për të garantuar përfshirjen sistematike të aspekteve gjinore në përpjekjet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri.

Ky proces gjithëpërfshirës i integrit të aspekteve gjinore kulmoi me zhvillimin e këtij Plani Veprimi për Aspektet Gjinore në kuadër të PKP-së. Plani ofron një qasje të strukturuar për integrimin e perspektivave gjinore në politikat dhe veprimet për ndryshimet klimatike në Shqipëri, duke u siguruar që aspektet gjinore të përfshihen në mënyrë sistematike në të gjitha fazat e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

2.3 Rëndësia e integritit të aspekteve gjinore në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike

Në nivel ndërkombëtar, Palët në KKKBNK kanë pranuar gjithashtu rëndësinë e përfshirjes së barabartë të grave dhe burrave në proceset e KKKBNK-së, si dhe në zhvillimin dhe zbatimin e politikave kombëtare me përgjegjshmëri gjinore për klimën, duke vendosur një pikë të veçantë në agjendën e Konventës për trajtimin e çështjeve gjinore dhe të ndryshimeve klimatike.¹² Këtu, vlen të theksohet Preambula e Marrëveshjes së Parisit (2021) ku paraqitet qasja që duhet të zbatohet Palët për të respektuar të drejtat e grupeve të cenueshme në të gjitha politikatat e lidhura me veprimet për klimën:

“Duke pranuar se ndryshimet klimatike janë një shqetësim i përbashkët i njerëzimit, Palët, kur marrin masa për të trajtuar ndryshimet klimatike, duhet të respektojnë, promovojnë dhe të marrin në konsideratë detyrimet e tyre përkatëse për të drejtat e njeriut, të drejtën për kujdes shëndetësor, të drejtat e popullatave indigjene, komuniteteve lokale, emigrantëve, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe personave në situata vulnerabël dhe të drejtën për zhvillim, si dhe barazinë gjinore, fuqizimin e grave dhe barazinë mes brezave.”

Lidhja midis barazisë gjinore dhe ndryshimeve klimatike është bërë gjithnjë e më tepër një pikë kyç në diskutimet dhe kuadrot e politikave për klimën. Një tregues i rëndësishëm i kësaj tendence mund të shihet qartësisht në planet kombëtare të përshtatjes (PKP) të dorëzuara nga shtetet përkatëse pranë KKKBNK-së, pasi më tepër se 97% e këtyre planeve përfshijnë, të paktën një herë, referenca për gratë. Kjo thekson rëndësinë e aspekteve gjinore në trajtimin e sfidave që vijnë nga ndryshimet klimatike.

PNNK-ja luan gjithashtu një rol thelbësor në këtë diskutim duke pranuar se dallimet në kapacitetet e përshtatjes ndërmjet burrave dhe grave e kanë origjinën te pabarazitë komplekse sociale, mjedisore, ekonomike dhe kulturore. Këto dallime ndikojnë ndjeshëm në cenueshmërinë e individëve ndaj rreziqeve klimatike dhe në aftësinë e tyre për të reaguar në mënyrë efektive. Duke analizuar dhe kuptuar këto dinamika me specifikë gjinore, politikëbërësit dhe ekspertët mund të identifikojnë dhe të trajtojnë më mirë cenueshmëritë dhe nevojat unike të grave dhe burrave në kontekstin e ndikimeve nga ndryshimet klimatike. Diçka e tillë është thelbësore për të zhvilluar dhe zbatuar veprime realisht efektive dhe gjithëpërfshirëse për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Për rrjedhojë, është thelbësore që përpjekjet për përshtatje, pavarësisht nëse ndërmerren në nivel politikash apo brenda komuniteteve, të integrojnë aspektet gjinore në mënyrë gjithëpërfshirëse. Veprimet që nuk marrin në konsideratë këto dimensione gjinore rrezikojnë të mos jenë efektive dhe mund të përshkallëzojnë më tej pabarazitë ekzistuese. Në thelb, miratimi i një qasjeje me përgjegjshmëri gjinore për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike nuk është thjesht një çështje e barazisë dhe drejtësisë sociale, por është gjithashtu thelbësore për të arritur rezultate të qëndrueshme dhe të përshtatshme në kontekstin e ndryshimeve klimatike.

Pranimi i faktit se ndryshimet klimatike kanë ndikime të ndryshme te burrat dhe gratë, sjell përfitime jo vetëm për gratë, por për shoqërinë në tërësi. Për shembull, duke kuptuar shumëllojshmërinë e cenueshmërive dhe rreziqeve përmes mbledhjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë, arrijmë të përmirësojmë eficiencën. Për shembull, studimet kanë treguar se gratë fermerë janë më të cenueshme ndaj ndryshimeve klimatike si

12. Të gjitha dokumentet e KKKBNK-së të lidhura me aspektet gjinore dhe ndryshimet klimatike mund të aksesohen këtu.

pasojë e aksesit të tyre të kufizuar në burime dhe mungesës së kompetencave vendimmarrëse në familje dhe komunitete¹³. Duke pasur parasysh këto të dhëna, mund të zhvillohen ndërhyrje të synuara për të mbështetur gratë fermere në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Këto ndërhyrje mund të përfshijnë sigurimin e farave rezistente ndaj ndryshimeve klimatike, ofrimin e trajnimeve mbi praktikatat e qëndrueshme bujqësore dhe garantimin e aksesit të barabartë në burimet dhe proceset e vendimmarrjes në familjet e fermerëve.

Duke trajtuar cenueshmëritë unike të grave në bujqësi, jo vetëm që fuqizojmë gratë për të përballuar më mirë ndikimet e ndryshimeve klimatike, por rrisim gjithashtu qëndrueshmërinë e sistemeve bujqësore. Kjo mund të sjellë rritjen e sigurisë ushqimore, përmirësimin e jetesës dhe rezultate më pozitive të zhvillimit të qëndrueshëm për komunitetet e prekura nga ndryshimet klimatike.

Ndryshimet klimatike vënë në rrezik zhvillimin socio-ekonomik dhe kanë ndikime të thella në të gjitha OZHQ-të, duke përfshirë tek OZHQ 5 “Barazi gjinore”. Në këtë kontekst, veprimet për përshtatje kanë potencialin të sjellin disa përfitime të përbashkëta në drejtim të punësimit, shëndetësisë, barazisë gjinore dhe ripërtëritjes së biodiversitetit, ndër të tjera.

Ekzistojnë ende hendeqe të konsiderueshme gjinore ndërmjet burrave dhe grave për sa i përket aksesit në arsim, aftësive të shkrimit dhe leximit, ndarjes së pabarabartë të punës dhe mundësive për gjenerimin e të ardhurave. Këto përbëjnë pengesa strukturore të cilat, krahas normave dhe besimeve tradicionale, rrisin cenueshmërinë e grave ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe cenojnë kapacitetin e tyre për përshtatje.

Aksesi i pabarabartë ndërmjet grave dhe burrave për sa i përket pronësisë së tokës dhe mundësive për kredi ndërthuret me cenueshmëritë mjedisore në mënyra të tilla që cenojnë aftësinë e grave për të kontribuar në mënyrë efektive në PNK. Kjo vlen veçanërisht për gratë në zonat rurale, jetesa e të cilave varet ndjeshëm nga burimet natyrore, si dhe për familjet me kryefamiljare gra të cilat mbajnë peshën e detyrave familjare krahas veprimtarive të sigurimit të jetesës dhe gjenerimit të të ardhurave. Këto mangësi duhet të tejkalohen në mënyrë që gratë dhe vajzat të përmbushin potencialin e tyre si agjentë të ndryshimit në kuadër të PNK-së.

13. Kabeer, N. (2016). Gender equality, economic growth, and women’s agency: The “endless variety” and “monotonous similarity” of patriarchal constraints (Barazia gjinore, rritja ekonomike dhe aftësitë e grave: “Shumëllojshmëria e pafundme” dhe “ngjashmëria monotone” e kufizimeve patriarkale). *Feminist Economics*, 22(1), 295-321.

03

Analiza Gjinore në Sektorët Kryesorë të PKP-së

Ky seksion paraqet një përmbledhje të analizës gjinore në sektorët kryesorë të parashtruar në Planin Kombëtar të Përshtatjes (PKP) të Shqipërisë, duke shqyrtuar mundësitë dhe sfidat me specifike gjinore në sektorët përkatës si, zhvillimi bujqësor dhe rural, turizmi, zhvillimi urban, energjia dhe transporti.

Përmbledhja për çdo sektor nënvizon pabarazitë aktuale gjinore, mangësitë në politika dhe rekomandimet për të nxitur përshtatjen me përgjegjshmëri gjinore ndaj ndryshimeve klimatike. Analiza mbështetet në studimet e kohëve të fundit, rishikimet e politikave dhe konsultimet me palët e interesit, me qëllim që të japë një panoramë gjithëpërfshirëse të integritit të aspekteve gjinore në këta sektorë kritikë. Për informacion të detajuar mbi analizat, të dhënat dhe metodologjitë sipas sektorëve, si dhe për rekomandimet e plota, referojuni shtojcës III.

3.1 Bujqësia dhe pylltaria

Aspektet gjinore janë thelbësore për përshtatjen e sektorit të bujqësisë, veçanërisht në kontekstin rural shqiptar. Gratë luajnë një rol të konsiderueshëm në sektorin e bujqësisë, ku shpeshherë menaxhojnë fermat familjare dhe kontribuojnë ndjeshëm në sigurinë ushqimore. Megjithatë, ato përballesh shpesh me akses të pabarabartë në burime, në pronësinë e tokës, në kredi dhe informacione bujqësore. Ndikimet e ndryshimeve klimatike, të tilla si ndryshimet në modelet e reshjeve dhe rritja e ngjarjeve ekstreme të motit, mund të ndikojë në mënyrë joproporcionale te gratë fermere për shkak të këtyre pabarazive ekzistuese. Integrimi i aspekteve gjinore në strategjitë e përshtatjes për sektorin bujqësor garanton trajtimin e nevojave dhe njohurive specifike të grave, duke përmirësuar qëndrueshmërinë e tyre ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo qasje mund të rezultojë në masa përshtatjeje më efektive, duke qenë se gratë

shpesh kanë njohuri tradicionale në lidhje me varietetet e kulturave dhe praktikave bujqësore, të cilat mund të jenë me vlerë për qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike. Përmes fuqizimit të grave në sektorin e bujqësisë nëpërmjet aksesit të barabartë në burime, trajnim dhe proceset e vendimmarrjes, Shqipëria mund të përforcojë kapacitetin e saj të përgjithshëm të përshtatjes së sektorit të bujqësisë dhe të promovojë një zhvillim rural më të qëndrueshëm dhe të barabartë ndaj ndryshimeve klimatike.

Sektorin bujqësor në Shqipëri përballet me pabarazi gjinore të konsiderueshme, veçanërisht në drejtim të politikave për klimën dhe bujqësinë. Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit (SBZHRP) 2021-2027 dhe ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike” shfaqin mangësi të konsiderueshme në trajtimin e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave. Nga totali i personave të punësuar në Shqipëri (1 298 380 persona), në sektorin e bujqësisë janë të punësuar 440 872 persona (33,9% e numrit total të të punësuarve). Gratë në bujqësi përbëjnë 40,1% të totalit të grave në fuqinë punëtore (239 775 nga 597 694 gra të punësuar), krahasuar me 28,7% të burrave (201 097 nga 700 686 burra të punësuar), ndërsa nëse vërejmë konkretisht fuqinë punëtore në sektorin bujqësor, gratë në përbëjnë 54,4% të të punësuarve në sektorin e bujqësisë, krahasuar me 45,6% të burrave. Ky përfaqësim më i lartë në sektorin e bën gratë më të ekspozuara ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike në sektorin e bujqësisë. (INSTAT, 2023). Sfidat kryesore përfshijnë aksesin e kufizuar në burime, nivelin e ulët të përfaqësimit në drejtim të regjistrimit të fermave (vetëm 10,8% e

regjistruarve janë gra), pjesëmarrjen minimale në shërbimet e ekstensionit bujqësor (8% janë përfituese gra), si dhe nivelin e ulët të grave të regjistruara në arsimin profesional bujqësor (16%). Skemat e mbështetjes dhe politikat kombëtare kanë treguar rënie të efikasitetit në përfshirjen e grave, pasi përfitueset femra kanë rënë nga 22% në vitin 2018 në 16% në vitin 2023.

3.2 Turizmi

Aspektet gjinore luajnë një rol jetik në strategjitë e përshtatjes së sektorit të turizmit, pasi ky i fundit përfshin dimensione gjinore të konsiderueshme që ndërthuren me ndikimet e ndryshimeve klimatike. Industria e turizmit shpesh punëson një përqindje të lartë të grave, veçanërisht në rolet e shërbimit, pozicionet sezonale dhe në sektorët informalë. Megjithatë, në shumë raste gratë janë të nënpërfaqësuar në rolet drejtuese dhe vendimmarrëse brenda industrisë. Ndryshimet klimatike mund t'i përshkallëzojnë këto pabarazi gjinore ekzistuese dhe të paraqesin sfida të reja. Strategjitë e përshtatjes në sektorin e turizmit duhet të marrin në konsideratë ndikimet e ndryshme të ndryshimeve klimatike mbi burrat dhe gratë brenda sektorit. Për shembull, ngjarjet ekstreme të motit ose ndryshimet në modelet e turizmit për shkak të ndryshimeve klimatike mund të prekin në mënyrë joproporcionale mjetet e jetesës së grave, veçanërisht të atyre që janë në pozicione të cenueshme ose pjesë e punësimit informal. Gratë gjithashtu mund të përballen me sfida më madhore për të aksesuar burimet, trajnimet dhe teknologjitë e nevojshme për t'u përshtatur ndaj kushteve të ndryshueshme në industrinë e turizmit.

Përshtatja me përgjegjshmëri gjinore e sektorit të turizmit mund të krijojë mundësi për fuqizimin ekonomik dhe qëndrueshmërinë ekonomike të grave. Kjo mund të përfshijë promovimin e liderit të grave në nismat e turizmit të qëndrueshëm, mbështetjen e bizneseve të

udhëhequra nga gratë në fushën e ekoturizmit ose të produkteve turistike të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike, dhe garantimin e aksesit të barabartë në programet e ngritjes së kapaciteteve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Për më tepër, strategjitë e përshtatjes duhet të marrin në konsideratë sigurinë dhe nevojat specifike të grave turistike dhe të grave që punojnë në industri, veçanërisht në kontekstin e rreziqeve të shtuara në lidhje me klimën.

Duke integruar aspektet gjinore në planet e përshtatjes së sektorit të turizmit, destinacionet mund të zhvillojnë strategji më gjithëpërfshirëse dhe efektive, të cilat jo vetëm që rrisin qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike, por edhe promovojnë barazinë gjinore brenda sektorit. Kjo qasje mund të rezultojë në zhvillim më të qëndrueshëm dhe të drejtë të turizmit, në dobi të komuniteteve dhe industrisë vendase përballë sfidave që paraqesin ndryshimet klimatike.

Sipas Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2024-2030, në sektorin e turizmit në Shqipëri janë të punësuar 42 698 individë. Edhe pse strategjia nuk ofron të dhëna të ndara sipas gjinisë specifike për turizmin, të dhënat e INSTAT për vitin 2022 tregojnë se në kategorinë më të gjerë "Tregtia, transporti, akomodimi dhe ushqimi, dhe shërbimet e biznesit dhe administrative", gratë përbëjnë 22,5% të fuqisë punëtore femra ndërsa burrat 30,9% të fuqisë punëtore meshkuj. Këto të dhëna mbi punësimin nxjerrin në pah nevojën për një analizë me specifike gjinore të cenueshmërive klimatike në sektorin e turizmit, veçanërisht duke marrë parasysh natyrën e punësimit ku shumë pozicione janë sezonale, informale ose të orientuara drejt shërbimeve, duke i bërë punonjësit potencialisht më të ndjeshëm ndaj problemeve ekonomike të lidhura me ndryshimet klimatike. Për më tepër, gratë mbeten të nënpërfaqësuar në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse, ku formulohen dhe zbatohen strategjitë e përshtatjes. Cenueshmëria e këtij

sektori thellohet më tej nga sfidat strukturore në tregun e punës në Shqipëri, duke përfshirë aksesin e kufizuar në pozicione drejtuese, mundësitë më të pakta për zhvillim profesional dhe përgjegjësitë tradicionale të kujdesit për familjen. Këta faktorë nxjerrin në pah nevojën kritike për strategji të përshtatjes me përgjegjshmëri gjinore ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin e turizmit, të cilat trajtojnë si ndikimet e drejtpërdrejta klimatike, ashtu edhe cenueshmëritë themelore socio-ekonomike, ndërkohë që promovojnë struktura punësimi më të qëndrueshme dhe të drejta në të gjithë sektorin. Një mangësi kritike në sektorin e turizmit në Shqipëri është mungesa e të dhënave gjithëpërfshirëse të ndara sipas gjinisë, çka pengon zhvillimin dhe monitorimin e politikave në mënyrë efektive. Sektori ofron potencial për fuqizimin ekonomik të grave përmes sipërmarrjes, veçanërisht në NVM dhe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe ofron mundësi punësimi fleksibël që mund të mbështesin gjetjen e ekuilibrit midis jetës profesionale dhe asaj personale.

3.3 Zhvillimi Urban

Aspektet gjinore janë thelbësore për strategjitë e përshtatjes së sektorit të zhvillimit urban për shkak të mënyrave të ndryshme se si burrat dhe gratë i përjetojnë dhe bashkëveprojnë me mjediset urbane. Zonat urbane janë sisteme komplekse ku ndikimet e ndryshimeve klimatike ndërthuren me faktorët socialë, ekonomikë dhe infrastrukturorë, shpeshherë duke i përshkallëzuar pabarazitë gjinore ekzistuese. Gratë, veçanërisht ato nga grupet e marginalizuara, mund të përballen me cenueshmëri të shtuara në mjediset urbane për shkak të faktorëve të tillë si aksesin e kufizuar në burime, nivele më të ulëta të të ardhurave dhe përgjegjësitë parësore të përkujdesit.

Masat e përshtatjes në sektorin e zhvillimit urban duhet të trajtojnë nevojat me specifike gjinore në fusha si strehimi, transporti, hapësirat publike dhe

shërbimet thelbësore. Për shembull, shqetësimet e grave për sigurinë në hapësirat publike dhe sistemet e transportit mund të kufizojnë lëvizshmërinë e tyre dhe aksesin në mundësitë ekonomike. Planifikimi urban me përgjegjshmëri gjinore mund të rrisë sigurinë përmes përmirësimit të ndriçimit, projektimit të hapësirave publike dhe opsioneve të transportit. Për më tepër, rolet e grave në ekonomitë informale dhe në menaxhimin e familjeve i bëjnë ato palë interesi kyç për përpjekjet e qëndrueshmërisë urbane, të tilla si menaxhimi i mbetjeve dhe nismat e përshtatjes të bazuara në komunitet.

Përfshirja e grave në proceset e planifikimit urban dhe të vendimmarrjes garanton integrimin e pikëpamjeve dhe nevojave të tyre në strategjitë e përshtatjes. Kjo mund të rezultojë në zgjidhje urbane më gjithëpërfshirëse dhe efektive, të tilla si sistemet e përmirësuar të ujësjellës-kanalizimeve që marrin në konsideratë nevojat specifike të grave ose hapësirat e gjelbra që janë të përshtatshme për grupe të ndryshme përdoruesish. Duke integruar aspektet gjinore në përshtatjen e sektorit të zhvillimit urban, qytetet mund të bëhen më të qëndrueshme teksa avancojnë njëkohësisht barazinë gjinore, duke krijuar mjedise urbane më të jetueshme dhe të barabarta për të gjithë banorët përballë sfidave që paraqesin ndryshimet klimatike.

Zhvillimi urban në Shqipëri mbart pabarazi të konsiderueshme gjinore, të cilat prekin veçanërisht gratë në ekonominë informale dhe proceset e planifikimit urban. Ndonëse studimet gjithëpërfshirëse mbi gratë janë të kufizuara, të dhënat e INSTAT tregojnë pabarazi të konsiderueshme gjinore në këtë sektor. Sektori i ndërtimit, ku janë të punësuar 98 179 punonjës, paraqet një nga hendeqet më të theksuara gjinore në ekonominë e Shqipërisë. Përkatesisht, burrat përbëjnë 96,3% (94 593 punonjës), ndërsa gratë përbëjnë vetëm 3,7% (3586 punonjës). Ky dallim i thellë theksohet më tej nga shkallët

e pjesëmarrjes në sektor, ku 13,5% e burrave të punësuar punojnë në ndërtim, krahasuar me vetëm 0,6% të grave të punësuar. Këto modele punësimi përshkallëzojnë sfidat ekzistuese me të cilat përballen gratë në mjediset urbane, ku ato shpesh janë të mbipërfaqësuar në ekonomitë informale urbane dhe të nënpërfaqësuar në proceset formale të planifikimit urban dhe vendimmarrjes. Qendrat urbane të Shqipërisë po përballen me përkeqësim të cilësisë së ajrit, kryesisht për shkak të automjeteve të vjetra me naftë dhe emetimeve industriale, veçanërisht nga bujqësia. Problemet kryesore përfshijnë ndotjen nga plehu azotik si në ujë ashtu edhe në ajër, si dhe teknikat e prerjes dhe djegies së bimësisë, e cila çliron grimca të imëta pluhuri dhe hiri në atmosferë.

Gratë përballen me sfida joproporcionale nga përkeqësimi i infrastrukturës urbane. Problematikat kryesore përfshijnë cilësinë e dobët të ajrit si pasojë e shkarkimeve bujqësore dhe industriale, si dhe aksesin e kufizuar në ujë të pastër, i cili ndikon veçanërisht në arsimimin e vajzave dhe shëndetin e grave. Situata është emergjente veçanërisht në zonat periurbane, ku 63% e grave raportojnë kushte të dobëta sanitare. Ndryshimet klimatike dhe kushtet e papërshtatshme sanitare kanë rritur rreziqet shëndetësore që u kanosen grave, si dhe kanë shtuar përgjegjësitë e tyre lidhur me kujdesin, të cilat u rritën nga 75% në 79% gjatë pandemisë së COVID-19.

3.4 Energjia

Integrimi i aspekteve gjinore në strategjitë e përshtatjes së sektorit të energjisë është thelbësor për të garantuar qëndrueshmëri të barabartë dhe efektive ndaj ndryshimeve klimatike. Aksesin në energji dhe përdorimi i saj shpesh ndryshojnë ndjeshëm midis gjinive për shkak të faktorëve socio-ekonomikë, roleve tradicionale dhe normave kulturore. Gratë, veçanërisht në zonat rurale ose me të ardhura të ulëta, mund të

përballen me varfëri më të madhe energjetike dhe të mbështeten më shumë në lëndët djegëse tradicionale të biomasës për gatim dhe ngrohje, duke i ekspozuar ato ndaj rreziqeve shëndetësore dhe gjetjes më të ngadaltë të lëndëve djegëse. Ndërsa ndryshimet klimatike ndikojnë mbi sistemet e energjisë, është thelbësore të identifikohen cenueshmëritë dhe nevojat me specifike gjinore. Masat e përshtatjes në sektorin e energjisë duhet të trajtojnë pabarazitë në aksesin në energji, të promovojnë teknologji të pastra dhe eficientë në dobi të shëndetit dhe produktivitetit të grave dhe të garantojnë pjesëmarrjen e grave në proceset e vendimmarrjes. Duke përfshirë perspektivat gjinore, strategjitë e përshtatjes së sektorit të energjisë jo vetëm që mund të përmirësojnë qëndrueshmërinë ndaj klimës, por edhe të kontribuojnë në barazinë gjinore, përmirësimin e jetesës dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo qasje garanton që përshtatja e sektorit të energjisë të sjellë përfitime për të gjithë shoqërinë dhe nuk përkeqëson në mënyrë të paqëllimtë pabarazitë gjinore ekzistuese.

Të dhënat e fundit të INSTAT tregojnë se në sektorin “Miniera dhe gurore, furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë”, ku janë të punësuar 35 508 punonjës, ekziston një pabarazi e thellë gjinore pasi burrat përbëjnë 84,9% të totalit (30 129 punonjës), ndërsa gratë vetëm 15,1% (5379 punonjës). Kjo pabarazi theksohet edhe më tej nga nivelet e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore në këtë sektor. Më konkretisht, 4,3% e burrave të punësuar punojnë në këtë sektor, ndërsa në rastin e grave kjo shifër është vetëm 0,9%. Këto dallime pasqyrojnë sfidat më të gjera strukturore në sektorin e energjisë, ku gratë përballen me akses të kufizuar në rolet teknike, pozicionet drejtuese dhe proceset e vendimmarrjes që ndikojnë në strategjitë për qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike. Përfaqësimi i ulët i grave është veçanërisht shqetësues duke pasur parasysh rolin kritik të këtij sektori në përpjekjet për përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike,

duke përfshirë në tranzicionin drejt energjisë së rinovueshme dhe zhvillimin e infrastrukturës së qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo pabarazi gjinore sugjeron që perspektivat dhe nevojat e grave mund të jenë të nënpërfaqësuar në politikat dhe planifikimin në sektorin e energjisë, çka mund të rezultojë në mangësi në trajtimin e cenueshmërive klimatike me specifikë gjinore dhe të sfidave lidhur me aksesin në energji. Të dhënat nënvizojnë nevojën urgjente për ndërhyrje të synuara për të rritur pjesëmarrjen e grave në sektorin e energjisë, duke u siguruar njëkohësisht që strategjitë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në fushën e zhvillimit energjetik të marrin në konsideratë ndikimet dhe nevojat me specifikë gjinore.

3.5 Transporti

Integrimi i aspekteve gjinore në masat e përshtatjes në sektorin e transportit është thelbësor si pasojë e urbanizimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit të infrastrukturës në vend. Rolet tradicionale gjinore, dallimet ndërmjet zonave urbane dhe rurale, si dhe pabarazitë ekonomike ndikojnë në nevojat dhe modelet e transportit të grave. Shpeshherë, gratë përballen me mundësi të kufizuara transporti në zonat rurale, çka ndikon në aksesin

e tyre në arsim, kujdes shëndetësor dhe mundësi ekonomike. Shqetësimet e lidhura me sigurinë, veçanërisht në transportin publik urban, janë të konsiderueshme për gratë në Shqipëri. Ndërkohë që vendi investon në infrastrukturë të re dhe punon drejt integritit në BE, është thelbësore përfshirja e qasjeve me ndjeshmëri gjinore në planifikimin e transportit. Kjo përfshin përmirësimin e aksesit në zonat rurale, trajtimin e problematikave të sigurisë, garantimin e përbalueshmërisë së kostove, si dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset e vendimmarrjes. Duke u fokusuar në këto aspekte, Shqipëria mund të krijojë një sistem transporti më të barabartë, efikas dhe gjithëpërfshirës që mbështet progresin social dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendit. Sipas të dhënave të INSTAT, transporti është pjesë e kategorisë më të gjerë “Tregti, Transport, Hoteleri, Shërbime të biznesit dhe administrative”, ku janë të punësuar 27,0% e totalit të fuqisë punëtore (350 563 punonjës nga 1 298 380 të punësuar në total). Edhe pse statistikatat e INSTAT nuk përmbajnë të dhëna mbi punësimin specifikisht për sektorin e transportit, veçanërisht në veprimtaritë e transportit konstatohet një ndër nivelet më të larta të pabarazisë gjinore. Më konkretisht, burrat përbëjnë 91,9% të punonjësve në sektorin e transportit, ndërsa gratë vetëm 8,1%. Nga totali i fuqisë punëtore meshkuj prej 700 686 individë, nga të cilët 30,9% punojnë në

Modelet e Lëvizshmërisë Gjinore në Sektorin e Transportit të Shqipërisë

60% e pasagjerëve të autobusëve në Tiranë janë gra

79% e grave raportojnë lëvizje më të shpeshta në këmbë

46% e grave përdorin autobusë për të shkuar në punë

20% njerëzve që përdorin biçikletë janë gra

sektorin më të gjerë, si dhe nga totali i fuqisë punëtore femra prej 597 694 individë, nga të cilat 22,5% punojnë në sektorin më të gjerë, transporti në veçanti shfaq pabarazi të thellë gjinore. Kjo pabarazi e thellë gjinore është tejet shqetësuese duke pasur parasysh rolin kritik të sektorit të transportit në qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe cenueshmërinë e tij ndaj ndikimeve klimatike. Struktura e punësimit, e cila dominohet nga meshkujt, paraqet sfida specifike, pasi punonjësit në sektorin e transportit duhet të përshtaten me rritjen e shpeshtësisë së ngjarjeve ekstreme të motit që ndikojnë tek infrastruktura, qëndrueshmëria e shërbimeve dhe kushtet e punës. Edhe pse përqindja e ulët e grave në sektor mund të sugjerojë se ekspozimi i tyre i drejtpërdrejtë ndaj rreziqeve klimatike operacionale është i kufizuar, gratë që punojnë në sektorin e transportit përballen shpeshherë me sfida të ndërlikuara, ku përfshihen aksesit i kufizuar në trajnime teknike, niveli i ulët i përfaqësimit në pozicionet vendimmarrëse që ndikojnë në masat për planifikimin e transportit të qëndrueshëm ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe pengesat për të pasur role drejtuese. Cenueshmëria e këtij sektori ndaj ndryshimeve klimatike është e konsiderueshme, veçanërisht duke pasur parasysh funksionin e tij thelbësor në ruajtjen e lëvizshmërisë dhe lidhjeve ekonomike gjatë ngjarjeve ekstreme të motit, çka nënvizon nevojën për qasje me përgjegjshmëri gjinore që mbrojnë fuqinë punëtore aktuale dhe nxisin një pjesëmarrje më gjithëpërfshirëse në zhvillimin e sistemeve të transportit të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike. Këto të dhëna nënvizojnë nevojën urgjente për ndërhyrje që trajtojnë pabarazitë e konsiderueshme gjinore dhe cenueshmëritë e këtij sektori ndaj ndryshimeve klimatike, duke punuar njëkohësisht drejt një përfaqësimit më të barabartë në planifikimin dhe veprimtaritë e transportit.

Sektori i transportit në Shqipëri shfaq pabarazi të konsiderueshme gjinore, veçanërisht për sa i përket modeleve të përdorimit dhe aksesit. Sipas një studimi të GIZ në vitin 2023, në Tiranë, gratë përbëjnë mbi 60% të udhëtarëve në autobus, dhe 46% prej tyre i përdorin autobusët për të shkuar në punë dhe 24% për të shkuar në shkollë. Megjithatë, gratë raportojnë një nivel më të ulët kënaqësie lidhur me shërbimet e transportit publik dhe përballen me sfida joproporcionale në përdorimin e automjeteve private. Vetëm 20% e përdoruesve të biçikletave janë gra dhe shqetësimet lidhur me sigurinë janë një ndër arsyet kryesore të këtij niveli të ulët, ndërsa 79% e grave shprehen se lëvizin shpesh në këmbë pavarësisht infrastrukturës së dobët. Të dhënat e ndara sipas gjinisë mungojnë për këtë sektor dhe politikat ekzistuese, si Strategjia Sektoriale e Transportit dhe Plani i Veprimit 2016-2020, nuk kanë të integruar aspektet gjinore. Cenueshmëritë ndaj ndryshimeve klimatike prekin veçanërisht gratë si pasojë e faktit që ato varen më tepër nga transporti publik dhe aktiv.

04

**Plani i Veprimit
për Aspektet
Gjinore
2026-2036**

4.1 Arsyetimi

Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri është hartuar për të integruar aspektet gjinore në Planin ekzistues Kombëtar të Përshtatjes (PKP), që mbulon periudhën 2026-2036. Kjo qasje pranon se ndryshimet klimatike kanë ndikime të ndryshme të gratë dhe burrat si pasojë e pabarazive sociale, ekonomike dhe kulturore. Duke integruar masa me përgjegjshmëri gjinore në veprimet e identifikuara në PKP, Shqipëria synon të rrisë efikasitetin dhe barazinë e përpjekjeve të saj për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore është i strukturuar rreth **pesë sektorëve prioritarë** të identifikuar në PKP-në e Shqipërisë dhe një **“sektori” të gjashtë, që mbulon rekomandimet ndërsektoriale ose ndërdisiplinore** për të forcuar përgjigjshmërinë gjinore të ngritjes së kapaciteteve institucionale, mekanizmat financiarë për klimën, nismat e edukimit dhe fushatat për ndërgjegjësimin publik të përshkruara në PKP:

1. Masat ndërsektoriale
2. Bujqësia dhe pylltaria
3. Turizmi
4. Zhvillimi urban
5. Energjia
6. Transporti

Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore pranon rëndësinë thelbësore të integritit të **aspekteve të kujdesit social** në përpjekjet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, veçanërisht në nivel vendor. Ky integrim garanton që masat për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike të jenë të aksesueshme nga popullsia më të cenueshme dhe të ofrohen së bashku me shërbimet sociale bazë. Duke ndërlidhur mekanizmat e mbrojtjes sociale me nismat për qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike, plani krijon një qasje më gjithëpërfshirëse për të trajtuar cënueshmëritë klimatike dhe nevojat e kujdesit social. Kjo është

veçanërisht e rëndësishme për zonat urbane, aksesin në energji dhe koordinimin ndërsektorial, ku shërbimet sociale dhe masat për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike ndërthuren në mënyrë të natyrshme.

Harmonizimi me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021-2030. Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore është zhvilluar për të garantuar një harmonizim të fortë me SKBGJ 2021-2030 të Shqipërisë, në veçanti me:

- Qëllimin strategjik I, i cili fokusohet te përm-bushja e të drejtave sociale dhe ekonomike, përmes masave që rrisin aksesin e grave në burimet dhe mundësitë ekonomike në sektorët e qëndrueshëm ndaj ndryshimeve klimatike
- Qëllimin strategjik IV, i cili fokusohet tek integrimi i perspektivës gjinore, përmes përfshirjes së aspekteve gjinore në kuadrot institucionale për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike
- Objektivat specifike të SKBGJ-së lidhur me rritjen e aksesit në shërbimet financiare, zvogëlimin e barrierave në sektorët jo-traditionalë dhe forcimin e mekanizmave institucionale.
- Për çdo sektor, Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore parashikon përmirësimin e masave ekzistuese të identifikuara në PKP me elemente me përgjegjshmëri gjinore. Kjo qasje garanton që:
- Aspektet gjinore të integrohen në kuadrin kryesor të Shqipërisë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
- Zbatimi të realizohet në përputhje me prioritetet e përgjithshme kombëtare të përshtatjes.
- Burimet të përdoren në mënyrë efektive duke u bazuar në veprimet ekzistuese të planifikuara.
- Përmirësimi i masave të PKP-së përmes elementeve me përgjegjshmëri gjinore synon të:
- Rrisë pjesëmarrjen e grave në proceset e vendimmarrjes lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike

- Përmirësojë aksesin e grave në burimet, teknologjinë dhe informacionin e nevojshëm për të garantuar qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike
- Trajtojë cenueshmëritë me specifike gjinore ndaj ndikimeve klimatike
- Nxisë lidërsipin e grave në nismat për qëndrueshmëri ndaj ndryshimeve klimatike
- Garantojë se përfitimet e përshtatjes shpërndahen në mënyrë të barabartë

4.2 Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore

Ndryshimet klimatike ndikojnë ndryshe te gratë dhe burrat për shkak të **pabarazive në aksesin në burime, fuqinë vendimmarrëse dhe mundësitë ekonomike**. Gratë në Shqipëri, veçanërisht kryefamiljaret dhe gratë që punojnë në mënyrë informale ose jetojnë në zona rurale dhe me të ardhura të ulëta, shpesh përballen me **ekspozim më të madh ndaj përmblytjeve, të nxehtit, thatësisë dhe varfërisë energjetike**, teksa vijojnë të jenë të **nënpërfaqësuar në strukturat e planifikimit dhe vendimmarrjes**. Përfshirja e konsideratave gjinore në zbatimin e PKP-së është thelbësore për të siguruar që masat e përshtatjes të jenë të **barabarta, gjithëpërfshirëse dhe të efektshme**.

Kjo PVBGJ përputhet dhe mbështet zbatimin e disa strategjive kryesore kombëtare dhe angazhimeve ndërkombëtare, duke përfshirë Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore, strategjitë specifike sektoriale, Marrëveshjen e Parisit dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Përmes përmirësimit të PKP-së me këto elemente të përgjigjshme gjinore, Shqipëria tregon angazhimin e saj për përshtatje gjithëpërfshirëse dhe të drejtë ndaj klimës. Kjo qasje merr parasysh se adresimi i pabarazive gjinore në kontekstin e ndryshimeve klimatike nuk është vetëm çështje drejtësie sociale, por edhe strategji kyç për krijimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme

dhe me aftësi ripërtëritëse për të gjithë shqiptarët.

Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore do t'u nënshtrohet vazhdimisht rishikimeve dhe përditësimeve të rregullta teksa PKP-ja evoluon. Ai ofron rekomandime për veprime që lidhen me barazinë gjinore, duke përshkruar sfidat e barazisë dhe përshtatjes që ato adresojnë, një përmbledhje të shkurtër të secilit veprim, përfituesit kryesorë dhe treguesit e sugjeruar në përputhje me Kuadrin e Monitorimit, Vlerësimit dhe të Nxënimit të PKP-së. Gjithashtu, PVBGJ-ja specifikon në tabelat sektoriale më poshtë se në cilat nga 66 masat e përshtatjes të PKP-së kontribuon më drejtpërdrejt secili veprim për barazinë gjinore. Në rastet kur një veprim nuk lidhet me një masë të vetme, ai identifikohet si ndërsektorial për të mbështetur integrimin e konsideratave gjinore në të gjitha veprimet e përshtatjes së një sektori.

PVGJ-ja, në zbatim të kuadrit të saj, përshkruan masat **ndërsektoriale** për barazinë gjinore, që shtrihen në të gjitha fushat e përshtatjes. Këto masa krijojnë kushtet e favorshme për zbatim të efektshëm dhe gjithëpërfshirës, duke garantuar që barazia gjinore të jetë vazhdimisht e integruar në qeverisje, ngritje kapacitetesh, mbledhje të dhënash, financa dhe menaxhim të riskut nga fatkeqësitë. Kjo qasje ndërsektoriale pasqyrohet nga prioritetet e mëposhtme:

- **Qeverisje gjithëpërfshirëse:** Të garantohet **përfaqësim i balancuar i grave dhe burave** në Grupin Ndërmnistror të Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK) dhe të gjitha Grupet Teknike të Punës (GTP) sektoriale. Të caktohen **pika fokale për barazinë gjinore** në ministritë dhe agjencitë kryesore për të këshilluar dhe monitoruar barazinë gjinore në veprimet e përshtatjes.
- **Zhvillimi i kapaciteteve:** Të ofrohen **trajtime për barazinë gjinore** dhe ndryshimet klimatike për politikëbërësit, planifikuesit dhe

zbatuesit në nivel kombëtar dhe vendor. Të forcohen aftësinë e institucioneve për të kryer **analizën gjinore, buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe hartimin gjithëpërfshirës të projekteve.**

- **Planifikimi dhe MVN-ja e përgjigjshme gjinore:** Të kryhet sistematikisht **analiza gjinore** në të gjitha ciklet e planifikimit të përshtatjes dhe projektit. Të përdoren **tregues të ndarë sipas seksit** në sistemin e Monitorimit, Vlerësimit dhe të Nxënit (MVN), të gjurmohet pjesëmarrja dhe përfitimet e grave dhe burrave dhe të sigurohet **buxheti i përgjigjshëm gjinor.**
- **Qasja e barabartë në financa dhe burime:** Të hartohen **mekanizma financimi për përshtatjen** (grante, garanci, hua me interes të ulët) për të arritur **NMVM-të e drejtuara nga gratë, gratë fermere dhe organizatat e grave.** Të promovohet akses i grave në titujt e pronësisë, asetet prodhuese dhe shërbimet këshillimore për të mundësuar rolin e tyre aktiv në përshtatje.
- **Pjesëmarrja domethënëse e shoqërisë civile:** Të përfshihen **organizatat e grave, grupet rinore dhe OSHC-të vendore** në konsultime, hartimin e projekteve dhe monitorimin. Të lehtësohen **nisma për përshtatjen të drejtuara nga komuniteti,** ku si gratë, ashtu edhe burrat, mund të udhëheqin dhe të përfitojnë.
- **Menaxhimi i riskut nga fatkeqësitë me ndjeshmëri gjinore:** Të përfshihen **sistemet e paralajmërimit të hershëm që arrijnë gratë dhe burrat në mënyrë të barabartë,** të mundësohet **evakuimi dhe strehimi i sigurt** dhe të përfshihet **mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore (DHBGJ)** në përgatitjen dhe reagimin ndaj fatkeqësive.
- **Njohuritë dhe të dhënat:** Të kryhet **mbledhja,**

analiza dhe publikimi i të dhënave të ndara sipas seksit dhe moshës në vlerësimet e riskut klimatik, raportet e monitorimit dhe vlerësimet e politikave. Të mbështetet kërkimi mbi **dimensionet gjinore të cenueshmërisë dhe aftësisë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike.**

Krahas këtyre, përfshihen edhe masa specifike sektoriale për t'i përkthyer konsideratat gjinore në ndërhyrje konkrete në të gjitha fushat prioritare të përshtatjes për Shqipërinë.

- Në **bujqësi dhe pylltari,** PVBGJ-ja përqendrohet në përmirësimin e aksesit të grave në tituj pronësie, hua dhe shërbime ekstensionale, duke mbështetur edhe pjesëmarrjen e tyre në bujqësinë inteligjente ndaj klimës, kooperativat prodhuese dhe zinxhirët e vlerave të pylltarisë. Këto veprime janë hartuar për të adresuar nënperfraqësimin e grave në sektorët prodhues dhe për të forcuar rolin e tyre në promovimin e ekosistemeve me aftësi ripërtëritëse.
- Në sektorin e **turizmit,** PVBGJ-ja thekson cenueshmërinë e grave të punësuar në punë sezonale dhe me rrezik të lartë, duke propozuar veprime që integrojnë planifikimin me ndjeshmëri gjinore për riskun klimatik, ofrojnë incentiva të dedikuara për NMVM-të e drejtuara nga gratë dhe zgjerojnë mundësitë e trajnimit për të siguruar akses të barabartë në njohuritë dhe udhëheqjen për përshtatje.
- Sa i përket **zhvillimit urban,** masat e përgjigjshme gjinore synojnë të krijojnë hapësira publike më të sigurt dhe me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës, të forcojnë gatishmërinë në raste fatkeqësive me bazë komunitetin dhe të ofrojnë mbështetje të synuar për familjet me të ardhura të ulëta dhe me kryefamiljare gra, duke garantuar që perspektivat e grave të formësojnë

projektimin e qyteteve me aftësi ripërtëritëse.

- Në sektorin e **energjisë**, PVBGJ-ja trajton çështjen e ngutshme të varfërisë energjetike në familjet me kryefamiljare gra, promovon pjesëmarrjen e grave në punët me energji të rinovueshme dhe eficiencë energjie dhe lehtëson investimet e udhëhequra nga gratë në zgjidhjet e energjisë së pastër, duke kombinuar kështu barazinë sociale me aftësinë ripërtëritëse ndaj klimës.
- Së fundi, në sektorin e transportit, veprimet për barazinë gjinore theksojnë sigurinë, aksesin dhe pjesëmarrjen, përfshirë masat për përshtatjen e transportit publik me nevojat e grave, promovimin e përfshirjes së tyre në planifikim dhe operacione dhe për shtimin e opsioneve të lëvizshmërisë për gratë në zonat rurale, teksa mobilizojnë edhe financimin e përgjigjshëm gjinor për klimën për të mbështetur infrastrukturën e qëndrueshme të transportit.

Së bashku, këto masa sektoriale plotësojnë veprimet ndërsektoriale duke siguruar që barazia gjinore të përfshihet jo vetëm në qeverisjen dhe planifikimin gjithëpërfshirës, por edhe në hartimin dhe zbatimin praktik të politikave të përshtatjes në të gjithë sektorët prioritarë. Këto veprime paraqiten me detaje në tabelat e mëposhtme, ku përshkruhen sfidat e adresuara, ndërhyrjet e propozuara, përfituesit e tyre, treguesit dhe kontributet specifike në masat e PKP-së. Kështu, PKP-ja forcon pajtueshmërinë me angazhimet ndërkombëtare dhe të BE-së për barazinë gjinore dhe ndryshimet klimatike, teksa rrit efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e masave të përshtatjes dhe fuqizon si gratë, ashtu edhe burrat, si agjentë aktivë të aftësisë ripërtëritëse ndaj klimës.

4.3 Masat ndërsektoriale

Nr	Veprimi për barazinë gjinore	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e PKP-së
1	Institucionalizimi i barazisë gjinore në raportimin dhe qeverisjen e PKP-së (GNPNK-ja dhe Grupet Teknike të Punës sektoriale)	Nënpërfaqësimi i grave në organet vendimmarrëse; rrjedha e kufizuar e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe seksit	Përditësimi i TR-së; kërkesa për ndarjen sipas seksit/moshës/cenueshmërisë në raportet sektoriale; rishikimi vjetor për barazinë gjinore	Gratë në institucione, stafi bashkiak, pikat kombëtare fokale për çështjet gjinore, OSHC-të e drejtuara nga gratë	# takime të GNPNK-së/GTP-së me agjendë gjinore; % e raporteve sektoriale me të dhëna të ndara sipas seksit; përqindja e masave që raportojnë rezultate me diferencë gjinore	M2 – Optimizimi i koordinimit klimatik (Forcimi i kuadrit të GNPNK-së)
2	Protokolli kombëtar i përgjigjshëm gjinori i monitorimit dhe vlerësimit të përshtatjes	Tregues të fragmentuar; ndarje jokonsistente gjinore	Hartimi i skedave të referencës për protokollet dhe treguesit; integrimi i SK-së/KC-së dhe verifikimit	Gratë në institucione, pikat fokale gjinore, OSHC-të kombëtare	# tregues me ndarje sipas seksit/moshës; # skeda reference të plotësuara për treguesit; % e masave sektoriale me tregues të përgjigjshëm gjinorë	M9 - Promovimi i monitorimit dhe trajnimit me ndjeshmëri gjinore për përshtatjen klimatike
3	Mundësi për qasje në financim të përgjigjshëm gjinor për ndryshimet klimatike	Qasje e kufizuar në financimin për përshtatje për NMVM-të dhe OSHC-të e drejtuara nga gratë	Grante/garanci të vogla për projektet pilot të përshtatjes	NMVM-të në pronësi të grave, gratë sipërmarrëse, grupet e grave në zonat rurale, familjet në nevojë, OSHC-të e drejtuara nga gratë	# organizata të financuara të drejtuara nga gratë; % e portofolit që shkon për projekte të udhëhequra nga gratë; % e projekteve të mbështetura për më shumë se 24 muaj	M7 - Mekanizmat novatorë të financimit për klimën
4	Protokolle MRF-je dhe emergjence me ndjeshmëri gjinore	Ndikime disproporcionale të gratë në raste fatkeqësish; DHBGJ-ja dhe risqet për sigurinë	Standardizimi i komunikimeve të riskut, strehët e sigurta, sistemet e ankesave dhe referimeve	Familjet me kryefamiljare gra, punonjëset informale gra, gratë dhe vajzat e cenueshme, grupet vendase të grave	# bashki që miratojnë protokollin; # strehë që përmbushin standardet gjinore; % e grave që raportojnë qasje të sigurt gjatë emergjencave	M10 – Edukimi i komuniteteve dhe forcimi i ndërgjegjësimit për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë

4.4 Bujqësia dhe pylltaria

Nr	Veprimi për barazinë gjinore	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e PKP-së
1	Qasje e barabartë në tokë, hua dhe shërbime ekstensionit	Pronësia e kufizuar mbi tokën dhe hua bujqësore; shtrirje e ulët e shërbimeve të ekstensionit për gratë	Ndihmë ligjore për titujt e pronësisë; agrofinancimi i përshtatur sipas gjinisë; objektivi prej 40% për shërbime ekstensionit për gratë	Gratë fermere dhe gratë në zona rurale; NMVM-të bujqësore në pronësi të grave	# gra me tituj pronësie mbi tokën; # gra që përfitojnë nga huat bujqësore të përshtatura; % e grave në shërbimet e ekstensionit; % që zbatojnë praktikatat e BMK-së	M11 dhe M12 – Mbështetja e fermerëve dhe rimëkëmbja nga fatkeqësitë; M17 – Zgjerimi dhe modernizimi i sistemit të ujitjes; M15 - Zbatimi i krijimit të habitatit dhe ZBN-ve për të luftuar erozionin e tokës
2	Bursa dhe AFPT i sigurt për bujqësi inteligjente ndaj klimës që siguron pjesëmarrjen e grave	Nënpërfaqësimi i vajzave dhe të rejave në trajnimin bujqësor	Bursa studimi; mjedise të sigurta mësimore; kurrikula inteligjente ndaj klimës	Vajzat dhe të rejtat në AFPT bujqësore dhe universitete	# bursa të dhëna për vajzat; % e të diplomuarave femra në programet e BMK-së; % e të diplomuarave të punësuar në vende pune inteligjente për klimën	M17 – Zgjerimi dhe modernizimi i sistemit të ujitjes (elementi i ngritjes së kapaciteteve)
3	Grupe prodhuesish dhe kooperativa të drejtuara nga gratë për ZBN	Përrjashtimi nga lidërshtipi dhe tregjet	Mbështetja e kooperativave të drejtuara nga gratë; lidhja me ujitjen, farat rezistente ndaj thatësirës dhe shërbimet hidrometeorologjike	Gratë fermere, gratë sipërmarrëse në bujqësi, gratë në OSHC-të vendore	# kooperativa të drejtuara nga gratë; % e grave në pozicione drejtuese; ndryshimi i rendimentit në parcelat e menaxhuara nga gratë	M14 – Mbrojtja nga përbytyt (brigjet e lumenjve/fushat aluvionale); M15 – Zgjidhjet e bazuara në natyrë kundër erozionit
4	Punë të orientuara drejt gjinisë në fidanishtet pyjore dhe pyllëzime	Pjesëmarrja e ulët e grave në zinxhirët e vlerave të pylltarisë	Vendosja e kuotave dhe orare fleksible për gratë në fidanishte; trajnim për lidërshtip	Gratë në zonat rurale, NMVM-të në pronësi të grave, gratë që punojnë në pylltari	# gra të trajnuara/ të punësuar; % e grave në menaxhimin e fidanishteve; shkalla e mbijetesës së fidanëve 12–24m	M23–M31 – Masat pyjore (Fidanishte rajonale për llojet e pemëve vendase rezistente ndaj thatësirës, migrimi i asistuar i llojeve, zonat buferike dhe restaurimi)

4.5 Turizmi

Nr	Veprimi për barazinë gjinore	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e PKP-së
1	Planifikimi hapësinor i riskut klimatik me këndvështrim gjinor	Gratë e caktuara në punë në zona bregdetare/ punë sezonale me risk të lartë; përfaqësim i pamjaftueshëm në planifikim	Integrimi i të dhënave të riskut dhe gjinisë; ridrejtimi i aseteve të reja nga zonat e riskut; kërkesa për pjesëmarrjen e grave	Punonjëset gra në turizëm, sipërmarrëset gra, planifikueset vendore dhe OSHC	# plane bashkiake që marrin parasysh gjininë; # leje me klauzola përshtatjeje dhe sigurie; % e grave që raportojnë qasje më të sigurt	M32 - Planifikimi hapësinor strategjik për turizmin:
2	Stimujt e dedikuar për mbrojtjen nga ndryshimet klimatike të NMVM-ve të drejtuara nga gratë	Mangësitë në financa dhe të dhëna për bizneset turistike të grave	Grante/hua për hijesim, kullim, eficiencë të ujit; kritere të qasjes gjinore	NMVM-të e turizmit në pronësi të grave; punonjëset sezonale gra	# i NMVM-ve të drejtuara nga gratë, të përmirësuara; % e objekteve që përmbushin listën e kontrollit të mbrojtjes nga ndryshimet klimatike; vijimësia e të ardhurave pas ngjarjeve klimatike	M33 – Incentiva për mbrojtje ndaj ndryshimeve klimatike; M36 - Forcimi i kuadrit politik dhe rregullator për turizmin e qëndrueshëm
3	Veprimet e bazuara në të dhëna: trajnime dhe qendra digjitale për gratë	Pak gra në menaxhim; qasje e kufizuar në të dhëna klimatike/ mentorim	Udhëzime praktike, rrjete të mësimit elektronik dhe mentorimit për gratë	Gratë sipërmarrëse, stafi me femra në sektorin e turizmit, menaxheret gra	# gra të trajnuara/ të mentoruara; % e grave në role menaxheriale; moduli i të dhënave klimatike të turizmit është funksional	M37 – Integrimi i të dhënave klimatike; M40 - Ngritja e kapaciteteve të operatorëve me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike

4.6 Zhvillimi Urban

Nr	Veprimi për barazinë gjinore	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e PKP-së
1	Hapësira publike të sigurta ndaj të nxehtit dhe me ndjeshmëri gjinore	Stresi nga i nxehti; shqetësimet për sigurinë; role kujdesi të lartë	Pemë/ hije, dhoma ftohjeje, ndriçim/kanalizime të sigurta	Familjet me kryefamiljare gra dhe familjet e cenueshme; pikat fokale për gratë në bashki	# hapësira të përshtatura; % e grave që raportojnë rehati/siguri të shtuar; ulje e incidenteve të lidhura me të nxehtin	M46 - Integrimi i hapësirave të gjelbra në zhvillimin e infrastrukturës publike përmes prokurimit publik të gjelbër M47 - Restaurimet e korridoreve të gjelbra: nisja për ripyllëzim dhe gjelbërim urban M50 - Rritja e aftësive ripërtëritëse urbane: vlerësimi i hapësirave të gjelbra dhe zgjidhjeve të qëndrueshme të kullimit
2	Menaxhimi gjithëpërfshirës i riskut nga përmbytjet në komunitet	Familjet me kryefamiljare femra janë shumë të ekspozuara	Grupe të udhëhequra nga gratë për përgatitje, simulime, kujdes për ligatinat/brigjet e lumenjve	Familje me kryefamiljare gra dhe familje të cenueshme; shoqata vendore të grave	# komunitete të prekura; % e grave në simulime; reduktim i kohës së evakuimit (sipas gjinisë)	M49- Planet e emergjencës në raste përmbytjesh M50 - Rritja e aftësive ripërtëritëse urbane: vlerësimi i hapësirave të gjelbra dhe zgjidhjeve të qëndrueshme të kullimit
3	Gratë në planifikimin e përshtatjes së qytetit	Nënpërfaqësim në planifikimin vendor	Vende të rezervuara dhe mentorim për gratë dhe OSHC-të	Stafi bashkiak gra; OSHC-të e drejtuara nga gratë	Politika e kuotave e miratuar; % e takimeve planifikuese me ≥40% gra; # plane që pasqyrojnë nevojat e grave	Ndërsektorial
4	Mbështetje për strehim të qëndrueshëm për gratë	Cenueshmëria e familjeve me kryefamiljare femra dhe të ardhura të ulëta	Grante/kuponë për hidroizolim, ventilim, mbrojtje nga përmbytjet	Familje me kryefamiljare femra dhe me të ardhura të ulëta	# familje të mbështetura me kryefamiljare femra; % ulje e humbjeve; rritja e aftësive ripërtëritëse ndaj përmbytjeve/ përmirësimi i energjisë	M45 - Skemat e incentivave për të rritur aftësitë ripërtëritëse të ndërtesave ndaj temperaturave ekstreme rritja e aftësive ripërtëritëse ndaj përmbytjeve/ përmirësimi i energjisë M48 – Vlerësimi i risqeve klimatike për Durrësin,

4.7 Energjia

Nr	Veprimi për barazinë gjinore	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e PKP-së
1	Lehtësim i synuar i varfërisë energjetike për gratë	Varfëria energjetike në familjet me kryefamiljare gra	Lehtësim tarifash dhe pajisje efikase	Familje me kryefamiljare femra dhe me të ardhura të ulëta	# familje të mbështetura; % ulje e ngarkesës së energjisë	Ndërsektorial
2	Trajnimi dhe punësimi i grave në OM-të e burimeve të rinovueshme	Pjesëmarrje e ulët e grave në punët teknike në sektorin e energjisë	Kurse dhe praktika profesionale të shkurtra me shërbime/BRE	Vajzat dhe të rejtat në STEM/AFPT; profesioniste gra	# gra të trajnuara; % e grave në vende pune në OM; mbajtja në punë ≥12 muaj	Ndërsektorial
3	Financim për PV dhe EE për NMVM-të e grave	Kapitali i kufizuar për investimet në energji të udhëhequra nga gratë	Grante/hua dhe AT për PV dhe EE	NMVM-të në pronësi të grave	# NMVM të drejtuara nga gratë që përdorin PV/EE; % ulje e kostos së energjisë; vijimësi gjatë goditjeve	M56 - Rritja e aftësive ripërtëritëse ndaj valës së të nxehtit përmes vendosjes efikase të teknologjisë së kondicionimit të ajrit dhe strehimeve për mbrojtje ndaj ndryshimeve klimatike M58 - Optimizimi i energjisë së rinovueshme për sisteme me aftësi ripërtëritëse: investime në inovacionin e rjetit dhe magazinimin
4	Të dhëna të detyrueshme të energjisë të ndara sipas seksit	Mungesa e të dhënave të energjisë sipas gjinisë	Kërkesa nga shoqëritë dhe ERE për të publikuar të dhëna gjinore	Gratë në institucione, analiste gjinore, OSHC-të	Lëshimi i autorizimit për raportim; # grupe të dhënash të publikuara; # politika të informuara	Ndërsektorial

4.8 Transporti

Nr	Veprimi për barazinë gjinore	Sfida e trajtuar	Përshkrimi	Përfituesit	Treguesit	Kontributi specifik në masat e PKP-së
1	Transport publik i sigurt ndaj klimës për gratë	Shqetësime për sigurinë, ekspozimi ndaj të nxehtit/përmbytjeve	Hijesim, ndriçim, butona emergjence; rrugë emergjence	Punonjëset gra që mbështeten në transportin publik; udhëtarët femra të cenueshme	# qendra transporti të rimodeluara; % e grave që raportojnë qasje më të sigurt; reduktim i kohës së udhëtimit gjatë risqeve	Ndërsektoriale
2	Gratë në planifikimin dhe operacionet e transportit	Nënpërfaqësim në bordet sektoriale	Kuota dhe mentorim për gratë në planifikim dhe operacione	Planifikueset gra, stafi bashkiak, OSHC-të	# gratë në komisione; % e planeve me analizë të lëvizshmërisë gjinore	Ndërsektoriale
3	Projektet pilot të lëvizshmërisë dhe qasjes së grave që jetojnë në zonat rurale	Mundësi të kufizuara të transportit rural	Shërbime që i përgjigjen kërkesës, ecje/çiklizëm i sigurt drejt shërbimeve dhe tregjeve	Gratë në zonat rurale, gratë dhe vajzat e cenueshme	# programe pilot të vëna në zbatim; # udhëtime thelbësore për gratë; kohë e kursyer.	Ndërsektoriale
4	Financim klimatik i i përgjigjshëm gjinor për transportin	Mangësi në financim për transport me aftësi ripërtëritëse në dobi të grave	PPP/ instrumente financimi për të përmirësuar asetet në mënyrë të paanshme	Përdorueset gra, udhëtarët e pambrojtura, sipërmarrëset gra	# instrumente të projektuara; kapital privat i mobilizuar; % e projekteve që përdorin teknologji me ndikim të ulët	M66 - Partneritete novatore për transport të qëndrueshëm

Lista e referencave

- ▶ Instituti i Statistikave në Shqipëri (INSTAT). (2023). Burra dhe Gra në Shqipëri, 2023. <https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/women-and-men-in-albania-2023/>
- ▶ Komisioni Evropian. (2023). Albania 2023 Report. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf
- ▶ Bordi i Turizmit në Slloveni. (2023). Skema e Gjelbër për Turizmin në Slloveni: Raport 2023. Lubjanë, Slloveni. <https://www.slovenia.info/en/business/green-scheme-of-slovenian-tourism/green-day-2023>
- ▶ Geopark, B. (2021). Burren Food Trail. Marrë nga <https://www.burren.ie/food-dining/burren-food-trail/> EPA Ireland. (2019). Ndryshimet klimatike dhe sektori i bujqësisë dhe pyjeve në Irlandë. Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit, Irlandë.
- ▶ Qeveria e Shqipërisë. (2021). Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.
- ▶ Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNNK). (2022). Raporti i Gjashtë i Vlerësimit (RGjV). <https://www.ipcc.ch/assessment-report/ar6/>
- ▶ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. (2021). Strategjia për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin (SBZHRP) 2021–2027. <https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Strategjia-e-Bujqesise-2021-2027.pdf>
- ▶ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. (2016). Strategjia Sektoriale e Transportit dhe Plani i Veprimit 2016-2020.
- ▶ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. (2020). Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (SKNK) 2020-2030.
- ▶ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, Shqipëri.
- ▶ Rrjeti Global i PKP-ve dhe KKKBNK. (2019). Toolkit for a Gender-Responsive Process to Formulate and Implement National Adaptation Plans (NAPs). <https://napglobalnetwork.org/resource/toolkit-for-gender-responsive-national-adaptation-plans/>
- ▶ Republika e Shqipërisë. (2008). Ligji nr. 9970, “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
- ▶ Republika e Shqipërisë. (2010). Ligji nr. 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- ▶ Republika e Shqipërisë. (2017). Ligji nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- ▶ Republika e Shqipërisë. (2020). Ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”.
- ▶ Kontrolli i Lartë i Shtetit. (2023). Raport për barazinë gjinore në skemat e mbështetjes bujqësore.
- ▶ UN CEDAW. (2023). Vëzhgimet përmbyllëse për raportin e pestë periodik të Shqipërisë. https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolNo=CEDAW/C/ALB/CO/5&Lang=En

- ▶ UNDP në Shqipëri. (2023). Raporti i zhvillimit sipas skenarëve në nivel kombëtar dhe sektorial.
- ▶ UNDP. (2021). Studim mbi situatën e klientëve në nevojë lidhur me furnizimin me energji elektrike.
- ▶ KKKBNK. (2019). Gjinia dhe ndryshimet klimatike. <https://unfccc.int/topics/gender/the-big-picture/introduction-to-gender-and-climate-change>
- ▶ UN Women. (2023). Përmbledhje për barazinë gjinore: Shqipëri. <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2023/01/country-gender-equality-brief-albania>
- ▶ Banka Botërore. (2021). Profili i Rrezikut Klimatik: Shqipëri. https://climateknowledgeportal.worldbank.org/sites/default/files/2021-05/15724-WB_Albania%20Country%20Profile-WEB.pdf
- ▶ Forumi Ekonomik Botëror. (2023). Global Gender Gap Report 2023. <https://www.weforum.org/reports/global-gender-gap-report-2023/>
- ▶ Organizata Botërore e Turizmit (UNWTO). (2022). Raport global për gratë në sektorin e turizmit. <https://www.e-unwto.org/doi/book/10.18111/9789284423132>

Shtojcat

Shtojca I: Konteksti kryesor për përshtatjen me përgjegjshmëri gjinore ndaj ndryshimeve klimatike

Pjesa 1 - përkufizimet dhe terminologjia kryesore

Përkufizimet kryesore lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike

Një nga objektivat parësorë të planifikimit të përshtatjes është zbutja e cenueshmërive dhe risqeve që mund të vijnë nga ndikimet klimatike të parashikuara, me synim parandalimin ose zbutjen e dëmit. Në rastin e Shqipërisë, ky objektivi përkthehet në mbrojtjen dhe përmirësimin e mirëqenies së popullsisë më të cenueshme. Ky objektivi është i lidhur ngushtësisht me nocionin e pabarazisë, një koncept që theksohet edhe nga

Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike, i cili në vitin 2014 konfirmoi, me një nivel të lartë saktësie, se luhatjet në nivelin e cenueshmërive dhe ekspozimit ndaj ndryshimeve klimatike vijnë si pasojë e faktorëve joklimatikë dhe pabarazive shumëdimensionale, të cilat shpeshherë lindin nga proceset e pabarabarta të zhvillimit. Këto pabarazi kontribuojnë në luhatjen e niveleve të riskut të lidhur me ndikimet e ndryshimeve klimatike (PNNK, 2014).

Gjinia, ndër faktorë të tjerë, është pranuar prej shumë kohësh në literaturën shkencore si një faktor përcaktues në nivelin e cenueshmërisë. Ky dokument shqyrton faktorët që nxisin pabarazitë

Tabela 1. Terminologjia kryesore lidhur me riskun dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike

Konceptet	Përkufizimet ¹⁴
Cenueshmëria	Tendenca apo predispozita për të pësuar ndikime negative. Cenueshmëria përfshin një sërë konceptesh si ndjeshmëria ose prirja për të pësuar dëm, si dhe mungesa e kapaciteteve përbaluese dhe përshtatëse.
Ekspozimi	Prania e njerëzve, veprimtarive të jetesës, specieve ose ekosistemeve, funksioneve mjedisore, shërbimeve, burimeve, infrastrukturës, apo asetëve ekonomike, sociale ose kulturore, në vende dhe ambiente që mund të pësojnë ndikime negative.
Rreziku	Mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje apo tendence që ka efekte fizike, qoftë natyrore ose të shkaktuar nga njeriu, ose e një ndikimi fizik që mund të shkaktojë humbje të jetës, lëndime apo ndikime të tjera shëndetësore, si dhe dëmtim dhe humbje të pronës, infrastrukturës, veprimtarive të jetesës, ofrimit të shërbimeve, ekosistemeve dhe burimeve mjedisore.
Ndikimet	Efektet e ngjarjeve klimatike dhe motit ekstrem, si dhe të ndryshimeve klimatike, te sistemet natyrore dhe njerëzore. U referohen efekteve të jeta, veprimtaritë të jetesës, shëndeti, ekosistemet, ekonomitë, shoqëritë, kulturat, shërbimet dhe infrastruktura si pasojë e ndërthurjes së ndryshimeve klimatike apo ngjarjeve të rrezikshme klimatike që ndodhin brenda një periudhe të caktuar dhe cenueshmërisë së një shoqëria po sistemi të ekspozuar.
Aftësia	Ndikimet e ndryshimeve klimatike te sistemet gjeofizike, duke përfshirë të përmblytjeve, thatësirave dhe rritjes së nivelit të detit, janë një nëngrup i ndikimeve që quhet ndikime fizike.
Përshtatja	Kapaciteti i sistemeve sociale, ekonomike dhe mjedisore për të përballuar një shqetësim, tendencë apo ngjarje të rrezikshme, për të reaguar apo për t'u riorganizuar në mënyra që ruajnë funksionin thelbësor, identitetin dhe strukturën e tyre, duke ruajtur njëkohësisht kapacitetin për t'u përshtatur, mësuar dhe transformuar.


14. Burimi: IPCC, 2014. Climate Change 2014: Impacts, Adaptation, and Vulnerability. Part A: Global and Sectoral Aspects. Kontributi i grupit të punës II në Raportin e Pestë të Vlerësimit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNNK, 2014. Ndryshimet klimatike 2014: Ndikimet, përshtatja dhe cenueshmëria. Pjesa A: Aspektet globale dhe sektoriale. Kontributi i grupit të punës II në Raportin e Pestë të Vlerësimit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike)

gjinore dhe rrisin cenueshmërinë e grave ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, në veçanti në pesë sektorët prioritarë të identifikuar në procesin e Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP) të Shqipërisë. Risku, siç përcaktohet në tabelën në vijim, ndikohet nga rreziqet, ekspozimi dhe cenueshmëria. Një planifikim efektiv i përshtatjes kërkon një vlerësim gjithëpërfshirës të këtyre tre dimensioneve. Për rrjedhojë, ky seksion synon të qartësojë situatën duke nënvizuar faktorët që ndikojnë te risku i lidhur me aspektet gjinore, duke iu referuar terminologjisë kryesore bazuar në raportet e PNNK-së (Tabela 1). Grupet sociale ndikohen në mënyrë të ndryshme nga ndryshimet klimatike, në varësi të tre variablave të ilustruar në figurën 1 në vijim, përkatësisht cenueshmëria, rreziqet dhe ekspozimi. Për rrjedhojë, zvogëlimi i cenueshmërisë është një element kyç i menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë (MRF) dhe i planifikimit të përshtatjes.

Përkufizimi i përshtatjes me përgjegjshmëri gjinore

Përshtatja me përgjegjshmëri gjinore përfshin një qasje sistematike për të dalluar përfituesit e investimeve në iniciativat e rikuperimit pas fatkeqësive dhe ndërtimit të qëndrueshmërisë (pra, masat e prioritizuara të përshtatjes), duke identifikuar njëkohësisht personat që duhet të përfitojnë, si dhe duke garantuar përfshirje dhe pjesëmarrje kuptimplotë. Ky proces përfshin analizimin e mënyrës se si risqet aktuale dhe të ardhshme klimatike kanë ndikim të ndryshëm te burrat dhe gratë, si dhe shqyrtimin e arsyeve përkatëse për këto dallime. Për më tepër, ky proces analizon dinamikat ndërmjet femrave dhe meshkujve, duke përfshirë nivelin e aksesit dhe të kontrollit të tyre mbi burimet, si dhe kufizimet me të cilat përballet çdo grup në raport me tjetrin.

Figura 4. Ilustrim i konceptit bazë të riskut (PNNK, 2014)



Source: (IPCC, 2014).

Politikat neutrale nga pikëpamja gjinore jo domosdoshmërisht shoqërohen me rezultate të barabarta si pasojë e pabarazive ekzistuese ndërmjet gjinive, si p.sh. dallimet e lidhura me kohën në dispozicion, veprimtaritë ekonomike, pronësinë e asetëve, aksesin në burime dhe teknologji, arsimin dhe normat kulturore.

Përgjigjet ndaj ndryshimeve klimatike, duke përfshirë politikat, ofrojnë një mundësi për të rritur barazinë gjinore dhe për të parandaluar përshkallëzimin e pabarazive ekzistuese. Qasjet “e verbra nga ana gjinore” nuk synojnë në mënyrë aktive arritjen e barazisë gjinore dhe mund të çojnë në rezultate të paparashikueshme.

Duke pasur parasysh këtë fakt, analiza gjinore në këtë dokument është realizuar për pesë sektorët prioritarë të parashikuar në procesin e Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP) për të garantuar që ndërhyrjet të mos thellojnë pabarazitë gjinore dhe kur është e mundur, të rrisin nivelin e barazisë gjinore dhe drejtësisë në marrëdhënie.

Sipas Udhëzimeve Teknike të Siguruara nga KKKBNK në vitin 2019:

- **Integrimi i aspekteve gjinore** përfshin integrimin në mënyrë sistematike të aspekteve gjinore në masat përkatëse, duke përcaktuar një nivel bazë për aspektet gjinore, hartimin e masave me pjesëmarrje, caktimin e objektivave dhe të veprimtarive, si dhe zhvillimin e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit me ndjeshmëri gjinore. Njohja dhe trajtimi i nevojave dhe kapaciteteve të ndryshme të grave dhe burrave janë thelbësore për hartimin e Planeve Kombëtare të Përshtatjes (PKP) me përgjegjshmëri gjinore. Proceset gjithëpërfshirëse të planifikimit dhe hartimit të politikave, duke përfshirë procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje ku bëjnë

pjesë edhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC), janë thelbësore për të garantuar pjesëmarrje dhe ndikim gjinor të barabartë (**Rrjeti Global i PKP-ve dhe KKKBNK, 2019**).

- **Qasjet me ndjeshmëri gjinore** pranojnë ekzistencën e normave, roleve dhe marrëdhënieve gjinore, por nuk trajtojnë në mënyrë aktive pabarazitë që rezultojnë prej tyre. Ato fokusohen në kuptimin e dallimeve gjinore.
- **Qasjet me përgjegjshmëri gjinore** trajtojnë në mënyrë aktive normat, rolet dhe pabarazitë gjinore, me synimin për të promovuar barazinë gjinore përmes veprimeve specifike që fuqizojnë gratë në familje dhe komunitete, si dhe që ndikojnë në proceset më të gjera të planifikimit dhe hartimit të politikave. Këto qasje shkojnë përtej ndjeshmërisë gjinore përmes ndërmarrjes së hapave konkretë drejt barazisë gjinore (**KKKBNK, 2019**).
- **Qasjet transformuese gjinore** shkojnë përtej qasjeve me përgjegjshmëri gjinore duke trajtuar shkaqet themelore të pabarazisë dhe diskriminimit me bazë gjinor. Ato kundërshtojnë në mënyrë aktive normat e dëmshme gjinore dhe synojnë ndryshimin e këtyre normave, krijimin e marrëdhënieve më të barabarta të pushtetit ndërmjet individëve të të gjitha gjinive, si dhe transformimin e sistemeve dhe strukturave që përforcojnë pabarazitë gjinore. Këto qasje fokusohen në ndryshime strukturore afatgjata duke nxitur ndarjen e kompetencave, të kontrollit të burimeve dhe të vendimmarrjes, duke angazhuar njëkohësisht të gjithë anëtarët e shoqërisë, përfshirë burrat dhe djemtë, si agjentë të ndryshimit (**KKKBNK, 2019**).

Pjesa 2 - Angazhimet e qeverisë për integrimin e aspekteve gjinore në politikat për klimën

Shqipëria ka nënshkruar një sërë angazhimesh ndërkombëtare detyruese dhe jodetyruese në

lidhje me adresimin e barazisë gjinore (Tabela 2).

Vendi ka ndërmarrë hapa fillestarë për integrimin e aspekteve gjinore në politikat dhe programet e tij për ndryshimet klimatike. Këtu përfshihen udhëzimet për integrimin e aspekteve gjinore në programet dhe planet e zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në KKK.

Tabela 2. Angazhimet e qeverisë për integrimin e aspekteve gjinore në politikat për klimën

Angazhimet detyruese	Angazhimet jodetyruese
<p>Konventa e Këshillit të Evropës e vitit 2011 “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (“Konventa e Stambollit”)</p> <p>Konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (CeDaW)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • KKKBNK • Platforma për Veprim e Pekinit • Protokollin e Kiotos • Marrëveshja e Kopenhagës • Marrëveshja e Parisit • Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ)

Tabela 3. Marrëveshjet ndërkombëtare kryesore për aspektet gjinore, mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në të cilat Shqipëria ka ndërmarrë angazhime

Organizata/Marrëveshja	Detajet
<p>Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK)</p> <p>Konventa është miratuar në maj të vitit 1992 dhe është hapur për nënshkrim një muaj më vonë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin (UNCED) në Rio de Zhaneiro. Ajo ka hyrë në fuqi në mars të vitit 1994.</p>	<p>KKKBNK-ja synon të arrijë ekuilibrin gjinor në organet e krijuara në kuadër të Konventës, Protokollit të Kiotos dhe Marrëveshjes së Parisit, për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe për të zhvilluar politika më efektive të ndryshimeve klimatike që trajtojnë nevojat e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë.</p> <p>KKKBNK-ja bën thirrje për përshtatje me ndjeshmëri gjinore dhe kërkon që Fondi i Gjellbër për Klimën (FGJK) të promovojë përfitimet e përbashkëta mjedisore, sociale, ekonomike dhe të zhvillimit, si dhe të ndërmarrë një qasje me ndjeshmëri gjinore.</p>

<p>Agjenda 21 e Kombeve të Bashkuara Agjenda 21 u miratua në Rio de Janeiro në vitin 1992.</p>	<p>Kapitulli 24 i Agjendës 21, që titullohet “Veprimi Global për Gratë drejt Zhvillimit të Qëndrueshëm”, kërkon që qeveritë të bëjnë ndryshimet e nevojshme kushtetuese, ligjore, administrative, kulturore, sociale dhe ekonomike për të eliminuar të gjitha pengesat ndaj përfshirjes së plotë të grave në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në jetën publike. Agjenda 21 thekson rëndësinë e njohurive dhe praktikave tradicionale të grave dhe nënvizon kontributin e grave në ruajtjen e biodiversitetit.</p>
<p>Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim nga Konferenca e Katërt Botërore për Gratë</p>	<p>Deklarata kërkon përfshirjen aktive të grave në vendimmarrjen për çështjet mjedisore në të gjitha nivelet, integrimin e shqetësimeve dhe perspektivave gjinore në politikat dhe programet për zhvillim të qëndrueshëm, si dhe përfundimin ose ngritjen e mekanizmave në nivele kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për të vlerësuar ndikimin e politikave për zhvillimin dhe mjedisin te gratë.</p>
<p>Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). Instrumenti kryesor për mbrojtjen e të drejtave të grave është CEDAW, që është miratuar në vitin 1979 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Një Protokoll Opsional i CEDAW është miratuar në vitin 1999 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2000.</p>	<p>CEDAW sigurohet që gratë të kenë mundësinë për të përfaqësuar qeveritë e tyre në nivel ndërkombëtar dhe për të marrë pjesë në punën e organizatave ndërkombëtare; që gratë të kenë të drejta të barabarta për të aksesuar kreditë bankare, kreditë hipotekare, si dhe format e tjera të kredisë financiare (i) që të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga zhvillimi rural; (ii) që të marrin pjesë në planifikimin e zhvillimit në të gjitha nivelet; (iii) që të marrin shërbime trajnimi, edukimi dhe ekstensionit; (iv) që të kenë akses në kreditë dhe huatë bujqësore, në shërbimet e marketingut dhe në teknologjinë e përshtatshme; dhe (v) që të trajtohen në mënyrë të barabartë në reformën e tokës, atë agrare dhe në skemën e rishpërndarjes së tokave.</p>
<p>Marrëveshja e Parisit dhe Protokollin e Kiotos</p>	<p>Rëndësia e integritimit të barazisë gjinore në veprimet për klimën është përfshirë në Preambulë, dhe është mbështetur zbatimi i masave me përgjegjshmëri gjinore.</p>
<p>Konventa e Këshillit të Evropës e vitit 2011 “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (“Konventa e Stambollit”)</p>	<p>Konventa hyri në fuqi më 1 gusht të vitit 2014 dhe e konsideron dhunën me bazë gjinore kundër grave si një shkelje e të drejtave të njeriut dhe si një formë diskriminimi.</p>
<p>Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM)</p>	<p>Deklarata garanton të drejta dhe mundësi të barabarta për gratë dhe burrat; promovon barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave si mënyra efektive për të luftuar varfërinë, urinë dhe sëmundjet, dhe për të nxitur një zhvillim realisht të qëndrueshëm; si dhe garanton që përfitimet e teknologjive të reja, veçanërisht të teknologjive të informacionit dhe komunikimit, të jenë të disponueshme për të gjithë.</p>
<p>Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) - OZHQ 5</p>	<p>Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave</p>

Megjithatë, integrimi i barazisë gjinore në kuadrot ligjorë dhe të politikave për klimën mbetet një punë në zhvillim e sipër. Në **ligjin nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”**, aktualisht mungojnë aspektet e qarta gjinore, por ai është në proces rishikimi. Versioni i ri parashikohet që të përfshijë elemente me përgjegjshmëri gjinore, duke trajtuar këtë hendek kritik në legjislacionin ekzistues. Zhvillimet e fundit në disa sektorë të caktuar paraqiten të jenë mjaft premtuese. Konkretisht, **Strategjia e Shqipërisë për Zhvillimin e Turizmit 2024-2030** ka përfshirë aspektet gjinore, duke shënuar një hap pozitiv drejt integritit të aspekteve gjinore në politikat sektoriale.

Pavarësisht këtyre përparimeve, sfidat mbeten të pranishme. Një sërë politikash dhe strategjish për klimën, duke përfshirë **Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike (2020-2030)**¹⁵ dhe **Politikën Kombëtare për Pyjet (2019-2030)**¹⁶, ende nuk i kanë integruar aspektet gjinore në mënyrë të konsoliduar. Plani i Integruar **Ndërsektorial** i Zonës Tiranë-Durrës¹⁷ dhe Plani i Veprimit “Qyteti i Gjelbër” për Bashkinë Tiranë, ndonëse kanë bërë njëfarë progresi, kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm në lidhje me planifikimin dhe monitorimin me përgjegjshmëri gjinore¹⁸. Një çështje kyç që qëndron në themel të këtyre hendeqeve është përfaqësimi dhe pjesëmarrja e kufizuar e grave dhe grupeve të disavantazuara në proceset e vendimmarrjes për çështjet mjedisore¹⁹. Trajtimi i këtyre çështjeve kërkon përpjekje proaktive për të garantuar përfshirjen

e pikëpamjeve të larmishme në qeverisjen për klimën²⁰, në përputhje me angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Konventës së Aarhus-it. Në rrugën drejt progresit, Shqipëria duhet të përforcojë qasjen e saj në lidhje me integrimin e aspekteve gjinore në të gjitha politikat dhe veprimet për klimën. Kjo përfshin përmirësimin e mbledhjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë, kryerjen e vlerësimeve të ndikimit gjinor, si dhe garantimin e pjesëmarrjes efektive të grave dhe grupeve të marginalizuara në formulimin dhe zbatimin e politikave. Këta hapa janë thelbësorë për zhvillimin e strategjive gjithëpërfshirëse, shteruese dhe efektive për klimën, të cilat trajtojnë nevojat dhe cenueshmëritë e të gjitha segmenteve të shoqërisë shqiptare.

15. Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike është një politikë kombëtare me qasje ndërsektoriale; ajo përfshin dy anekse: Planin Kombëtar të Veprimit për Zbutjen (PKVZ) dhe Planin Kombëtar të Përshtatjes (PKP), që janë të disponueshëm në: <https://www.fao.org/faolex/results/details/en/c/LEX-FAOc211874/>

16. I disponueshëm në: <https://www.fao.org/faolex/results/details/es/c/LEX-FAOc204065/>

17. I aksesueshëm në: <https://www.yumpu.com/en/document/read/59900990/integrated-cross-sectorialplan-of-tirana-durres-area>

18. Bashkia e Tiranës (2018). Plani i Veprimit “Qyteti i Gjelbër” për Bashkinë Tiranë. I disponueshëm në: <https://ebrdgreencities.com/assets/Uploads/PdF/tirana-GcAP.pdf> (Versioni në gjuhën angleze); dhe në: <https://ebrdgreencities.com/assets/Uploads/PdF/tirana-GcAP-Alba.pdf> (Versioni në gjuhën shqipe).

19. Rrjeti i Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore (2019). Raport i organizatave të shoqërisë civile për zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit në Shqipëri, Pekin+25. I disponueshëm në: <https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/Get%20involved/Beijing-25/Generation-Equality-Forum/csO-Beijing-report-Albania-en.pdf>

20. Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (KEKBE) (1998). Konventa për aksesin në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe aksesin në drejtësi për çështjet mjedisore. Shihni: <https://unece.org/dAM/env/pp/documents/cep43e.pdf>

Shtojca II: Analiza gjinore në sektorët kryesorë të PKP-së

Bujqësia dhe zhvillimi rural

Rëndësia e aspekteve gjinore në përshtatjen e sektorit të bujqësisë

Aspektet gjinore janë thelbësore për përshtatjen e sektorit të bujqësisë, veçanërisht në kontekstin rural shqiptar. Gratë luajnë një rol të konsiderueshëm në sektorin e bujqësisë, ku shpeshherë menaxhojnë fermat familjare dhe kontribuojnë ndjeshëm në sigurinë ushqimore. Megjithatë, ato përballen shpesh me akses të pabarabartë në burime, në pronësinë e tokës, në kredi dhe informacione bujqësore. Ndikimet e ndryshimeve klimatike, të tilla si ndryshimet në modelet e reshjeve dhe rritja e ngjarjeve ekstreme të motit, mund të ndikojë në mënyrë joproporcionale te gratë fermere për shkak të këtyre pabarazive ekzistuese. Integrimi i aspekteve gjinore në strategjitë e përshtatjes për sektorin bujqësor garanton trajtimin e nevojave dhe njohurive specifike të grave, duke përmirësuar qëndrueshmërinë e tyre ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo qasje mund të rezultojë në masa përshtatjeje më efektive, duke qenë se gratë shpesh kanë njohuri tradicionale në lidhje me varietetet e kulturave dhe praktikave bujqësore, të cilat mund të jenë me vlerë për qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike. Përmes fuqizimit të grave në sektorin e bujqësisë nëpërmjet aksesit të barabartë në burime, trajnim dhe proceset e vendimmarrjes, Shqipëria mund të përforcojë kapacitetin e saj të përgjithshëm të përshtatjes së sektorit të bujqësisë dhe të promovojë një zhvillim rural më të qëndrueshëm dhe të barabartë ndaj ndryshimeve klimatike.

Të dhënat bazë dhe vlerësimet e cenueshmërisë

Bujqësia zë një vend të rëndësishëm në Shqipëri, duke kontribuar me 18,6% në PBB-në totale të vendit në vitin 2022, dhe duke shërbyer si burimi kryesor i të ardhurave për 25% të popullsisë²¹. Në vitin 2022, kulturat kryesore të kultivuara në Shqipëri përfshinin drithërat, të cilat përbënin 31,5% të tokës së kultivuar, foragjeret përbënin 52,26%, perimet përbënin 8,1%, patatet përbënin 2,38% dhe fasulet e bardha përbënin 3,12%²².

Sektori bujqësor është një ndër më të cenueshmit ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Çdo aspekt i bujqësisë, duke përfshirë qëndrueshmërinë e çmimeve, varet nga ndryshimet në modelet klimatike. Reshjet e shiut dhe faktorët e tjerë klimatikë luajnë role të rëndësishme në përcaktimin e rendimentit të kulturave dhe të prodhimit blegtoral, pasi një pjesë e konsiderueshme e prodhimit bujqësor varet në masë të madhe nga reshjet natyrore. Historikisht, përmytjet, thatësitat dhe reshjet e parregullta kanë pasur një ndikim të konsiderueshëm në prodhimtarinë bujqësore. Studimet tregojnë vazhdimisht se luhatjet e shtuara të temperaturave dhe reshjeve ndikojnë negativisht mbi prodhimin e kulturave.

Sishumë rajonet tjera, edhe Shqipëria kapërjetuar efekte negative mbi kulturat bujqësore bazë, të tilla si gruri dhe misri, në zona si Shkodra, Lezha, Lushnja, Fieri dhe Vlora për shkak të ndryshimeve klimatike. Cenueshmëria e sektorit lind për shkak të ndjeshmërisë së lartë dhe të kapacitetit përshtatës të kufizuar të tij. Përpjekjet në kuadër të sektorit të bujqësisë synojnë të përmirësojnë qëndrueshmërinë duke përmirësuar menaxhimin

21. INSTAT 2023. <https://www.statista.com/statistics/444090/albania-gdp-distribution-across-economic-sectors/>

22. INSTAT 2023. <https://www.statista.com/statistics/444090/albania-gdp-distribution-across-economic-sectors/>

e plehut, sistemet e kullotjes, rotacionin e kulturave dhe kalimin në varietete kulturash që janë rezistente ndaj thatësirave. Megjithatë, sfidat mbeten të pranishme, veçanërisht për fermerët e vegjël, të cilëve shpeshherë u mungojnë burimet financiare dhe aksesin në teknologji.²³

Trajtimi i ndikimeve të ndryshimeve klimatike në bujqësi kërkon investime të konsiderueshme në shpërndarjen e teknologjisë, ruajtjen e tokës dhe ujit, infrastrukturën e ujitjes dhe aksesin në informacionin hidrometeorologjik. Rritjet e vëzhguara të ngjarjeve të motit ekstrem, si përmbytjet, rrëshqitjet e tokës dhe shpërthimet e dëmtuesve/insekteve të dëmshme, thellojnë më tej cenueshmërinë e këtij sektori. Për më tepër, ndryshimet në modelet e reshjeve dhe luhatjet e temperaturave paraqesin sfida të konsiderueshme, duke rezultuar në reduktim të prodhimit të kulturave dhe rritje të ndryshueshmërisë së rendimentit.²⁴

Ndonëse disa rajone mund të përfitojnë nga rritjet e temperaturës, gjë që ofron mundësi për kultivim të dyfishtë, rajonet e tjera do të përballen me reduktim të rendimentit dhe cenueshmëri të shtuar ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve. Varësia e sektorit të bujqësisë nga ferat e vogla dhe familjare përshkallëzon sfidat, pasi këtyre subjekteve shpeshherë u mungojnë burimet për përshtatje efektive.

Në Shqipëri, ultësirat perëndimore, që përbëjnë një sipërfaqe bujqësore të konsiderueshme, përballen me cenueshmëri të shtuar për shkak të ndryshimeve klimatike, ku sfidat përfshijnë prodhimtarinë e ulët, pronësinë e tokave të fragmentuara dhe kontrollet e pamjaftueshme fitosanitare. Prodhimi blegtoral, si ai intensiv ashtu edhe ai ekstensiv, është gjithashtu në rrezik, pasi temperaturat në rritje ndikojnë në cilësinë

e foragjereve dhe disponueshmërinë e ujit, duke ndikuar në shëndetin dhe prodhimtarinë blegtorale.

Trajtimi i ndikimeve të ndryshimeve klimatike në sektorin e bujqësisë kërkon një qasje të shumanshme, duke përfshirë investimet në teknologji, infrastrukturë dhe shpërndarje të informacionit, si dhe mbështetjen për fermerët e vegjël dhe strategjitë e përshtatjes të personalizuara për kontekstet rajonale.

Integrimi i aspekteve gjinore në politikat për klimën

Strategjia e Shqipërisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin (SBZHRP) 2021- 2027 paraqet mangësi të konsiderueshme në lidhje me trajtimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave në sektorin e bujqësisë. Strategjia e trajton barazinë gjinore kryesisht në mënyrë deklarative, pa përfshirë masa thelbësore për të trajtuar disavantazhet sistematike me të cilat përballen gratë në sektorin e bujqësisë²⁵. Kjo qasje nuk arrin të përmbushë integrimin gjithëpërfshirës të aspekteve gjinore të kërkuar nga standardet ndërkombëtare dhe politikat e BE-së.

Strategjia duhet të harmonizohet me disa kuadro kyç kombëtarë dhe ndërkombëtarë:

Angazhimet në CEDAW: Në veçanti, nenet 11 (të drejtat për punësim), 13 (përfitimet ekonomike dhe sociale), 14 (gratë në zonat rurale), 15 (barazia përpara ligjit) dhe 16 (jeta martesore dhe familjare). Këto nene ofrojnë udhëzime specifike mbi mënyrën e garantimit të barazisë në aspekte të ndryshme të jetës së grave në zonat rurale, duke përfshirë aksesin në mundësitë ekonomike, përfitimet sociale dhe proceset e vendimmarrjes²⁶.
Legjislacioni kombëtar për barazinë gjinore:

23. Planifikimi Kombëtar i Përshtatjes (PKP) ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri, Kuadri për Procesin e Vendit. URL: https://unfccc.int/sites/default/files/resource/National_Adaptation_Plan_Albania.pdf

24. Teqja, Z., Kopali, A., Libohova, Z. Dhe Owens, P. (2017). A study of the impacts of climate change scenarios on the plant hardiness zones of Albania (Një studim mbi ndikimet e skenarëve të ndryshimeve klimatike në zonat me qëndrueshmëri të bimëve në Shqipëri). *J. of Appl. Meteorology and Climatology*. 56(3): 615–631. DOI: <https://doi.org/10.1175/JAMC-D-16-0108.1>

25. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2022). Strategjia për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021–2027.

26. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (1979). Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).


Strategjia duhet të harmonizohet me ligjin e Shqipërisë nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i cili përkufizon termin “integrim gjinor” dhe përcakton standardet për barazinë gjinore²⁷.

Kuadrot e politikave të BE-së: Harmonizimi me standardet e BE-së për barazinë gjinore është thelbësor, veçanërisht teksa Shqipëria po avancohet drejt anëtarësimit në BE. Kjo përfshin pajtueshmërinë me Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore III të BE-së dhe me direktivat përkatëse

për barazinë gjinore në fushën e zhvillimit rural dhe bujqësor²⁸. Mungesa e integritit të aspekteve gjinore në ligjin nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike” përbën një tjetër hendek të konsiderueshëm në kuadrin e politikave të Shqipërisë. Ky ligj rregullon ndryshimet klimatike në Shqipëri dhe cakton Ministrinë e Mjedisit si autoritetin kryesor kombëtar për çështjet e ndryshimeve klimatike. Megjithatë, nuk parashikon integrimin e aspekteve gjinore në politikat e ndryshimeve klimatike²⁹. Kjo

27. Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 125, datë 01.08.2008.

Figura 5. Punësimi sipas sektorit dhe gjinisë në Shqipëri



28. Komisioni Evropian dhe Bënjësori i Lartë i BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë (2020). Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore III i BE-së – Një agjendë ambicioze për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në veprimet e jashtme të BE-së.

29. Ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”, Republika e Shqipërisë.

mospërfshirje është në harmonizim me natyrën jodetyruese të rekomandimeve të KKKBNK-së për analizën gjinore në veprimet për klimën, por konsiston në një mundësi të humbur për të trajtuar ndikimet gjinore të ndryshimeve klimatike, veçanërisht në sektorin e bujqësisë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se ligji nr. 155/2020 është aktualisht në proces rishikimi. Versioni i përditësuar parashikohet që ta trajtojë këtë hendek, duke integruar aspektet gjinore në kuadrot e politikave për klimën. Ky rishikim përbën një mundësi të konsiderueshme për të harmonizuar legjisllacionin shqiptar për ndryshimet klimatike me praktikën më të mira ndërkombëtare në drejtim të veprimeve për klimën me përgjegjshmëri gjinore.

Hendeqet gjinore dhe sfidat

Sektori i bujqësisë në Shqipëri përballet me hendeqe gjinore të konsiderueshme dhe sfida që pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe fuqizimin ekonomik të grave. Nga totali i personave të punësuar në Shqipëri (1 298 380 persona), në sektorin e bujqësisë janë të punësuar 440 872 persona (33,9% e numrit total të të punësuarve). Ndërsa gratë përbëjnë 40,1% të fuqisë punëtore (gra) në sektorin e bujqësisë (239 775 gra nga 597 694 gra të punësuar), krahasuar me 28,7% të burrave (201 097 burra nga 700 686 burra të punësuar), nëse vërejmë konkretisht forcën e punës së sektorit bujqësor, gratë në fakt përbëjnë 54,4% të të punësuarve në sektorin e bujqësisë, krahasuar me 45,6% të burrave. Ky përfaqësim më i lartë në sektor i bën gratë më të ekspozuara ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike në sektorin e bujqësisë. (INSTAT, 2023).

Stereotipat gjinorë dhe praktikën diskriminuese e kufizojnë ndjeshëm aksesin e grave në burimet thelbësore për prodhimin bujqësor, duke përfshirë tokën, kredinë, teknologjinë dhe

fuqinë vendimmarrëse³⁰. Kjo përkeqësohet nga sistemi aktual i regjistrimit të fermave, i cili njeh kryesisht kryefamiljarët meshkuj, duke kufizuar aksesin e grave në shërbime mbështetëse dhe mundësi ekonomike. Në vitin 2022, vetëm 10,8% e fermerëve të regjistruar zyrtarisht ishin gra (INSTAT, 2022).

Një sfidë kritike qëndron në ofrimin e shërbimeve të ekstensionit bujqësor mbi baza gjinore. Këto shërbime favorizojnë kryesisht burrat, ndërsa gratë përbëjnë vetëm 8% të përfutësve në vitin 2023 (UN Women). Kjo pabarazi gjinore në aksesin ndaj informacionit, teknologjive dhe mbështetjes bujqësore ndikon ndjeshëm në produktivitetin e grave dhe aftësinë e tyre për të asimiluar praktika bujqësore novatore. Mungesa e qasjeve me përgjegjshmëri gjinore në shërbimet e ekstensionit, e kombinuar me kapacitetin e kufizuar për të integruar aspektet gjinore brenda stafit, i jep shtysë përjashtimit të grave fermere nga njohuritë dhe burimet thelbësore (UN Women).

Për më tepër, sistemi i arsimit profesional në drejtimin e bujqësisë nuk arrin të mbështesë siç duhet perspektivat për karrierë të grave dhe vajzave. Pjesëmarrja e femrave në shkollat profesionale bujqësore është jashtëzakonisht e ulët, përafërsisht 16%, dhe pjesëmarrja nga zonat rurale është e papërfillshme. Kjo jo vetëm që kufizon perspektivat e ardhshme të punësimit për gratë e zonave rurale në këtë sektor, por gjithashtu kontribuon në mungesën e eksperteve bujqësore femra dhe të ekstensionistëve, duke penguar më tej informimin e grave fermere. Mungesa e një kurrikule me ndjeshmëri gjinore, e mjedisëve të sigurtë mësimorë dhe e mbështetjes së synuar për studentet femra e përkeqëson këtë problematikë (Komisioni Evropian, 2023).

Politikat, programet, buxhetet dhe skemat e mbështetjes në nivel kombëtar në sektorin e bujqësisë nuk i përgjigjen nevojave të grave në mënyrë të mjaftueshme. Strategjisë aktuale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin

30. FAO (2016). Gjinia, bujqësia dhe zhvillimi rural në Shqipëri (Gender, Agriculture, and rural development in Albania)

2021-2027 i mungon një perspektivë gjinore e konsoliduar dhe masat efektive për të trajtuar disavantazhet sistematike të grave në këtë sektor (UN CEDAW, 2023). Kjo pasqyrohet në përqindjen në rënie të grave përfituese në skemat kombëtare të mbështetjes, duke u reduktuar nga 22% në vitin 2018 në 16% në vitin 2023, pavarësisht rritjeve të përgjithshme të numrit të grave që përfitojnë nga këto skema.

Trajtimi i këtyre sfidave kërkon një qasje të shumanshme që përfshin një reformë me përgjegjshmëri gjinore të shërbimeve të ekstensionit bujqësor, arsimit profesional dhe kuadrove të politikave. Kjo duhet të përfshijë ngritjen e kapaciteteve të stafit të ekstensionit për metodat e me ndjeshmëri gjinore, rritjen e numrit të grave ekstensioniste dhe garantimin që shërbimet të jenë të aksesueshme dhe të vlefshme për gratë fermere. Sa i takon arsimin profesional, nevojiten reforma gjithëpërfshirëse për t'i bërë programet më tërheqëse dhe të vlefshme për vajzat dhe gratë, duke përfshirë masat për të garantuar mjedise të sigurta mësimore dhe për të ofruar mbështetje të synuar, për shembull përmes bursave. Për më tepër, integrimi i perspektivave gjinore në të gjitha seksionet e strategjive bujqësore, miratimi i masave të përkohshme të veçanta për të promovuar pjesëmarrjen e grave dhe zbatimin sistematik të vlerësimeve të ndikimit gjinor për të mbështetur skemat, janë hapa thelbësorë drejt krijimit të një sektori bujqësor më gjithëpërfshirës dhe të barabartë në Shqipëri (Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, 2023).

Turizmi

Rëndësia e aspekteve gjinore në përshtatjen e sektorit të turizmit

Aspektet gjinore luajnë një rol jetik në strategjitë e përshtatjes së sektorit të turizmit, pasi ky i fundit përfshin dimensione gjinore të konsiderueshme që ndërthuren me ndikimet e ndryshimeve klimatike. Industria e turizmit shpesh punëson një

përqindje të lartë të grave, veçanërisht në rolet e shërbimit, pozicionet sezonale dhe në sektorët informalë. Megjithatë, në shumë raste gratë janë të nënpërfaqësuar në rolet drejtuese dhe vendimmarrëse brenda industrisë. Ndryshimet klimatike mund t'i përshkallëzojnë këto pabarazi gjinore ekzistuese dhe të paraqesin sfida të reja. Strategjitë e përshtatjes në sektorin e turizmit duhet të marrin në konsideratë ndikimet e ndryshme të ndryshimeve klimatike mbi burrat dhe gratë brenda sektorit. Për shembull, ngjarjet ekstreme të motit ose ndryshimet në modelet e turizmit për shkak të ndryshimeve klimatike mund të prekin në mënyrë joproporcionale mjetet e jetesës së grave, veçanërisht të atyre që janë në pozicione të cenueshme ose pjesë e punësimit informal. Gratë gjithashtu mund të përballen me sfida më madhore për të aksesuar burimet, trajnimet dhe teknologjitë e nevojshme për t'u përshtatur ndaj kushteve të ndryshueshme në industrinë e turizmit.

Përshtatja me përgjegjshmëri gjinore e sektorit të turizmit mund të krijojë mundësi për fuqizimin ekonomik dhe qëndrueshmërinë ekonomike të grave. Kjo mund të përfshijë promovimin e liderit të grave në nismat e turizmit të qëndrueshëm, mbështetjen e bizneseve të udhëhequra nga gratë në fushën e ekoturizmit ose të produkteve turistike të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike, dhe garantimin e aksesit të barabartë në programet e ngritjes së kapaciteteve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Për më tepër, strategjitë e përshtatjes duhet të marrin në konsideratë sigurinë dhe nevojat specifike të grave turistike dhe të grave që punojnë në industri, veçanërisht në kontekstin e rreziqeve të shtuara në lidhje me klimën.

Duke integruar aspektet gjinore në planet e përshtatjes së sektorit të turizmit, destinacionet mund të zhvillojnë strategji më gjithëpërfshirëse dhe efektive, të cilat jo vetëm që rrisin qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike, por edhe promovojnë barazinë gjinore brenda sektorit. Kjo qasje mund të rezultojë në zhvillim më

të qëndrueshëm dhe të drejtë të turizmit, në dobi të komuniteteve dhe industrisë vendase përballë sfidave që paraqesin ndryshimet klimatike.

Të dhënat bazë dhe vlerësimet e cenueshmërisë

Turizmi, veçanërisht përgjatë zonave bregdetare të tilla si ajo e detit Adriatik, nxisin rritjen ekonomike në mënyrë të konsiderueshme. Ai mbetet një nga katalizatorët kryesorë të prosperitetit ekonomik të rajonit³¹. Shqipëria mbështetet në masë të konsiderueshme në sektorin e turizmit, i cili ka ndikim të thellë në rritjen ekonomike, në punësim dhe në zhvillimin social. Në vitin 2020, sektori i turizmit kontribuoi drejtpërdrejt në PBB, duke arritur në vlerën 169,7 miliardë lekë, me një kontribut të përgjithshëm prej 10,6% në ekonominë totale dhe krijimin e 194 600 vendeve të reja të punës, që përbëjnë afërsisht 17,5% të punësimit total në vend. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) e identifikon sektorin e turizmit si një “motor” kyç për rritjen ekonomike kombëtare.

Megjithatë, turizmi në Shqipëri ende nuk është zhvilluar plotësisht për shkak të kufizimeve të tilla si infrastruktura e kufizuar dhe kapacitetet akomoduese të kufizuara, standardet dhe cilësia nën nivel e shërbimeve, ofertat dhe produktet turistike të pamjaftueshme, si dhe bashkëpunimi dhe koordinimi i pamjaftueshëm midis palëve të interesit të industrisë. Shumica e aktiviteteve turistike të Shqipërisë janë të përqendruara përgjatë bregdetit të detit Adriatik, i cili ka brigje ranore dhe shkëmbore dhe përfshin ekosisteme jetësore. Pavarësisht numrit në rritje të zonave të mbrojtura përgjatë bregdetit, shqetësimet antropogjene, të tilla si menaxhimi i papërshtatshëm i mbetjeve, turizmi dhe urbanizimi i paplanifikuar, rritja e pakontrolluar e popullsisë urbane dhe mungesa e menaxhimit të integruar të zonës bregdetare nga autoritetet vendore,

paraqesin kërcënime të konsiderueshme për ekosistemet bregdetare.

Për trajtimin e këtyre sfidave, Shqipëria ka ngritur Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për të garantuar mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave bregdetare. Agjencia synon të koordinojë projektet, të nxisë investimet e donatorëve dhe të zbatojë masa për zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Rekomandimet e Komunikimit të Tretë Kombëtar përfshijnë kontributin në vlerësimin e rrezikut të ndryshimeve klimatike dhe planifikimin e përshtatjes, zhvillimin e faqeve informuese të internetit mbi masat e përshtatjes, përmirësimin e cilësisë së produkteve turistike, kryerjen e programeve të trajnimit mbi përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe marrjen në konsideratë të ndryshimeve klimatike në vlerësimet financiare të projekteve.

Ndryshimet klimatike paraqesin rreziqe të konsiderueshme ndaj infrastrukturës turistike, duke përfshirë hotelet, parqet e rekreacionit dhe qendrat e transportit, si dhe ndaj infrastrukturës mbështetëse, siç janë aeroportet, rrugët dhe portet. Rritja e parashikuar e nivelit të detit, rritja e stuhive detare dhe ndryshimet e ekosistemeve bregdetare do të përkeqësojnë cenueshmëritë, veçanërisht për 97% të popullsisë që jeton në rrezen brenda 100 km nga bregdeti. Zhvillimi urban i parregulluar dhe shpyllëzimi kontribuojnë në erozionin bregdetar dhe rrisin rrezikun e dëmeve nga ngjarjet ekstreme të motit.

Rajonet bregdetare, të njohura për ndjeshmërinë e tyre ndaj kushteve klimatike, përballen me sfida të afërta si rezultat i ndryshimeve klimatike. Rajoni i Mesdheut parashikohet të përjetojë rënie të atraktivitetit të tij për shkak të kërcënimeve të parashikuara si thatësitat, mungesa e ujit, valët e të nxehtit, rritja e temperaturave dhe rritja e zjarreve masive. Këta faktorë paraqesin rrezik të konsiderueshëm ndaj turizmit veror përgjatë bregdeteve. Nga ana tjetër, temperaturat e larta

31. Selimi, N.; Sadiku, L. and Sadiku, M. 2017: The impact of tourism on economic growth in the Western Balkan countries. An empirical analysis. (Ndikimi i turizmit në rritjen ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor. Një analizë empirike.) URL: <https://ideas.repec.org/a/tei/journal/V10y2017i2p19-25.html>

në këto zona, në mënyrë paradoksale, mund të nxisin turizmin në terrene malore dhe kodrinore. Ndërsa ndikimi i mundshëm i ndryshimeve klimatike në sektorin e peshkimit artizanal mbetet i paeksploruar mjaftueshëm, parashikimet tregojnë se rritja e temperaturave të sipërfaqes së detit mund ta ndërpresë funksionimin e kësaj industrie jetësore. Fatkeqësisht, planifikimi aktual i turizmit nuk përfshin në mënyrë të mjaftueshme masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Për shembull, ndërtimi i infrastrukturës turistike shpesh zhvillohet pa ushtruar konsideratën e duhur ndaj dëmeve potenciale të shkaktuara nga ngjarjet ekstreme si përmbytjet, stuhitë, erozionit detar dhe thatësira. Përtej këtyre kërcënimeve të drejtpërdrejta, ka pasoja më të gjera të tërthorta të ndryshimeve klimatike në sektorin e turizmit. Këto përfshijnë ndryshimet në cilësinë e ujërave të ëmbla, humbjen e biodiversitetit, ndryshimet në prodhimin bujqësor që ndikojnë në enoturizëm, rritjen e rreziqeve të rrëshqitjeve të tokës dhe zjarreve në pyje, si dhe një incidencë më të lartë të sëmundjeve të transmetuara nga insektet. Temperaturat ekstreme dhe reshjet e çrregullta mund të zvogëlojnë atraktivitetin e bregdetit të Shqipërisë gjatë muajve të verës (qershor deri në shtator), pavarësisht nga skenari klimatik. Rritja e temperaturave të ujit të detit dhe të sipërfaqes së detit po prish ekosistemet, duke shkaktuar rritje të popullatës së kandilave të detit, lulëzime të algave të dëmshme, cianobaktere dhe formime mucilagjesh. Këto dukuri paraqesin një rrezik serioz ndaj turizmit bregdetar, aktiviteteve argëtuese dhe bizneseve të lidhura me to.

Dokumentet kombëtare të tilla si Komunikimi i Katërt Kombëtar (KKK), Komunikimi i Tretë Kombëtar (KTK) dhe Plani Kombëtar për Zhvillimin Hapësinor (SKZHI-III) ofrojnë këndvështrime të vlefshme në lidhje me kapacitetin përshtatës në sektorin e turizmit. Strategjitë e propozuara për të forcuar sektorin kundër ndikimeve të ndryshimeve klimatike përfshijnë integrimin e aspekteve klimatike në planifikimin e sektorit të

turizmit, miratimin e një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj zhvillimit të turizmit, përmirësimin e cilësisë së ofertave turistike, nxitjen e një kuadri ligjor dhe institucional të favorshëm për tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja, si dhe promovimin e fushatave të ndërgjegjësimit mjedisor. Konkretisht, **Strategjia e Shqipërisë për Zhvillimin e Turizmit 2024-2030** ka përfshirë aspektet gjinore, duke shënuar një hap pozitiv drejt integritit të aspekteve gjinore në politikat sektoriale.

Megjithatë, hendeqe të konsiderueshme vazhdojnë të ekzistojnë në politika, kuadro institucionalë, në ngritjen e kapaciteteve dhe përhapjen e njohurive për të adresuar ndryshimet klimatike në sektorin e turizmit. Kapaciteti përshtatës i industrisë së turizmit varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë kushtet socio-ekonomike, formulimin e politikave, kapacitetin institucional dhe burimet e disponueshme. Si të ardhurat publike, nëpërmjet taksave, ashtu edhe të ardhurat private të gjeneruara nga turizmi mund të kanalizohen në programe që synojnë fuqizimin e kapacitetit përshtatës.

Ndërsa politika dhe strategji të shumta qeveritare mbështesin turizmin në mënyrë të tërthortë, ato shpesh neglizhojnë domosdoshmërinë për të përmirësuar kapacitetin përshtatës brenda sektorit. Edhe pse Shqipëria ka ndërmarrë disa programe të fokusuara te ndryshimet klimatike, asnjë nuk është projektuar posaçërisht për industrinë e turizmit. Megjithatë, disa prej këtyre nismave mbartin implikime për turizmin.

Një hendek i konsiderueshëm njohurish vazhdon të ekzistojë në lidhje me ndikimin e ndryshimeve klimatike në sektorin e turizmit në Shqipëri. Ndërsa sektori i turizmit në vetvete është i dokumentuar mirë, kërkimet mbi cënueshmëritë dhe ndjeshmërinë e tij ndaj ndryshimeve klimatike janë në fazë fillestare. Si pasojë, ka mungesë njohurish të bazuara në prova, veçanërisht në nivel kombëtar, gjë që pengon formulimin e politikave të informuara dhe planifikimin e programeve.

Integrimi i aspekteve gjinore në politikat për klimën

Ndërkohë që nuk ka pasur studime të thelluara mbi gratë në sektorin e turizmit, në përputhje me tendencat ndërkombëtare, gratë janë të punësuara gjerësisht në sektor (përfshirë agroturizmin); shumë prej tyre në mënyrë informale ose si punonjëse në familje. Gratë janë gjithashtu më të prekura nga shqetësimet për sigurinë dhe mbrojtjen, si punonjëse ashtu edhe si turiste. Ndërsa vendi aspiron të bëhet destinacioni i ardhshëm turistik ndërkombëtar, tani është koha më e mirë për të përforcuar përfshirjen e aspekteve gjinore në sektorin e turizmit. Dëshmitë në rang global tregojnë se një përqindje e lartë e punonjëseve gra në sektorin e turizmit nuk përkthehet domosdoshmërisht në vende pune të sigurta dhe të denja, mundësi të përshtatshme karriere dhe paga të barabarta. Promovimi i turizmit me ndjeshmëri gjinore është rrjedhimisht jetik për arritjen e vizionit të deklaruar të vendit për “turizëm të qëndrueshëm”, në kuadër të Strategjisë Kombëtare të tij për Integrim Evropian dhe Zhvillim të Qëndrueshëm 2022-2030.

Hendeqet gjinore dhe sfidat

Sipas Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2024-2030, në sektorin e turizmit në Shqipëri janë të punësuar 42 698 individë. Edhe pse strategjia nuk ofron të dhëna të ndara sipas gjinisë specifike për turizmin, të dhënat e INSTAT për vitin 2022 tregojnë se në kategorinë më të gjerë “Tregtia, transporti, akomodimi dhe ushqimi, dhe shërbimet e biznesit dhe administrative”, gratë përbëjnë 22,5% të fuqisë punëtore femra ndërsa burrat 30,9% të fuqisë punëtore meshkuj. Këto të dhëna mbi punësimin nxjerrin në pah nevojën për një analizë me specifike gjinore të cenueshmërive klimatike në sektorin e turizmit, veçanërisht duke marrë parasysh natyrën e punësimit ku shumë pozicione janë sezonale, informale ose të

orientuara drejt shërbimeve, duke i bërë punonjësit potencialisht më të ndjeshëm ndaj problemeve ekonomike të lidhura me ndryshimet klimatike. Për më tepër, gratë mbeten të nënpërfaqësuar në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse, ku formulohen dhe zbatohen strategjitë e përshtatjes. Cenueshmëria e këtij sektori thellohet më tej nga sfidat strukturore në tregun e punës në Shqipëri, duke përfshirë aksesin e kufizuar në pozicione drejtuese, mundësitë më të pakta për zhvillim profesional dhe përgjegjësitë tradicionale të kujdesit për familjen. Këta faktorë nxjerrin në pah nevojën kritike për strategji të përshtatjes me përgjegjshmëri gjinore ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin e turizmit, të cilat trajtojnë si ndikimet e drejtpërdrejta klimatike, ashtu edhe cenueshmëritë themelore socio-ekonomike, ndërkohë që promovojnë struktura punësimi më të qëndrueshme dhe të drejta në të gjithë sektorin.

Ndërsa kontributi i tij në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror njihet gjerësisht nga studimet e ndryshme, me kalimin e viteve i është kushtuar pak vëmendje mënyrës se si industria e turizmit u sjell përfitime grave dhe burrave, si dhe marrëdhënies midis turizmit dhe barazisë gjinore. Sipas Organizatës Botërore të Turizmit (UNWTO), turizmi paraqet mundësi, por edhe vështirësi për gratë, duke e bërë perspektivën e barazisë gjinore një element shumë të rëndësishëm.

Nga pikëpamja e mundësive, turizmi mund të kontribuojë në disa mënyra në barazinë gjinore:

1. Duke ofruar mundësi të rëndësishme punësimi. Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), turizmi përbën një pikë hyrëse në tregun e punës, veçanërisht për gratë, të rinjtë, punonjësit emigrantë dhe popullsitë rurale, veçanërisht në vendet në zhvillim ose më pak të zhvilluara. Në fakt, në mbarë botën, gratë përbëjnë 60% dhe 70% të të gjithë punonjëseve në industrinë e turizmit. Në vitin 2011, pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore totale të turizmit në 28

shtetet anëtare të BE-së ishte 56%, krahasuar me një shkallë pjesëmarrjeje prej 46% në ekonominë e BE-së në tërësi. Për më tepër, turizmi është ngushtësisht i lidhur me sektorët e tjerë (transporti, ushqimi, mjedisi, produktet artizanale lokale etj.) dhe mund të krijojë më shumë punë në këto fusha. Për më tepër, shumë prej punëve në sektorin e turizmit janë fleksibël dhe mund të kryhen në vendndodhje të ndryshme, si për shembull nga shtëpia, vendi i punës ose në komunitet. Turizmi ofron gjithashtu punë me kohë të pjesshme dhe me turne, gjë që mund ta mbështesë ekuilibrin midis punës dhe jetës personale.

2. Duke rritur pjesëmarrjen e grave në jetën në komunitet dhe në vendimmarrje. Disa studime zbulojnë se pjesëmarrja e grave në sipërmarrjet e turizmit jo vetëm që kontribuon në zvogëlimin e varfërisë individuale dhe familjare, por mund të ndryshojë edhe mënyrën se si merren vendimet në punë dhe në komunitet. Gratë, të cilat më parë ndiheshin të pafavorizuara në status dhe pushtet, po fitojnë një status dhe vetëvlerësim më të lartë brenda shoqërisë nëpërmjet fuqizimit të tyre ekonomik dhe aksesit në vendimmarrje.
3. Duke rritur fuqizimin ekonomik dhe aksesin në burime për gratë. Sektori i turizmit ka potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e veprimtarive sipërmarrëse, veçanërisht sepse shumica e bizneseve në sektorin e turizmit janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM). Për më tepër, mund të vendoset bashkëpunimi ndërmjet turizmit rural të qëndrueshëm dhe sektorit të punimeve artistike dhe artizanale, të cilat mund të kontribuojnë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e ekonomive vendase. Financimi i nisave sipërmarrëse që kanë në fokus gratë artiste dhe artizanet mund të jetë një masë politike që synon promovimin e fuqizimit të grave, duke kontribuar njëkohësisht në ru-

ajtjen e trashëgimisë kulturore. Shumë gra janë eksperte në zeje specifike që janë tipike për rajone të caktuara të një vendi, por kanë mungesë njohurish se si t'i transformojnë këto veprimtari në biznese fitimprurëse. Ofrimi i mbështetjes ndaj tyre për të organizuar bizneset e tyre të vogla do të krijonte një mundësi për të gjeneruar të ardhura dhe do t'i jepte vizibilitet trashëgimisë kulturore të vendit.

Sektori i turizmit përballet me sfida të ndryshme që mund të ndikojnë negativisht mbi prania e grave në këtë sektor. Ashtu si në shumë sektorë, ndasitë në tregun e punës në industrinë e turizmit përbëjnë një sfidë: gratë janë të përqendruara në punë të nënpaguara. Për më tepër, prania e grave në pozicione vendimmarrëse nuk është veçanërisht e lartë. Si përfituese të industrisë së turizmit, gratë kanë më shumë gjasa sesa burrat të raportojnë se nuk planifikojnë të shkojnë me pushime për arsye personale ose financiare ose se, kur shkojnë me pushime, vizitojnë miqtë dhe të afërmit. Për më tepër, disa studime zbulojnë lidhje ndërmjet turizmit dhe industrisë së seksit, e cila mund t'i bëjë gratë më të cenueshme ndaj shfrytëzimit seksual.

Një nga sfidat e konsiderueshme që frenon përpjekjet për promovimin e barazisë gjinore në sektorin e turizmit në Shqipëri është **mungesa e vendimmarrjes së bazuar në të dhëna**. Nëse nuk ka të dhëna të sakta dhe gjithëpërfshirëse për pabarazitë gjinore, përfaqësimin dhe përvojat brenda industrisë, zhvillimi efektiv i politikave dhe ndërhyrjeve të synuara do të jetë sfidues. Mbledhja dhe analizimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë për aspekte të ndryshme të sektorit të turizmit, duke përfshirë punësimin, sipërmarrjen, udhëheqjen dhe sigurinë, është thelbësor për identifikimin e hendeqeve, vendosjen e standardeve dhe monitorimin e progresit drejt objektivave të barazisë gjinore. Krijimi i mekanizmave për mbledhjen dhe analizën

sistematike të të dhënave do t'u mundësojë politikëbërësve, bizneseve dhe grupeve të interesit të marrin vendime të informuara dhe të ndajnë burimet në mënyrë strategjike për të trajtuar pabarazitë gjinore në industrinë e turizmit.

Zhvillimi Urban

Rëndësia e aspekteve gjinore në përshtatjen e sektorit të zhvillimit urban

Aspektet gjinore janë thelbësore për strategjitë e përshtatjes së sektorit të zhvillimit urban për shkak të mënyrave të ndryshme se si burrat dhe gratë i përfshijnë dhe bashkëveprojnë me mjediset urbane. Zonat urbane janë sisteme komplekse ku ndikimet e ndryshimeve klimatike ndërthuren me faktorët socialë, ekonomikë dhe infrastrukturorë, shpeshherë duke i përshkallëzuar pabarazitë gjinore ekzistuese. Gratë, veçanërisht ato nga grupet e marginalizuara, mund të përballen me cenueshmëri të shtuara në mjediset urbane për shkak të faktorëve të tillë si aksesit i kufizuar në burime, nivele më të ulëta të të ardhurave dhe përgjegjësitë parësore të përkujdesit.

Masat e përshtatjes në sektorin e zhvillimit urban duhet të trajtojnë nevojat me specifikë gjinore në fusha si strehimi, transporti, hapësirat publike dhe shërbimet thelbësore. Për shembull, shqetësimet e grave për sigurinë në hapësirat publike dhe sistemet e transportit mund të kufizojnë lëvizshmërinë e tyre dhe aksesin në mundësitë ekonomike. Planifikimi urban me përgjegjshmëri gjinore mund të rrisë sigurinë përmes përmirësimit të ndriçimit, projektimit të hapësirave publike dhe opsioneve të transportit. Për më tepër, rolet e grave në ekonomitë informale dhe në menaxhimin e familjeve i bëjnë ato palë interesi kyç për përpjekjet e qëndrueshmërisë urbane, të tilla si menaxhimi i mbetjeve dhe nismat e përshtatjes të bazuara në komunitet.

Përfshirja e grave në proceset e planifikimit urban dhe të vendimmarrjes garanton integrimin e


pikëpamjeve dhe nevojave të tyre në strategjitë e përshtatjes. Kjo mund të rezultojë në zgjidhje urbane më gjithëpërfshirëse dhe efektive, të tilla si sistemet e përmirësuara të ujësjellës-kanalizimeve që marrin në konsideratë nevojat specifike të grave ose hapësirat e gjelbra që janë të përshtatshme për grupe të ndryshme përdoruesish. Duke integruar aspektet gjinore në përshtatjen e sektorit të zhvillimit urban, qytetet mund të bëhen më të qëndrueshme teksa avancojnë njëkohësisht barazinë gjinore, duke krijuar mjedise urbane më të jetueshme dhe të barabarta për të gjithë banorët përballë sfidave që paraqesin ndryshimet klimatike.

Të dhënat bazë dhe vlerësimet e cenueshmërisë

Në vitin 2023 (me të dhënat e publikuara në vitin 2024), Shqipëria e popullsisë ishte në shifrën 2,412,113, e cila shënoi një ulje prej 15% nga censi i vitit 2011, sipas të dhënave nga INSTAT (Instituti i Statistikave). Gjatë dekadave të kaluara, Shqipëria i është nënshtruar një niveli të konsiderueshëm urbanizimi, ku popullsia urbane është rritur nga një e treta në fillim të viteve 90' në pothuajse dy të tretat (62%) deri në vitin 2020.

Në vitin 2015, rajoni Tiranë-Durrës përbënte 48% të PBB-së kombëtare dhe kishte të ardhurat më të larta për frymë - 1,32 herë më të larta se mesatarja kombëtare. Ky urbanizim i shpejtë ka paraqitur sfida të shumta, duke përfshirë papunësinë dhe varfërinë në zonat rurale, mbipopullimin dhe zgjerimin e qendrave urbane, cenimin e zonave natyrore dhe kulturore, si dhe infrastrukturën e pamjaftueshme për transportin, ujin, kanalizimet dhe energjinë.

Pavarësisht tendencës në rritje drejt urbanizimit, infrastruktura dhe shërbimet publike në qytete dhe qyteza mbeten të pamjaftueshme dhe të shpërndara në mënyrë të pabarabartë. Planifikimi urban nuk ka arritur t'i trajtojë në mënyrë të përshtatshme shqetësimet e lidhura me ndryshimet klimatike, duke rezultuar në probleme të tilla si përmbytjet urbane, ndotja e ujit dhe e

Figura 6. Popullsia e Shqipërisë sipas vitit të censit (në milionë)

Burimi: INSTAT (Censi 2024, f. 16)

ajrit, si dhe presioni mbi habitatet bregdetare për shkak të migrimit nga zonat rurale.

Përqendrimi i ndërtesave në zona të caktuara pasqyron mungesën e një vizioni afatgjatë për zhvillimin urban, veçanërisht me mbizotërimin e ndërtimit të banesave krahasuar me projektet e tjera kritike infrastrukturore. Për më tepër, planifikimi i dobët urban dhe zhvillimi i dobët infrastrukturor kanë përkeqësuar cënueshmërinë e zonave urbane ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, duke përfshirë përmbytjet dhe ndotjen e ajrit. Duke marrë në konsideratë rreth 63,5% të popullsisë që jeton në qytete, vetëm rajoni Tiranë-Durrës përfshin 37% të popullsisë së vendit, duke treguar një përqendrim të konsiderueshëm të individëve në zonat urbane. Megjithatë, kapaciteti i ministrive dhe bashkive për të kryer planifikim strategjik afatgjatë është i kufizuar, duke kompromentuar më tej përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Qytetet bregdetare, të cilat janë shpesh qendrat urbane më të mëdha, janë veçanërisht të

rrezikuara nga rritja e nivelit të detit, stuhitë dhe përmbytjet. Me rritjen e temperaturave, efektet e rritjes së temperaturave në zonat urbane bëhen më të theksuara, duke paraqitur rreziqe shëndetësore dhe konsum të shtuar të energjisë për ftohje. Reshjet e çrregullta dhe rritjet e temperaturave cenojnë gjithashtu burimet ujore, duke rezultuar në përmbytje të shpejta, rrëshqitje të tokës dhe përmbytje të zonave urbane, të cilat prekin në mënyrë joproporcionale vendbanimet urbane dhe rezultojnë në humbje të jetës dhe infrastrukturës.

Integrimi i aspekteve gjinore në politikat për klimën

Ndërsa studimet gjithëpërfshirëse mbi gratë në zhvillimin urban në Shqipëri janë të kufizuara, të dhënat e INSTAT tregojnë pabarazi të konsiderueshme gjinore në këtë sektor. Sektori i ndërtimit, ku janë të punësuar 98 179 punonjës, paraqet një nga hendeqet më të theksuara gjinore në ekonominë e Shqipërisë. Përkatësisht, burrat

përbëjnë 96,3% (94 593 punonjës), ndërsa gratë përbëjnë vetëm 3,7% (3586 punonjës). Ky dallim i thellë theksohet më tej nga shkallët e pjesëmarrjes në sektor, ku 13,5% e burrave të punësuar punojnë në ndërtim, krahasuar me vetëm 0,6% të grave të punësuar. Këto modele punësimi përshkallëzojnë sfidat ekzistuese me të cilat përballen gratë në mjediset urbane, ku ato shpesh janë të mbipërfaqësuar në ekonomitë informale urbane dhe të nënpërfaqësuar në proceset formale të planifikimit urban dhe vendimmarrjes.

Hendeqet gjinore dhe sfidat

Përfaqësimi i kufizuar i grave në role formale të zhvillimit urban (3,7%) ka implikime të rëndësishme në mënyrën se si planifikohen dhe ndërtohen qytetet, veçanërisht në kontekstin e ndryshimeve klimatike. Qendrat urbane të Shqipërisë po përballen me përkeqësim të cilësisë së ajrit, kryesisht për shkak të automjeteve të vjetra me naftë dhe emetimeve industriale, veçanërisht nga bujqësia. Problemet kryesore përfshijnë ndotjen nga plehu azotik si në ujë ashtu edhe në ajër, si dhe teknikat e prerjes dhe djegies së bimësisë, e cila çliron grimca të imëta pluhuri dhe hiri në atmosferë³². Për më tepër, aksesit në ujë rubineti të pastër është shpesh i pasigurt në të gjithë vendin, veçanërisht në zonat rurale. **Meqenëse gratë janë tejet të nënpërfaqësuar në pozicionet e lidhura me ndërtimin dhe planifikimin urban, perspektivat dhe nevojat e tyre kanë më pak gjasa të përfshihen në zhvillimin e infrastrukturës së qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike.** Kjo paraqet sfida të konsiderueshme, veçanërisht për vajzat që mund të mungojnë në shkollë për shkak të ciklit menstrual. Rreth 63% e grave shqiptare që

jetojnë në zona periurbane raportojnë kushte të këqija sanitare³³.

Përhapja e sëmundjeve të lidhura me ndryshimet klimatike dhe higjienën e papërshtatshme prek gratë në mënyrë joproporcionale, të cilat shpesh janë kujdestaret kryesore dhe më të cenueshme ndaj infeksioneve gjatë menstruacioneve dhe shtatzënisë. Për më tepër, rreziku në rritje i pandemie³⁴ për shkak të ndryshimeve klimatike vendos një barrë kujdesi më të madhe ndaj grave, të cilat tradicionalisht ndërmarrin pothuajse 75% të përgjegjësisë të papaguara të kujdesit shtëpiak dhe familjar. Kjo përqindje u rrit në 79% gjatë muajve të fillimit të pandemisë së COVID-19.³⁵ Kjo barrë kujdesi është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh përfaqësimin e kufizuar të grave në rolet formale të zhvillimit urban që mund të ndihmojnë në formësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve më me përgjegjshmëri gjinore.

Nënpërfaqësimi i thellë i grave në sektorin e ndërtimit (3,7%) jo vetëm që kufizon pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë në zhvillimin e infrastrukturës së qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike, por edhe aftësinë e tyre për të ndikuar në politikat dhe praktikatat e zhvillimit urban. Trajtimi i këtij hendequ gjinor është i nevojshëm si pjesë e angazhimit të gjerë të Shqipërisë për qytete të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, siç përshkruhet në Strategjinë e saj Kombëtare për Integrim Evropian dhe Zhvillim të Qëndrueshëm 2022-2030. Promovimi i zhvillimit urban me përgjegjshmëri gjinore kërkon rritjen e përfaqësimit të grave në rolet formale të ndërtimit dhe planifikimit, duke garantuar njëkohësisht që hapësirat urbane të jenë të projektuara për të trajtuar nevojat me specifike gjinore dhe cenueshmëritë klimatike.

32. (ESMF_CRAD-19-12-2022 fq. 81); <https://www.bujqesia.gov.al/kerkese-perpjesemarrje-ne-konsultimin-publik-ne-kuader-te-projektit-qendrushmeria-ndajklimes-dhe-zhvillimit-te-bujqesise-crad/>

33. (report Albania, wecf, fq. 2) <https://www.women2030.org/wpcontent/uploads/2018/10/Albania-Final.pdf>

34. (C.J. Carlson, G.F. Albery, C. Mero., C.H. Trisos., C.M. Zipfel, E.A. Eskew, & S. Bansal, Climate change increases cross-species viral transmission risk (Ndryshimet klimatike rrisin rrezikun e transmetimit të virusit midis specieveve), Nature, 1-1, 2022, <https://doi.org/10.1038/s41586-022-04788-w>)

35. (K. Power, The COVID-19 pandemic has increased the care burden of women and families, Sustainability: Science, Practice and Policy (Pandemia e COVID-19 ka rritur barrën e kujdesit ndaj grave dhe familjeve. Qëndrueshmëria: Shkenca, Praktika dhe Politika), 16(1), fq. 67-73, 2020, <https://doi.org/10.1080/15487733.2020.1776561>)

Energjia

Rëndësia e aspekteve gjimore në përshtatjen e sektorit të energjisë

Integrimi i aspekteve gjimore në strategjitë e përshtatjes së sektorit të energjisë është thelbësor për të garantuar qëndrueshmëri të barabartë dhe efektive ndaj ndryshimeve klimatike. Aksesimi në energji dhe përdorimi i saj shpesh ndryshojnë ndjeshëm midis gjinive për shkak të faktorëve socio-ekonomikë, roleve tradicionale dhe normave kulturore. Gratë, veçanërisht në zonat rurale ose me të ardhura të ulëta, mund të përballen me varfëri më të madhe energjetike dhe të mbështeten më shumë në lëndët djegëse tradicionale të biomasës për gatim dhe ngrohje, duke i ekspozuar ato ndaj rreziqeve shëndetësore dhe gjetjes më të ngadaltë të lëndëve djegëse. Ndërsa ndryshimet klimatike ndikojnë mbi sistemet e energjisë, është thelbësore të identifikohen cenueshmëritë dhe nevojat me specifike gjimore. Masat e përshtatjes në sektorin e energjisë duhet të trajtojnë pabarazitë në aksesin në energji, të promovojnë teknologji të pastra dhe efçente në dobi të shëndetit dhe produktivitetit të grave dhe të garantojnë pjesëmarrjen e grave në proceset e vendimmarrjes. Duke përfshirë perspektivat gjimore, strategjitë e përshtatjes së sektorit të energjisë jo vetëm që mund të përmirësojnë qëndrueshmërinë ndaj klimës, por edhe të kontribuojnë në barazinë gjimore, përmirësimin e jetesës dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo qasje garanton që përshtatja e sektorit të energjisë të sjellë përfitime për të gjithë shoqërinë dhe nuk përkeqëson në mënyrë të paqëllimtë pabarazitë gjimore ekzistuese.

Të dhënat bazë dhe vlerësimet e cenueshmërisë

Strategjia Kombëtare e Energjisë paraqet mundësi të konsiderueshme për të integruar në mënyrë më efektive përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në politikat për energjinë, duke marrë parasysh ndjeshmërinë e sektorit ndaj ndikimeve klimatike,

krahas rolit të tij thelbësor në përpjekjet për zbutjen. Sektori i energjisë është një gur themeli i PBB-së kombëtare, duke theksuar rëndësinë e tij strategjike. Shqipëria ka vendosur një objektiv ambicioz prej 38% për energjinë nga burimet e rinovueshme në konsumin final bruto të energjisë deri në vitin 2020, të mbështetur nga një kuadër i ri rregullator i përvijuar në ligjin nr. 7/2017, në harmonizim me marrëveshjet ndërkombëtare të tilla si Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe Direktiva nr. 2009/28/KE “Për burimet e rinovueshme të energjisë”. Ky legjislacion prezanton skema nxitëse për të rritur përdorimin e energjisë që rrjedh nga burimet e rinovueshme, duke treguar angazhimin e qeverisë për të arritur objektivat e energjisë së rinovueshme.

Varësia e lartë e Shqipërisë ndaj energjisë hidrike për prodhimin e energjisë elektrike, e cila përbën 98% të prodhimit të saj, nënvizon rolin e saj në dekarbonizimin e ekonomisë. Megjithatë, kjo varësi e bën vendin tejet të cenueshëm ndaj kushteve hidrologjike të ndryshueshme dhe ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Pavarësisht kapacitetit të konsiderueshëm të energjisë hidrike, Shqipëria shpesh përballet me deficite të energjisë elektrike, duke rezultuar në importe vjetore të konsiderueshme. Ndërprerjet e vazhdueshme të energjisë paraqesin sfida ndaj rritjes ekonomike, veçanërisht në sektorë në lulëzim siç është turizmi. Topografia e Shqipërisë përfshin lumenj me kaskada të konsiderueshme, duke ofruar një potencial të rëndësishëm të energjisë hidrike. Megjithatë, kjo varësi nga energjia hidrike paraqet sfida mjedisore dhe sociale, duke përfshirë dëmtimin ekologjik të lumenjve, siç theksohet nga OJQ-të vendase dhe ndërkombëtare. Ndërtimi i hidrocentraleve të vogla ka nxitur kundërshtime publike për shkak të shqetësimeve në lidhje me degradimin mjedisor dhe vlerësimet e pamjaftueshme të ndikimit në mjedis.

Ndonëse mbizotërimi i energjisë hidrike në Shqipëri qenë dobiprurës në dekarbonizimin e sektorit të

energjisë elektrike, gjithashtu e ekspozon vendin ndaj rreziqeve klimatike. Luhatjet në prodhimin e energjisë hidrike, të përshkallëzuara nga luhatjet klimatike, sjellin nevojën për importe të energjisë elektrike pavarësisht zgjerimeve të vazhdueshme të centraleve. Rritja e temperaturave parashikohet të ndryshojë kërkesat sezonale për energji dhe të zvogëlojë potencialin e energjisë hidrike, ndërsa shpeshimi i thatësirave do të intensifikojë konkurrencën për burimet ujore, veçanërisht për bujqësinë dhe ujitjen. Ndryshimet e parashikuara në reshje dhe temperaturë mund të ndryshojnë bilancin hidrik, modelet e rrjedhjes së ujit dhe kohën e disponueshmërisë së ujit, duke ndikuar rrjedhimisht në ekosistemet dhe komunitetet e rrjedhës së poshtme. Midis të gjithë sektorëve, industrinë e burimeve ujore dhe të energjisë hidrike dallohen për shkak të ndjeshmërisë së tyre të shtuar ndaj ndryshimeve klimatike dhe ndikimit të thellë mbi to. Kjo cenueshmëri është veçanërisht më e dukshme për centralet në lumenj të rrjedhshëm, të cilët janë sensitivë ndaj luhatjeve të reshjeve dhe shkarkimeve, ndërsa impiantet e depozitimit përballen me rritje të rreziqeve të erozionit dhe sedimentimit. Për më tepër, infrastruktura e energjisë hidrike mbetet e cenueshme ndaj rreziqeve të ndryshme si përmbytjet e shpejta, rrëshqitjet e tokës, sedimentimi dhe aktiviteti sizmik.

Përveç kësaj, linjat e transmetimit janë në rrezik nga rreziqe të tilla si rrëshqitjet e tokës dhe erozioni i brigjeve të lumenjve, të cilat mund të cenojnë stabilitetin e tyre dhe të pengojnë përpjekjet e mirëmbajtjes. Ndryshimet e shkaktuara nga faktorët klimatikë në disponueshmërinë e ujit dhe modelet e shkarkimit paraqesin kërcënime të konsiderueshme për prodhimin e energjisë hidrike; parashikimet tregojnë një ulje të mundshme të prodhimit prej 15% për centralet

e mëdha dhe 20% për centralet e vogla deri në fund të shekullit, sipas një skenari të rritjes së temperaturës prej 4°C. Këto sfida përkeqësohen nga vjetrimi i pjesës më të madhe të infrastrukturës së energjisë hidrike të vendit, e cila kërkon masa mirëmbajtjeje dhe përshtatjeje për të trajtuar rritjet e parashikuara të ndryshueshmërisë sezonale të ujit.

Për të neutralizuar efektet negative të ndryshimeve klimatike në prodhimin e energjisë elektrike, ekziston një nevojë kritike për të diversifikuar burimet e energjisë dhe për të shfrytëzuar rezervat e energjisë së rinovueshme johidrike brenda rajonit. Shqipëria, një vend i pasur me burime të bollshme natyrore, është e mirëpozicionuar për të zgjeruar portofolin e energjisë së rinovueshme përtej energjisë hidrike. Përveç potencialit të saj hidroenergjetik, Shqipëria po përparon strategjikisht me lidhjen e planifikuar të gazit në termocentralin e Vlorës me Gazsjellësin Trans-Adriatik (TAP), duke lehtësuar furnizimet e ardhshme me gaz natyror përmes infrastrukturës së qëndrueshme si një burim gjatë tranzicionit energjetik.

Integrimi i aspekteve gjinore në politikat për klimën

Në mars të vitit 2021, ndryshimet në ligjin e Shqipërisë “Për eficientësin e energjisë” prezantuan objektiva të detyrueshëm për sektorin publik dhe privat, duke përfshirë zhvillimin e planeve lokale të veprimit për eficientësin e energjisë nga bashkitë³⁶. Financimi i BE-së përmes një programi të GIZ pritet të ndihmojë bashkitë që të zhvillojnë plane të qëndrueshme për energjinë dhe klimën. Ndryshimi i vitit 2018 në ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike”³⁷ paraqiti gjithashtu konceptin “klientë në nevojë”, duke

36. Spasić, V. (2021). Albania introduces obligations for public, private sector to increase energy efficiency (Shqipëria vendos detyrime për sektorin publik dhe privat për të rritur eficientësin e energjisë). I disponueshëm në: <https://balkangreenenergynews.com/albania-introduces-obligations-for-public-private-sector-to-increase-energy-efficiency/>

37. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2015). Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”. I disponueshëm në: https://ere.gov.al/doc/Law_no.43-2015_On_Power_Sector.pdf

ofruar kompensim për energjinë elektrike për familjet që përballen me vështirësi ekonomike. Megjithatë, më pak se 37% e familjeve në nevojë përfitojnë nga ky subvencion, ndërsa organizatat e shoqërisë civile kërkojnë rishikime rregullatore për të rritur aksesueshmërinë³⁸.

Ligji i vitit 2020 “Për ndryshimet klimatike” rezultoi në zhvillimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK), duke prezantuar konceptin e “varfërisë energjetike” si një masë të re të politikave³⁹. PKEK-ja synon të përcaktojë dhe të monitorojë në mënyrë sistematike varfërinë energjetike, por asnjë buxhet shtetëror nuk është alokuar në mbështetje të kësaj nisme. Pavarësisht një platforme të konsultimit publik, asnjë aspekt gjinor apo reagim nuk është integruar në plan. Aktivistët sugjerojnë veprime të mëtejshme për të garantuar pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse dhe perspektivat e larmishme në politikat e ardhshme. Sektori i energjisë në Shqipëri demonstroi një pabarazi gjinore të konsiderueshme që formëson profilin e cenueshmërisë së tij ndaj ndryshimeve klimatike. Të dhënat e fundit të INSTAT tregojnë se në sektorin “Miniera dhe gurore, furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë”, ku janë të punësuar 35 508 punonjës, ekziston një pabarazi e thellë gjinore pasi burrat përbëjnë 84,9% të totalit (30 129 punonjës), ndërsa gratë vetëm 15,1% (5379 punonjës). Kjo pabarazi theksohet edhe më tej nga nivelet e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore në këtë sektor. Më konkretisht, 4,3% e burrave të punësuar punojnë në këtë sektor, ndërsa në rastin e grave kjo shifër është vetëm 0,9%. Këto dallime pasqyrojnë sfidat më të gjera strukturore në sektorin e energjisë, ku gratë përballen me akses të kufizuar në rolet teknike, pozicionet drejtuese dhe proceset e vendimmarrjes që ndikojnë në strategjitë për qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike. Përfaqësimi i ulët i grave është veçanërisht shqetësues duke pasur

parasysh rolin kritik të këtij sektori në përpjekjet për përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, duke përfshirë në tranzicionin drejt energjisë së rinovueshme dhe zhvillimin e infrastrukturës së qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo pabarazi gjinore sugjeron që perspektivat dhe nevojat e grave mund të jenë të nënpërfaqësuar në politikat dhe planifikimin në sektorin e energjisë, çka mund të rezultojë në mangësi në trajtimin e cenueshmërive klimatike me specifike gjinore dhe të sfidave lidhur me aksesin në energji. Të dhënat nënvizojnë nevojën urgjente për ndërhyrje të synuara për të rritur pjesëmarrjen e grave në sektorin e energjisë, duke u siguruar njëkohësisht që strategjitë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në fushën e zhvillimit energjetik të marrin në konsideratë ndikimet dhe nevojat me specifike gjinore.

Për më tepër, ndikimet gjinore në varfërinë energjetike mbeten të nëntrajtuara. Enti Rregullator i Energjisë (ERE) rregullon furnizimin me energji, por mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë kufizon kuptueshmërinë e qartë të ndikimit mbi demografi të ndryshme. Një studim i vitit 2021 i kryer nga UNDP nënvizoi se të ardhurat e ulëta, arsimit dhe aftësitë e kufizuara janë barrierat kryesore të aksesit në energji, duke prekur në mënyrë joproporcionale popullsitë e cenueshme, veçanërisht gratë. Megjithëse ky studim ofron një panoramë gjithëpërfshirëse, atij i mungon interpretimi i mjaftueshëm i të dhënave të ndara sipas gjinisë, duke lënë hendeqe në mënyrën e të kuptuarit të varfërisë energjetike nga një perspektivë gjinore.

Hendeqet gjinore dhe sfidat

Pavarësisht përpjekjeve për të trajtuar varfërinë energjetike në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, mungojnë masat konkrete për

38. Udhëzimi i Përbashkët nr. 15 ndërmjet MSPJ-së, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, datë 08.04.2015.

39. Komuniteti i Energjisë (n.d.) I disponueshëm në: <https://www.energy-community.org/regionalinitiatives/NECP.html>

ta trajtuar atë. Mungesa e fokusit të aspektet gjinore në kuadër të politikave për energjinë mund të rrjedhë nga kuptueshmëria e kufizuar e marrëdhënies ndërmjet barazisë gjinore dhe varfërisë energjetike.

Për trajtimin e këtyre hendeqeve, përpjekjet e përmirësuar për mbledhjen e të dhënave, në veçanti të të dhënave të ndara sipas seksit dhe gjinisë, janë të nevojshme. Censi i vitit 2023 paraqet një mundësi për të mbledhur këndvështrime me vlerë në lidhje me aksesin dhe përdorimin e energjisë në familje sipas gjinisë. Për më tepër, përshtatja e anketave për të mbledhur informacione me specifike gjinore lidhur me përdorimin e energjisë dhe aktiviteteve të lidhura me to është thelbësor.

Gjithashtu, përpjekjet për integrimin e aspekteve gjinore duhet të përfshihen në të gjitha fazat e politikave dhe të planifikimit të veprimeve brenda sektorit të energjisë, duke përfshirë projektimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin. Analiza me bazë gjinore duhet të inkurajohet për të vlerësuar ndikimet e ndryshme të nismave qeveritare mbi gratë dhe burrat.

Ndërkohë që reformat për energjinë janë në përputhje me standardet e BE-së, praktikat e monitorimit dhe vlerësimit me ndjeshmëri gjinore janë thelbësore për të matur në mënyrë efektive ndikimet me specifike gjinore. Është e domosdoshme që politikat dhe ndryshimet ligjore të ardhshme të shqyrtohen nga një perspektivë gjinore, duke përfshirë edhe nevojën për të modernizuar politikat dhe planet me specifike gjinore për të trajtuar sfidat e reja në sektorët jotradicionalë, siç janë energjia dhe ndryshimet klimatike.

Perceptimi publik për përfaqësim të shtuar të grave në pozicione vendimmarrëse duhet të përdoret për të nxitur përmirësime në politikat dhe legjislacionin kombëtar. Megjithatë, kjo

kërkon përpjekje të vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve, përgatitje teknike dhe konsultime me palët e interesit.

Angazhimet financiare janë kritike për të trajtuar ndikimet negative të varfërisë energjetike, dhe buxheti i përgjegjshëm gjinor luan një rol kyç për të garantuar që planet e veprimit për energjinë i japin përparësi nevojave dhe prioritetëve të ndryshme të përdoruesve të energjisë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të kërkojë rritje të përgjegjshmërisë për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, me lidhje të qarta ndërmjet alokimeve të buxhetit dhe prioritetëve kombëtare.

Trajtimi i këtyre sfidave dhe hendeqeve kërkon përpjekje të përbashkëta, angazhim efektiv të palëve të interesit dhe angazhim të vazhdueshëm për integrimin e aspekteve gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave për energjinë.

Transporti

Rëndësia e aspekteve gjinore në përshtatjen e sektorit të transportit

Integrimi i aspekteve gjinore në masat e përshtatjes në sektorin e transportit është thelbësor si pasojë e urbanizimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit të infrastrukturës në vend. Rolet tradicionale gjinore, dallimet ndërmjet zonave urbane dhe rurale, si dhe pabarazitë ekonomike ndikojnë në nevojat dhe modelet e transportit të grave. Shpeshherë, gratë përballen me mundësi të kufizuara transporti në zonat rurale, çka ndikon në aksesin e tyre në arsim, kujdes shëndetësor dhe mundësi ekonomike. Shqetësimet e lidhura me sigurinë, veçanërisht në transportin publik urban, janë të konsiderueshme për gratë në Shqipëri. Ndërkohë që vendi investon në infrastrukturë të re dhe punon drejt integritit në BE, është thelbësore përfshirja e qasjeve me ndjeshmëri gjinore në planifikimin e transportit. Kjo përfshin përmirësimin e aksesit në

zonat rurale, trajtimin e problematikave të sigurisë, garantimin e përballueshmërisë së kostove, si dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset e vendimmarrjes. Duke u fokusuar në këto aspekte, Shqipëria mund të krijojë një sistem transporti më të barabartë, efikas dhe gjithëpërfshirës që mbështet progresin social dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

Të dhënat bazë dhe vlerësimet e cenueshmërisë

Shqipëria ka trashëguar një sistem transporti të dobët nga epoka komuniste, por investimet e kohëve të fundit kanë përmirësuar ndjeshëm rrjetin rrugor kombëtar, duke rritur aktivitetin e transportit dhe konsumin e lëndëve djegëse.

Sfidat për arritjen e transportit të qëndrueshëm mbeten të pranishme. Fluksi i automjeteve të përdorura, përafërsisht 60% e regjistrimeve të reja, përkeqëson ndikimet në mjedis. Ndërkohë që transporti detar dhe ajror tregojnë potencial rritjeje, me zgjerime të planifikuara të porteve dhe aeroporteve kryesore, sistemi hekurudhor mbetet i nënzhvilluar dhe mbështetet në infrastrukturë të vjetruar. Për më tepër, sektori i transportit në Shqipëri është i cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike, me rreziqe të tilla si rritja e nivelit të detit, përmytjet dhe ngjarjet ekstreme të motit që paraqesin kërcënime për besueshmërinë dhe sigurinë e infrastrukturës. Zhvillimi i sistemeve të transportit që janë të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike është thelbësor për zbutjen e këtyre rreziqeve.

Përpjekjet për modernizimin e sektorit përfshijnë zgjerimin e linjave hekurudhore, modernizimin e porteve dhe ndërtimin e aeroporteve shtesë për të lehtësuar turizmin dhe transportin e mallrave. Megjithatë, Shqipëria përballlet me sfida të konsiderueshme në lidhje me ekuilibrimin e zhvillimit me qëndrueshmërinë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Transporti publik është një funksion ekskluziv

dhe organizohet në nivel vendor ose nëpërmjet bashkëpunimit ndërbashkiak midis njësive të qeverisjes vendore, në përputhje me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Sipas një studimi gjithëpërfshirës të lëvizshmërisë, të realizuar në Tiranë nga GIZ në vitin 2023, **ekzistojnë pabarazi gjinore të konsiderueshme në aksesin e transportit** dhe në modelet e përdorimit. Transporti publik, veçanërisht autobusët, luan një rol thelbësor në lëvizshmërinë e grave, të cilat përbëjnë më shumë se 60% të udhëtarëve në autobusë. Ky përdorim i lartë nxitet kryesisht për shkak të studenteve femra dhe grave në moshë pune, duke treguar rëndësinë e sistemit të autobusëve për arsimin dhe pjesëmarrjen ekonomike. Megjithatë, **gratë raportojnë kënaqësi të ulët me shërbimet e autobusëve krahasuar me burrat**, duke raportuar shqetësime në lidhje me sigurinë, besueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit në përgjithësi.

Studimi zbulon se 46% e udhëtimeve me autobus të grave janë për qëllime pune, ndërsa 24% janë për qëllime arsimore, duke nënvizuar **rolin kritik të transportit publik në mbështetjen e aktiviteteve ekonomike dhe arsimore të grave**. Pavarësisht se kanë akses në makina, 26% e përdorueseve gra të autobusëve zgjedhin transportin publik, duke treguar një preferencë për opsionet e lëvizshmërisë së qëndrueshme kur ato janë të disponueshme dhe të besueshme.

Nga ana tjetër, përdorimi i automjeteve private tregon një dallim gjinor të qartë. **Drejtuesit tipikë të makinave në Tiranë janë burrat në moshë të mesme dhe të punësuar**, ndërsa gratë, veçanërisht ato nën 30 vjeç ose mbi 45 vjeç, studentet dhe ato me të ardhura më të ulëta, kanë më pak gjasa të ngasin makinën. Kjo pabarazi thekson nevojën për **politika gjithëpërfshirëse transporti** që trajtojnë nevojat për lëvizshmëri të grupeve të ndryshme demografike.

Ky studim vë në pah hendeqet e konsiderueshme në transportin aktiv. **Vetëm 20% e përdoruesve të biçikletave në Tiranë janë gra**, dhe më shumë se gjysma e tyre raportojnë shqetësimet lidhur me sigurinë si barriera kryesore ndaj lëvizjes me biçikletë. Lëvizja në këmbë është më e shpeshtë mes grave, ku 79% e tyre shprehen se lëvizin shpesh në këmbë, por përvoja e tyre shpesh cenohet nga infrastruktura e dobët dhe çështjet e sigurisë.

Këto gjetje nga studimi i GIZ theksojnë nevojën për **politika transporti me përgjegjshmëri gjinore në të gjithë Shqipërinë**, duke u fokusuar në përmirësimin e cilësisë së transportit publik, përmirësimin e infrastrukturës çiklistike dhe në krijimin e mjediseve më të sigurta dhe më të aksesueshme të lëvizjes në këmbë. Cenueshmëria ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin e transportit në Shqipëri përshkallëzohet nga pabarazitë gjinore, ku gratë përballen me sfida joproporcionale për shkak të varësisë së tyre më të madhe nga mënyrat publike dhe aktive të transportit, të cilat janë më të ndjeshme ndaj problemeve që lidhen me ndryshimet klimatike, të tilla si përmytjet, i nxehti ekstrem dhe ngjarjet ekstreme të motit. Kjo cenueshmëri është veçanërisht e dukshme në zonat urbane si Tirana, ku gratë përbëjnë shumicën e përdoruesve të transportit publik dhe këmbësorëve, por raportojnë kënaqësi më të ulët lidhur me shërbimet dhe infrastrukturën, duke theksuar nevojën për strategji të përshtatjes me përgjegjshmëri gjinore ndaj ndryshimeve klimatike në planifikimin dhe zhvillimin e transportit.

Sipas të dhënave të INSTAT, transporti është pjesë e kategorisë më të gjerë “Tregti, Transport, Hoteleri, Shërbime të biznesit dhe administrative”, ku janë të punësuar 27,0% e totalit të fuqisë punëtore (350 563 punonjës nga 1 298 380 të punësuar në total). Edhe pse statistikave të INSTAT nuk përmbajnë të dhëna mbi punësimin specifikisht për sektorin e transportit, veçanërisht

në veprimtarinë e transportit konstatohet një ndër nivelet më të larta të pabarazisë gjinore. Më konkretisht, burrat përbëjnë 91,9% të punonjësve në sektorin e transportit, ndërsa gratë vetëm 8,1%. Nga totali i fuqisë punëtore meshkuj prej 700 686 individë, nga të cilët 30,9% punojnë në sektorin më të gjerë, si dhe nga totali i fuqisë punëtore femra prej 597 694 individë, nga të cilat 22,5% punojnë në sektorin më të gjerë, transporti në veçanti shfaq pabarazi të thellë gjinore. Kjo pabarazi e thellë gjinore është tejet shqetësuese duke pasur parasysh rolin kritik të sektorit të transportit në qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe cenueshmërinë e tij ndaj ndikimeve klimatike. Struktura e punësimit, e cila dominohet nga meshkujt, paraqet sfida specifike, pasi punonjësit në sektorin e transportit duhet të përshtaten me rritjen e shpeshtësisë së ngjarjeve ekstreme të motit që ndikojnë tek infrastruktura, qëndrueshmëria e shërbimeve dhe kushtet e punës. Edhe pse përqindja e ulët e grave në sektor mund të sugjerojë se ekspozimi i tyre i drejtpërdrejtë ndaj rreziqeve klimatike operacionale është i kufizuar, gratë që punojnë në sektorin e transportit përballen shpeshherë me sfida të ndërlikuara, ku përfshihen akseset e kufizuara në trajnime teknike, niveli i ulët i përfaqësimit në pozicionet vendimmarrëse që ndikojnë në masat për planifikimin e transportit të qëndrueshëm ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe pengesat për të pasur role drejtuese. Cenueshmëria e këtij sektori ndaj ndryshimeve klimatike është e konsiderueshme, veçanërisht duke pasur parasysh funksionin e tij thelbësor në ruajtjen e lëvizshmërisë dhe lidhjeve ekonomike gjatë ngjarjeve ekstreme të motit, çka nënvizon nevojën për qasje me përgjegjshmëri gjinore që mbrojnë fuqinë punëtore aktuale dhe nxisin një pjesëmarrje më gjithëpërfshirëse në zhvillimin e sistemeve të transportit të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike. Këto të dhëna nënvizojnë nevojën urgjente për ndërhyrje që trajtojnë pabarazitë e konsiderueshme gjinore dhe cenueshmëritë e këtij sektori ndaj ndryshimeve

klimatike, duke punuar njëkohësisht drejt një përfaqësimi më të barabartë në planifikimin dhe veprimtaritë e transportit.

Hendeqet gjinore dhe sfidat

Hendeqet dhe sfidat gjinore në sektorin e transportit në Shqipëri janë potencialisht të konsiderueshme, por shkalla e tyre e plotë mbetet e paqartë për shkak të mungesës kritike të të dhënave me specifike gjinore. Strategjia ekzistuese Sektoriale e Transportit dhe Plani i Veprimit 2016-2020, ka mungesë të dukshme të aspekteve gjinore, duke nxjerrë në pah një boshllëk të konsiderueshëm në planifikimin e politikave. Për më tepër, ndërsa Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) përmend integrimin e aspekteve gjinore në sektorin e transportit në kuadër të planit të tij të veprimit, nuk ofron një analizë gjithëpërfshirëse për të kuptuar nevojat specifike dhe dimensionet gjinore brenda këtij sektori. Kjo mungesë e mbledhjes dhe analizës së të dhënave të fokusuar në dimensionin gjinor pengon seriozisht aftësinë për të vlerësuar dhe trajtuar me saktësi sfidat unike me të cilat përballen gratë si në kontekstin e transportit urban ashtu edhe në atë rural.

Mungesa e të dhënave ka ndikim në aspekte të ndryshme, duke filluar nga të kuptuarit e modeleve të lëvizshmërisë së grave dhe shqetësimeve të lidhura me sigurinë, e deri tek identifikimi i pengesave në aksesimin e mundësive ekonomike dhe shërbimeve thelbësore. Për të trajtuar këtë mangësi kritike, Shqipëria duhet të

prioritizojë mbledhjen sistematike të të dhënave të ndara sipas gjinisë në sektorin e transportit. Ky proces duhet të përfshijë informacionin për modelet e udhëtimit, perceptimet mbi sigurinë, problematikat lidhur me aksesueshmërinë dhe nivelin e përfaqësimit të grave në profesionet dhe rolet vendimmarrëse të lidhura me transportin. Mbledhja e këtyre të dhënave është thelbësore për të realizuar vlerësime kuptimplota të ndikimit gjinor, për të informuar vendimet e politikave dhe për të projektuar sisteme transporti me përgjegjshmëri gjinore.

Duke nisur përpjekjet gjithëpërfshirëse për mbledhjen e të dhënave, Shqipëria mund të hedhë themelet për një politikëbërje të bazuar në evidenca që trajton në mënyrë efektive pabarazitë gjinore në sektorin e transportit, duke kontribuar kështu në një sistem transporti më të barabartë dhe më gjithëpërfshirës, në përputhje me objektivat e zhvillimit të vendit dhe përpjekjet për integrimin në BE.

Shtojca III: Objektivat gjithëpërfshirës në integrimin e aspekteve gjinore në PKP

Si mund të rritet përgjegjshmëria gjinore e proceseve të PKP-së?

Natyra ciklike e procesit të PKP-së ofron mundësi të shumta për integrimin e aspekteve gjinore. Hapi i parë dhe më i rëndësishëm është që ekipet e PKP-së të angazhohen për të vepruar me përgjegjshmëri gjinore (për shembull, duke e përfshirë këtë aspekt si një çështje kyç në procesin e inventarizimit dhe të udhërrëfyesit për PKP-në).

Përmes këtij angazhimi, mund të merren veprime për të integruar analizën gjinore dhe veprimet me përgjegjshmëri gjinore në të gjitha dimensionet e procesit të PKP-së. Tabela në vijim paraqet çështjet themelore për t'u marrë në konsideratë nga ekipet e PKP-së gjatë zhvillimit të proceseve të PKP-së. Hapat përkatës në udhëzimet teknike të PKP-së, të hartuara nga Grupi i Ekspertëve i Vendeve më Pak të Zhvilluara (LEG), janë paraqitur në kllapa, sipas rastit (KKKBANK, 2012b).⁴⁰

Tabela 4. Proceset me përgjegjshmëri gjinore të PKP-së: Çështjet themelore për t'u marrë në konsideratë nga ekipet e PKP-së

Çështjet themelore për t'u marrë në konsideratë për qasjet me përgjegjshmëri gjinore			
	Planifikimi	Zbatimi	M-V
Procesi i PKP-së	<p>Përdorimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë, vlerësimeve me ndjeshmëri gjinore të cënueshmërive klimatike dhe kontributeve nga ekspertët e çështjeve gjinore për të mbështetur planifikimin e përshtatjes (A4, B2)</p> <p>Analizimi i politikave kombëtare për të identifikuar mangësitë dhe mundësitë në lidhje me integrimin e aspekteve gjinore (A2)</p> <p>Përdorimi i praktikave të mira ekzistuese lidhur me aspektet gjinore dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në proceset e planifikimit (B3)</p> <p>Njohja e grave si një grup interesi i veçantë në procesin e PKP-së (B4)</p> <p>Garantimi i pjesëmarrjes efektive të grave, organizatave të grave dhe institucioneve që promovojnë barazinë gjinore në proceset e planifikimit (B4)</p> <p>Lehtësimi i vendim marrjes gjithëpërfshirëse që merr në konsideratë nevojat dhe prioritetet specifike të grave dhe burrave (B4)</p>	<p>Përdorimi i strategjive, politikave dhe programeve ekzistuese që trajtojnë pabarazitë gjinore (C1)</p> <p>Përfshirja e konceptit të barazisë gjinore në kriteret për prioritetin e veprimeve të përshtatjes (C1)</p> <p>Marja e masave për të garantuar se veprimet e përshtatjes trajtojnë cënueshmëritë e lidhura me aspektet gjinore dhe mbështeten në njohuritë dhe kapacitetet ekzistuese të grave dhe burrave (C3)</p> <p>Marja e masave për të garantuar se veprimet e përshtatjes mbështesin gratë e cënueshme që të aksesojnë burimet dhe mundësitë që u nevojiten për përshtatjen (C1)</p> <p>Identifikimi i veprimeve specifike që synojnë veçanërisht gratë e cënueshme (C2)</p> <p>Fuqizimi i grave dhe i organizatave të grave për të marrë role drejtuese në zbatimin e masave të përshtatjes (C3)</p> <p>Zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (C2)</p> <p>Marja e masave për të garantuar se burimet për përshtatjen, duke përfshirë financimet, alokohen në mënyrë të barabartë nga pikëpamja gjinore (C1)</p> <p>Marja e masave për të garantuar se veprimet e përshtatjes rrisin barazinë në përbushjen e të drejtave dhe aksesin në burime të grave dhe burrave (C2)</p>	<p>Përfshirja e ekspertëve të çështjeve gjinore në zhvillimin e kuadrove të monitorimit dhe vlerësimit, duke u bazuar në sistemet ekzistuese (C1)</p> <p>Përfshirja e mbledhjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe e analizës gjinore të të dhënave (D1)</p> <p>Përfshirja e grave në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave (D2)</p> <p>Përfshirja e treguesve të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në proceset e përshtatjes (D1)</p> <p>Vlerësimi i ndikimit të diferencuar të veprimeve të përshtatjes te gratë dhe burrat (D2)</p>

40. Referencat u referohen hapave në vijim, të identifikuar në katër elementet kryesore të procesit të PKP-së, siç paraqiten në udhëzime: A) Hedhja e themeleve dhe trajtimi i mangësive, B) Elementet përgatitore, C) Strategjitë e zbatimit, D) Raportimi, monitorimi dhe rishikimi. KKKBNK. (2012b). Planet Kombëtarë të Përshtatjes: Udhëzimet teknike për procesin e planit kombëtar të përshtatjes. Grupi i Ekspertëve i Vendeve më Pak të Zhvilluara, dhjetor 2012. Marrë nga https://unfccc.int/files/adaptation/cancun_adaptation_framework/application/pdf/naptechguidelines_eng_high__res.pdf

	Mekanizmat institucionalë (A1)	Zhvillimi i kapaciteteve (C3)	Ndarja e informacionit (B4, C3)
FAKTORËT MUNDËSËS	<p>Garantimi i përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave në strukturat institucionale për procesin e PKP-së</p> <p>Lehtësimi i pjesëmarrjes së organizatave që promovojnë barazinë gjinore dhe/ose interesat e grave (duke përfshirë ministrinë qeveritare me fokus tek aspektet gjinore)</p> <p>Vënia në pah, në termat e referencës për strukturat institucionale, e rëndësisë që ka ndjeshmëria gjinore në veprimtari dhe vendimmarrje</p> <p>Përfshirja e organizatave që promovojnë barazinë gjinore dhe/ose interesat e grave (duke përfshirë në nivel rajonal) në platformat e palëve të interesit të lidhura me procesin e PKP-së</p>	<p>Identifikimi i aktorëve kryesorë për barazinë gjinore dhe i burimeve të ekspertizës gjinore në vend</p> <p>Hartimi i strategjive të zhvillimit të kapaciteteve për të gjeneruar përfitime të barabarta për burrat dhe gratë</p> <p>Lehtësimi i veprimtarive të synuara për ngritjen e kapaciteteve për gratë dhe organizatat e grave për të mundësuar pjesëmarrje efektive në procesin e PKP-së</p> <p>Lehtësimi i ngritjes së kapaciteteve për ekipet e PKP-së për integrimin e aspekteve gjinore</p>	<p>Trajtimi i pengesave me specifikë gjinore ndaj aksesit në informacion, në strategjitë e komunikimit dhe të shpërndarjes</p> <p>Zhvillimi i shërbimeve për informacionit klimatike për të siguruar akses të barabartë për burrat dhe gratë</p> <p>Garantimi i pjesëmarrjes së barabartë të grave në platforma dhe rrjete</p>

Burimi: NAP, A Framework for Gender-Responsive National Adaptation Plan (NAP) Processes (Një kuadër për proceset e Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP) me përgjegjshmëri gjinore), 2017 <https://napglobalnetwork.org/wp-content/uploads/2017/07/napgn-en-2017-a-framework-for-gender-responsive-nap-processes.pdf>

Shtojca IV: Konsultimet me palët e interesit

Procesi i konsultimeve me palët e interesit dhe dhënies së komenteve gjatë përgatitjes së PKP-së (Faza I)

Në kuadër të procesit të integrit të aspekteve gjinore për Planin Kombëtar të Përshtatjes (PKP) të Shqipërisë, u realizuan një sërë konsultimesh me palët e interesit gjatë periudhës janar-shkurt 2024. Synimi i këtyre takimeve ishte mbledhja e të dhënave mbi integrimin e aspekteve gjinore në përpjekjet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në sektorë dhe institucione të ndryshme. Konsultimet u fokusuan në mbledhjen e të dhënave bazë, rishikimin e strategjive kombëtare të rëndësishme dhe strukturimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVBGJ). Kjo punë përgatitore garantoj harmonizimin e dokumentit me objektivat më të gjerë të Shqipërisë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe me strategjinë kombëtare për barazinë gjinore. Për më tepër, falë

kësaj pune u siguroi informacion i vlefshëm mbi praktikatat dhe sfidat aktuale, si dhe mbi ndërhyrjet e mundshme për përmirësimin veprimeve për klimën me përgjegjshmëri gjinore në Shqipëri.

Konsultimet angazhuan një spektër të gjerë të palëve përkatëse të interesit, përfshirë ministrinë qeveritare, agjencitë e specializuara, institutet kërkimore, organizatat e OKB-së dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur institucionet e përfshira dhe datat e takimeve, duke ofruar një pasqyrë të përgjithshme të subjekteve, kontributet e të cilave kanë informuar integrimin e konsideratave gjinore në PKP. Ky hartëzim ilustron përfshirjen e procesit dhe siguron transparencë në lidhje me diversitetin e perspektivave institucionale të marra në konsideratë. Krahas këtyre, fotografitë e mëposhtme dokumentojnë vizualisht procesin e konsultimit. Ato tregojnë përfshirjen aktive të pjesëmarrësve dhe frymën bashkëpunuese të

Data	Institucioni
22 janar 2024	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
22 janar 2024	Instituti i Kërkimeve Urbane
22 janar 2024	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
23 janar 2024	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
24 janar 2024	UN Women
24 janar 2024	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
26 janar 2024	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
7 shkurt 2024	AWEN - Rjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
12 shkurt 2024	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

diskutimeve, duke përforcuar rëndësinë e angazhimit gjithëpërfshirës për përparimin e veprimeve klimatike të përgjigjshme gjinore në Shqipëri.


Procesi i konsultimeve me palët e interesit dhe dhënies së komenteve për Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (Faza II)

Në tetor 2024, drafti i Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVBGJ) u nda me palët kryesore të interesit, duke përfshirë me ministrinë qeveritare, organizatat ndërkombëtare, ekspertët e politikave për klimën dhe specialistët e sektorit. Qëllimi ishte mbledhja e informacioneve dhe të dhënave për të garantuar rëndësinë, cilësinë dhe harmonizimin e tij me prioritetet kombëtare. Dokumenti u shpërnda me email për të mundësuar dhënien e komenteve në kohë reale. Periudha e konsultimit u shtri deri në fillim të muajit nëntor, duke u dhënë kështu palëve të interesit kohën e nevojshme për të shqyrtuar përmbajtjen e dokumentit dhe për të dhënë komentet e tyre. Nga muaji nëntor 2024 deri në janar 2025, palëve të interesit iu kërkua që të jepnin komente mbi aspekte të ndryshme të dokumentit, duke përfshirë mbi strukturën e tij, saktësinë e të dhënave dhe harmonizimin me prioritetet kombëtare. Komentet u mbledhën me shkrim dhe përmes takimeve të strukturuar. Periudha e gjatë për dhënien e komenteve garantoj që të gjitha palët përkatëse të kishin mundësinë të angazhoheshin me dokumentin.

Rishikimet kryesore bazuar në komentet e dhëna përfshijnë:

- Palët e interesit sugjeruan ristrukturimin e dokumentit për të ndarë analizat e detajuara nga teksti kryesor, duke lehtësuar kështu lexueshmërinë/kuptueshmërinë e tij. Këto sugjerime u zbatuan dhe analizat sektoriale u zhvendosën në seksionin e shtojcave duke lënë përmbledhje koncize në dokumentin kryesor.
- U kërkuan më shumë të dhëna specifike për aspektet gjinore dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike, veçanërisht lidhur me punësimin e grave në sektorë kyç si bujqësia, turizmi dhe energjia. Këto të dhëna u rishikuan dhe standardizuan, duke siguruar shifra në terma absolutë dhe përqindje për të ofruar një panoramë më të qartë të shpërndarjes gjinore.
- Komentet nënvizuan nevojën për të forcuar lidhjen ndërmjet përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe shërbimeve të kujdesit social në nivel vendor. U prezantuan veprime të reja për të integruar më mirë këto shërbime në dokument, duke u siguruar që popullsitë e cënueshme të marrin mbështetje gjithëpërfshirëse.
- PVBGJ-ja u rishikua për të qenë më shumë në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021-2030). U shtuan referenca eksplicite për të garantuar koherencën.

Figura 7. Konsultimet me palët e interesit gjatë përgatitjes së PKP-së së Shqipërisë (janar–shkurt 2024): Takime me përfaqësues nga Instituti i Kërkimeve Urbane, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.



Procesi i konsultimeve dhe dhënies së komenteve, i cili u shtri gjatë periudhës tetor 2024 - janar 2025, ishte thelbësor për zhvillimin e një plani veprimi gjithëpërfshirës dhe efektiv për aspektet gjinore. Duke përfshirë në mënyrë aktive palët e interesit në fazat e hartimit dhe rishikimit, PVBGJ-ja u përmirësua dhe u përshtat për të trajtuar më mirë dimensionet gjinore të ndryshimeve klimatike në Shqipëri. Kjo qasje bashkëpunuese garanoi që PVBGJ-ja do të jetë një instrument i vlefshëm në rritjen e barazisë gjinore në përpjekjet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.



GREEN
CLIMATE
FUND



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

